

RAPORT

I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË

MJEDIS

(VNM)

PËR PROJEKTIN:

"Qendër për Grumbullimin, Klasifikimin, Magazininimin e Përkohshëm të Mbeturinave Metalike, Plastike, Akumulatorëve të Përdorur dhe Mbeturinave Elektrike/Elektronike, si dhe Çmontimin e Automjeteve dhe Kamionëve Jashtë Përdorimit për Rikuperim të Materialeve"

Lokacioni: Parcela kadastrale P-71409044-01218-2 Zona Kadastrale Lipjan, Komuna e Lipjanit
Adresa: Rr. "Ibrahim Rugova", magjistrallja Prishtinë–Shtime (M-25), Lipjan
Sipërfaqja e parcelës: 2916 m ² Faza e projektit: Operim (aktivitet ekzistues)
APLIKUESI / INVESTITORI
Loresa BBV Sh.p.k. Numri i biznesit: 812014132
HARTUESI I RAPORTIT TË VNM-së
GeoSource Consulting Sh.p.k.
Tel: +383 44 800 098 E-mail: gsc.rks@gmail.com

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS (VNM)

Të Dhëna të përgjithshme të Projektit:

Emri i Projektit: Qendër për Grumbullimin, Klasifikimin, Magazinimin e Përkohshëm të Mbeturinave Metalike, Plastike, Akumulatorëve të Përdorur dhe Mbeturinave Elektrike/Elektronike, si dhe Çmontimin e Automjeteve dhe Kamionëve Jashtë Përdorimit për Rikuperim të Materialeve.

Lokacioni: Lipjan

Rruga: Magjistralla- Prishtinë- Shtime –“Rr.Ibrahim Rugova”

Sipërfaqja: 2916.3

Faza e Projektit: Operim

Investitori / Aplikuesi

Loresa BBV Sh.P.K.

Tel:

E-mail:

Përfaqësuesi i kompanisë:

Emri dhe Mbiemri:Blorimi Fazliu

Pozita: Pronar

Nënshkrimi: _____

Data: 29/07/2026

Vula e kompanisë

HARTUESI I RAPORTIT TË VNM-së

GeoSource Consulting Sh.p.k.

Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel: +383 44 800 098

E-mail: dsc.rks@gmail.com

E-mail: astrit-shala@hotmail.com

Ekipi Profesional

Emri dhe Mbiemri	Profesioni	Nënshkrimi
Dr. Sc. Astrit Shala	Gjeolog	_____
Inxh. Dip. Ark. Masar Kabashi	Arkitekt	_____
MSc. Iliriana Sutaj	Inxhiniere e Ndërtimtarisë	_____

Prishtinë, 29.07.2026

PËRMBAJTJA

1. Informacione të përgjithshme.....	13
1.1. Të dhënat për aplikuesin.....	14
1.2. Të dhënat kryesore për projektin, titulli i plotë, vendndodhja dhe adresa.....	14
1.3. Të dhëna për hartuesit që kanë marrë pjesë në hartimin e Raportit të VNM-së.....	15
1.4. Baza ligjore dhe metodologjike e hartimit të raportit.....	15
1.5. Metodologjia dhe niveli i sigurtisë së të dhënave.....	16
1.6. Organizimi i procesit të VNM-së	17
1.6.1. Fushëveprimi	17
1.6.2. Qasja burim–rrugë–receptor	17
1.6.3. Klasifikimi i të dhënave.....	18
1.7. Palët e interesit dhe komunikimi	18
1.7.1. Identifikimi i palëve.....	18
1.7.2. Mekanizmi i ankesave	18
2. Përshkrimi i projektit të propozuar	19
2.1. Kategoria e projektit të propozuar	19
2.2. Përshkrim të punëve përgatitore për zbatimin e projektit.....	19
2.3. Përshkrimin e karakteristikave kryesore të funksionimit të projektit	20
2.3.1. Organizimi funksional i lokacionit	20
2.3.2. Karakteristikat teknike të funksionimit	22
2.4. Përshkrimin detal të procesit të planifikimit të prodhimit, duke filluar nga hyrja e lëndëve të para deri te produkti përfundimtar.....	24
2.4.1. Faza 1 – Pranimi, kontrolli dhe regjistrimi	25
2.4.2. Faza 2 – Klasifikimi dhe kodifikimi sipas Katalogut Shtetëror të Mbeturinave	25
2.4.3. Faza 3 – Çmontimi i automjeteve dhe kamionëve jashtë përdorimit	25
2.4.4. Faza 4 – Depolutimi: heqja e lëngjeve dhe komponentëve të rrezikshëm.....	26
2.4.5. Faza 5 – Magazinimi i përkohshëm i ndarë.....	27
2.4.6. Faza 6 – Presimi, paketimi dhe përgatitja për transport	27
2.4.7. Faza 7 – Transporti dhe dorëzimi tek operatorët e licencuar.....	27
2.4.8. Bilanci material i procesit.....	28
2.5. Paraqitjen e llojit dhe sasisë së burimeve të nevojshme	28
2.5.1. Energjia elektrike.....	28
2.5.2. Uji	29
2.5.3. Karburanti dhe materialet shpenzuese.....	29
2.5.4. Burimet natyrore.....	29
2.6. Vlerësimin e gjenerimit të llojit dhe sasisë së mbeturinave, emetimeve gjatë procesit teknologjik	29
2.6.1. Klasifikimi i mbeturinave të pranuar sipas Katalogut Shtetëror të Mbeturinave.....	30
2.6.2. Mbeturinat e gjeneruara nga çmontimi i automjeteve jashtë përdorimit	31
2.6.3. Mbeturinat e gjeneruara nga funksionimi i objektit.....	33
2.6.4. Bilanci i përgjithshëm i mbeturinave.....	33
2.6.5. Emetimet në ajër.....	34
2.7. Prezantimi i teknologjisë së trajtimit, përpunimit, riciklimit, dhe asgjësimit të të gjitha llojeve të mbeturinave	37
2.7.1. Sqarim terminologjik: baza e riformulimit të titullit dhe kufizimi i veprimtarisë ndaj konceptit ligjor “trajtim”	37
2.7.2. Operacionet e kryera për secilin kod mbeturine	39
2.7.3. Kërkesat e përbashkëta teknike për magazinimin.....	42
2.7.4. Zinxhiri i mëtejshmë i trajtimit tek operatorët e licencuar	43

2.8.	Program për ndërtimin, kohëzgjatjen e ndërtimit, kohëzgjatjen e planifikuar të funksionimit të projektit, kohën e mundshme të përfundimit të funksionimit të projektit dhe sipas rastit edhe fazën e planifikuar të rehabilitimit të sipërfaqes pas mbarimit të funksionimit të projektit	43
2.9.	Të dhëna për infrastrukturën e nevojshme.....	44
2.10.	Të dhëna për aktivitete të tjera që mund të nevojiten për zbatimin e projektit, si ndërtimi i kampeve apo rezidencave.....	45
2.11.	Informacion për lejet dhe licencat e nevojshme për projektin.....	45
2.12.	Informacion për ndërlidhjet e mundshme të projektit me projekte të tjera ekzistuese	46

3. Përshkrimi i lokacionit të propozuar 48

3.1.	Të dhënat për emrin e lokacionit ku është planifikuar të zbatohet projekti.....	48
3.2.	Skicën dhe planimetrinë e vendndodhjes së projektit.....	49
3.3.	Distancën me të dhënat për qendrat e banuara në raport me lokacionin ku propozohet të zbatohet projekti, shoqëruar me fotografi	52
3.4.	Paraqitjen e karakteristikave pedologjike, gjeomorfologjike, gjeologjike, hidrogeologjike dhe sizmologjike të terrenit	54
3.4.1.	Karakteristikat pedologjike.....	54
3.4.2.	Karakteristikat gjeomorfologjike.....	54
3.4.3.	Karakteristikat gjeologjike	55
3.4.4.	Karakteristikat hidrogeologjike	56
3.4.5.	Karakteristikat sizmologjike.....	58
3.4.6.	Vlerësimi i përgjithshëm i përshtatshmërisë së terrenit.....	58
3.5.	Të dhënat për burimin e furnizimit me ujë	58
3.6.	Paraqitjen e karakteristikave klimatike me tregues të përshtatshëm meteorologjik	59
3.7.	Prezantimi i karakteristikave natyrore	60
3.8.	Rishikimi i karakteristikave themelore të peisazhit.....	61
3.9.	Rishikimi i objekteve të mbrojtura të trashëgimisë kulturore dhe historike.....	62
3.10.	Të dhënat për popullsinë, përqendrimin e popullsisë dhe karakteristikat demografike në lidhje me projektin e planifikuar	63
3.11.	Të dhëna për objektet ekzistuese	63
3.12.	Në varësi të karakteristikave të zonës, përshkrimi i lokacionit përmban edhe të dhëna për zonat e përcaktuara për kërkime shkencore, vendet arkeologjike, zonat veçanërisht të ndjeshme, zonat me qëllime të veçanta dhe të ngjashme	64
3.13.	Të dhënat për burimet ujore në sipërfaqen ku realizohet projekti dhe në afërsi të saj.....	65

4. Gjendja aktuale e faktorëve mjedisor 66

4.1.	Raport për gjendjen aktuale të faktorëve mjedisor	66
4.1.1.	Gjendja aktuale sipas faktorëve mjedisorë	66
4.1.2.	Boshllëqet e të dhënave dhe monitorimi bazë i detyrueshëm.....	66
4.1.3.	Ndryshimet e mundshme në gjendjen e mjedisit nëse projekti nuk zbatohet	67

5. Përshkrimi i alternativave të projektit 69

5.1.	Përshkrimi i alternativave të realizueshme	69
5.2.	Përshkrimi i alternativave të realizueshme përmban edhe përshkrimin e arsyeve kryesore për zgjedhjen e një alternative të caktuar	69
5.3.	Vendndodhjes ose rrugës.....	70
5.4.	Ndikimet në mjedis dhe shëndetin e njeriut	71
5.5.	Proceset, teknologjia e prodhimit	72
5.6.	Metodat e punës gjatë zbatimit dhe funksionimit të projektit	72
5.7.	Planin e lokacionit	74
5.8.	Llojin dhe përzgjedhjen e materialeve për realizimin e projektit	74
5.9.	Afati kohor për ekzekutimin dhe përfundimin e funksionimit të projektit sipas legjislacionit	75

5.10.	Madhësia e lokacionit ose objektit	76
5.11.	Vëllimi i prodhimit	76
5.12.	Kontrolli i ndotjes	76
5.13.	Trajtimin e mbeturinave, përfshirë riciklimin, ripërdorimin, asgjësimin dhe deponimin përfundimtar	77
5.14.	Rregullimi i infrastrukturës rrugore të qasjes në projekt dhe rrugë të komunikacionit	78
5.15.	Përgjegjësia dhe procedura për menaxhimin e mjedisit	79
5.16.	Trajnime	79
5.17.	Monitorimi	80
5.18.	Planet për situata emergjente	80
5.19.	DEMOLIMI DHE REHABILITIMI	82
5.20.	Plani për menaxhimin e mjedisit	84
5.21.	Përshkrimi i alternativave pa veprim	84
6.	Përshkrimi i ndikimit të projektit në mjedis	85
6.1.	Përshkrimi i ndikimeve të projektit në mjedis	85
6.1.1.	Metodologjia e vlerësimit	85
6.1.2.	Matrica përmbledhëse e ndikimeve	85
6.2.	Cilësinë e ajrit	87
6.3.	Nivelin dhe përqendrimin e substancave ndotëse në ajër dhe krahasimin me treguesit e përcaktuar me norma dhe standardet sipas legjislacionit në fuqi	87
6.4.	Ndikimin e projektit në klimë, lloji dhe vëllimi i emetimeve të gazeve serrë dhe ndjeshmëria e projektit ndaj ndryshimeve klimatike	88
6.4.1.	Ndjeshmëria e projektit ndaj ndryshimeve klimatike	89
6.5.	Mundësinë e ndikimit në ndotjen ndërkufitare të ajrit	90
6.6.	Cilësia e ujit	90
6.7.	Ndikimi i ndotësve në cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore	90
6.8.	Mundësinë e ndikimit në ndotjen ndërkufitare të ujërave	91
6.9.	Ndryshimet hidromorfologjike, sasia dhe cilësia me referencë të veçantë për shkarkimet e ujërave të zeza 91	
6.10.	Toka	92
6.11.	Ndikimi fizik, ndryshimi në topografinë lokale, erozioni i tokës, rrëshqitjet e tokës, etj.	92
6.12.	Ndikimi i emetimeve të ndotësve në vendndodhjen e projektit të planifikuar dhe në tokën përreth dhe krahasimi me treguesit e përcaktuar me norma dhe standarde sipas legjislacionit përkatës	92
6.13.	Ndikimi në shfrytëzimin e tokës dhe burimeve natyrore	93
6.14.	Sasia dhe cilësia e tokës bujqësore të humbur	93
6.15.	Ndikimi në karakteristikat gjeologjike dhe gjeomorfologjike	93
6.16.	Popullsinë lokale	93
6.17.	Ndryshimet në numrin dhe strukturën e popullsisë dhe ndikimet të lidhura me mjedisin, popullsia, përqendrimi dhe migrimi	94
6.18.	Ndikimet vizuale të vendbanimeve	94
6.19.	Ndikimet e emetimit të ndotësve, zhurmës, vibrimet, nxehtësisë dhe të gjitha llojet e rrezatimit për shëndetin e njeriut	94
6.20.	Ndikimet socio-ekonomike	95
6.21.	Ndikimi i projektit në struktura të ekonomisë lokale, sipas sektorit prodhues dhe degës kryesor të zonës 95	
6.22.	Numri i vendeve të punës të krijuara gjatë fazave të ndërtimit dhe funksionimit të projektit, si dhe humbjet e mundshme të vendeve të punës në sektorët apo zonat e prekura	95
6.23.	Kontributi i projektit në ekonominë rajonale dhe kombëtare	95
6.24.	Ekosistemet dhe gjeologjia	96

6.25.	Humbja dhe dëmtimi i specieve bimore dhe shtazore dhe habitateve të tyre	96
6.26.	Humbja dhe dëmtimi i veçorive gjeologjike, paleontologjike dhe gjeomorfologjike biodiversiteti, florës dhe fauna, pasurive natyrore të mbrojtura, specieve të rralla dhe të rrezikuara të bimëve dhe kafshëve të egra dhe habitateve të tyre	96
6.27.	Qëllimi dhe shfrytëzimi i sipërfaqeve.....	96
6.28.	Sipërfaqet e ndërtuara dhe të pa ndërtuara	97
6.29.	Shfrytëzimi i tokës.....	97
6.30.	Infrastrukturën komunale	97
6.31.	Trafiku	97
6.32.	Furnizimi me ujë.....	97
6.33.	Energjia.....	97
6.34.	Ujërat e zeza	97
6.35.	Gjenerimi i mbeturinave	98
6.36.	Pasuritë e mbrojtura natyrore, kulturore dhe rrethina e tyre, veçoritë e peizazhit.....	98
6.37.	Përkrahimi i ndikimeve të projektit në mjedis përmban gjithashtu informacione që rezultojnë nga zbatimi i projektit, ndikimet kumulative dhe shtrirja hapësinore	99
6.38.	Zbatimi i projektit, duke përfshirë punimet e largimit, sipas rastit.....	99
6.39.	Ndikimet kumulative të projekteve të tjera ekzistuese	99
6.40.	Të dhëna për shtrirjen e mundshme hapësinore të ndikimit negativ në mjedis	100
6.41.	Shkarkimi i ujërave të ndotura gjatë fazës së ndërtimit.....	100
6.42.	Emetimet e rrezatimit elektromagnetik gjatë ndërtimit	101
6.43.	Emetimet në ajër të gazrave serrë gjatë operimit.....	101
6.44.	Ndikimet në ndryshimet klimatike	101

7. Përkrahimi i masave për të parandaluar, reduktuar ose eliminuar ndikimin në mjedis..... 102

7.1.	Masat e parashikuara me legjislacion, norma e standarde dhe afate për zbatimin e tyre	102
7.2.	Masat që duhen marrë në rast aksidentesh dhe fatkeqësive të mëdha	103
7.3.	Planet dhe zgjidhjet teknike për mbrojtjen e mjedisit: trajtimi, riciklimi, dhe magazinimi i mbeturinave, rikultivimi, rehabilitimi i vendndodhjes pas përfundimit të aktivitetit	105
7.4.	Masa të tjera që mund të ndikojnë në parandalimin, zvogëlimin ose neutralizimin e efekteve të dëmshme në mjedis	107

8. Programi i monitorimit të ndikimit në mjedis 108

8.1.	Programi i monitorimit të ndikimit në mjedis	108
8.2.	Prezantimin e gjendjes mjedisore përpara se projekti të vihet në punë ose fillimi i aktiviteteve në vendet ku ndikimi mjedisor pritet.....	108
8.3.	Parametrat në bazë të të cilave mund të përcaktohen efektet e dëmshme në mjedis.....	108
8.4.	Vendet, mënyra dhe shpeshtësia e matjes së parametrave të përcaktuar	109
8.5.	Përmbajtja dhe dinamika e dorëzimit të raporteve për matjet e kryera	111
8.6.	Detyrimin për të informuar publikun për rezultatet e matjeve të kryera	112
8.7.	Programin ndërkufitar të monitorimit të ndikimit në mjedis, sipas rastit.....	112

9. Plani i menaxhimit mjedisor 113

9.1.	Mbrojtja efektive mjedisore gjatë gjithë fazave të projektit	113
9.1.1.	Struktura organizative e menaxhimit mjedisor.....	114
9.2.	Pajtushmeria me pëlqimin mjedisor	114
9.3.	Inkurajimi i zhvillimit të sistemit të menaxhimit mjedisor në përputhje me standardin ISO 14000	115

10. Informacione shtesë dhe karakteristikat e projektit 116

10.1.	Informacionet dhe karakteristikat shtesë të projektit specifik	116
-------	--	-----

10.1.1.	Kriteret e pranimi dhe të refuzimit të mbeturinave	116
10.1.2.	Gjurmueshmëria dhe ditari i mbeturinave	116
10.1.3.	Kufizimet operative të detyrueshme	117
10.2.	Lista e kontrollit sipas Shtojcës II të UA (MMPHI) nr. 04/2025	118
10.3.	Korniza ligjore e zbatueshme	121

11. Burimet e të dhënave 123

11.1.	Lista e referimit të burimeve e të dhënave të përdorura për përshkrimet dhe vlerësimet e dhëna në raportin e VNM-së	123
11.1.1.	Akte ligjore dhe nënligjore	123
11.1.2.	Dokumentacion i projektit dhe të dhëna të aplikuesit	123
11.1.3.	Korrespondencë institucionale	123
11.1.4.	Të dhëna statistikore, hartografike dhe mjedisore	123
11.1.5.	Metodologji dhe burime teknike	124

12. Shtojca 125

12.1.	Përmbledhja jo-teknike e informacionit	125
12.1.1.	Çfarë parashihet të bëhet dhe ku	125
12.1.2.	Sa larg janë banorët dhe objektet e ndjeshme	125
12.1.3.	Çfarë ndryshoi në këtë raport dhe pse	125
12.1.4.	Sa material do të përpunohet në vit	126
12.1.5.	Çfarë ndikime mund të ketë	126
12.1.6.	Përfitimet	127
12.1.7.	Zgjidhjet e tjera që u shqyrtuan	127
12.1.8.	Si do të kontrollohet	127
12.2.	Lista e dokumenteve që bashkëngjiten raportit	128
12.3.	Shtojcat teknike	129

LISTA E FIGURAVE

Figura 1. Pozita gjeografike e lokacionit të projektit në kuadër të territorit të Republikës së Kosovës	13
Figura 2. Rrjedha e procedurës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis Burimi: Përpunim i hartuesit sipas Ligjit Nr. 08/L-181 dhe UA (MMPHI) Nr. 04/2025	17
Figura 3. Organizimi funksional i lokacionit – skemë e zonimit sipas fraksioneve dhe kodeve të mbeturinave	22
Figura 4. Pamje e hapësirës së jashtme operative të lokacionit – sipërfaqe të asfaltuara, zona e pritjes për automjete jashtë përdorimit dhe hangarët ekzistues	23
Figura 5. Kamionë jashtë përdorimit në zonën e pritjes para depolimit (majtas) dhe organizimi i qarkullimit të brendshëm (djathtas).....	23
Figura 6. Skema e procesit teknologjik – shtatë fazat e procesit dhe operacionet përkatëse sipas Listës R.....	24
Figura 7. Rafte për magazinimin e pjesëve të çmontuara dhe depozita për vavra e lëngje teknike brenda Hangarit 2	27
Figura 8. Bilanci material i çmontimit të automjeteve jashtë përdorimit (kodi 16 01 04*).....	28
Figura 9. Vlerësimi i propagimit të zhurmës nga lokacioni drejt receptorëve më të afërt.....	36
Figura 10. Skema e menaxhimit të mbeturinave sipas kodit dhe operacionit përkatës	42
Figura 11. Objektet ekzistuese brenda parcelës dhe veprimtaritë e ngjashme në afërsi të drejtpërdrejtë.....	47
Figura 12. Pozita e parcelës kadastrale sipas Hartës Zonale Komunale të Lipjanit (HZK Lipjan) – destinimi komercial i zonës	49
Figura 13. Situacion i ngushtë – pozita e parcelës në raport me parcelat fqinje dhe rrjetin rrugor	50
Figura 14. Situacion gjeodezik i parcelës dhe i zonës përreth.....	50
Figura 15. Plan i lokacionit – kufijtë e parcelës, objektet ekzistuese, linja e kanalizimit, pusetat dhe gropa septike (ortofoto, Geoportali Shtetëror)	51
Figura 16. Afërsia e lokacionit me vendbanimet dhe me receptorët e ndjeshëm, me distancat e matura.....	52
Figura 17. Fotografi nga terreni – pamje e brendshme e lokacionit dhe e ndarjes ndaj parcelave fqinje.....	53
Figura 18. Pamje nga terreni ku zhvillohet veprimtaria	53
Figura 19. Harta pedologjike e zonës	54
Figura 20. Harta e relievit të zonës	55
Figura 21. Harta gjeologjike e zonës	56
Figura 22. Harta hidrologjike dhe relievo e zonës.....	57
Figura 23. Harta e zonave mbishtresore – Lipjan	57
Figura 24. Harta mesatare e reshjeve dhe e temperaturave në Kosovë.....	60
Figura 25. Sipërfaqe të gjelbra brenda kufijve të parcelës (majtas) dhe pamje e përgjithshme e zonës (djathtas) ..	61
Figura 26. Karakteristikat themelore të peizazhit urban-industrial të zonës.....	62
Figura 27. Ortofoto e zonës me objektet ekzistuese brenda dhe përreth parcelës (Geoportali Shtetëror)	64
Figura 28. Lokacioni i parcelës ku zhvillohet veprimtaria – gjendja aktuale	68
Figura 29. Vendndodhja e projektit dhe rrjeti rrugor i qasjes	71
Figura 30. Skema e metodave të punës, e masave të mbrojtjes së mjedisit dhe e masave të sigurisë në punë.....	74
Figura 31. Materialet dhe pajisjet e përzgjedhura për realizimin e projektit	75
Figura 32. Skema e organizimit të reagimit në situata emergjente.....	81
Figura 33. Inventari i verifikueshëm i gazeve serrë gjatë fazës së operimit.....	89
Figura 34. Kontejner për mbeturina komunale, kapacitet 1.1 m ³ , i shfrytëzuar sipas kontratës me KRM “Pastrimi”	98
Figura 35. Harta përmbledhëse A4 e lokacionit dhe receptorëve të ndjeshëm, me parcelën, distancat, veriun, shkallën dhe legjendën.....	128

LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Lista e shkurtesave dhe e termave të përdorura në raport.....	12
Tabela 2. Të dhënat identifikuese për aplikuesin	14
Tabela 3. Të dhënat kryesore identifikuese të projektit.....	14
Tabela 4. Të dhënat për hartuesin e licencuar të Raportit të VNM-së.....	15
Tabela 5. Punët përgatitore për zbatimin e projektit.....	19
Tabela 6. Organizimi funksional dhe bilanci i sipërfaqeve të lokacionit	20
Tabela 7. Karakteristikat kryesore teknike të funksionimit të projektit	22
Tabela 8. Metodologjia e kodifikimit të mbeturinave sipas UA (MMPH) nr. 13/2013	25
Tabela 9. Renditja e detyrueshme e depolutimit dhe kodifikimi i fraksioneve të rrezikshme.....	26
Tabela 10. Bilanci i konsumit të energjisë elektrike.....	28
Tabela 11. Bilanci i konsumit të ujit.....	29
Tabela 12. Materialet shpenzuese dhe kushtet e magazinimit.....	29
Tabela 13. Regjistri i kodeve të mbeturinave që pranoen në lokacion, sipas UA (MMPH) nr. 13/2013	30
Tabela 14. Bilanci material dhe kodifikimi i fraksioneve nga çmontimi i automjeteve jashtë përdorimit (kodi 16 01 04*).....	32
Tabela 15. Mbeturinat e gjeneruara nga funksionimi i objektit (jo nga procesi teknologjik)	33
Tabela 16. Bilanci i përgjithshëm i mbeturinave në nivel objekti	34
Tabela 17. Emetimet e pluhurit difuz nga manipulimi i materialeve (US EPA AP-42, kap. 13.2.4).....	35
Tabela 18. Emetimet nga djegia e karburantit dizel në makinerinë e manipulimit	35
Tabela 19. Burimet e zhurmës dhe fuqia akustike e vlerësuar	35
Tabela 20. Nivelet e vlerësuar të zhurmës në receptorët më të afërt	36
Tabela 21. Rrjedhat e ujërave të zeza dhe menaxhimi i tyre	37
Tabela 22. Deklarim eksplisit i operacioneve që kryhen dhe që nuk kryhen në lokacion	38
Tabela 23. Operacionet e kryera, kushtet e magazinimit dhe destinacioni i mëtejme për secilin kod të mbeturinës	40
Tabela 24. Zinxhiri i mëtejme i trajtimit dhe statusi i kontratave me operatorët e licencuar	43
Tabela 25. Programi kohor i fazave të projektit	44
Tabela 26. Infrastruktura ekzistuese dhe ndërhyrjet e nevojshme.....	44
Tabela 27. Lejet, licencat dhe dokumentet e nevojshme për projektin.....	45
Tabela 28. Vlerësimi i ndërlidhjeve me projekte dhe veprimtari të tjera ekzistuese	47
Tabela 29. Të dhënat për makrolokacionin dhe mikrolokacionin e projektit	48
Tabela 30. Të dhënat e planimetrisë së lokacionit.....	51
Tabela 31. Distancat nga receptorët e ndjeshëm dhe nga elementet kryesore hapësinore	52
Tabela 32. Karakteristikat hidrogeologjike dhe implikimet për projektin	56
Tabela 33. Të dhënat për burimin e furnizimit me ujë	58
Tabela 34. Karakteristikat klimatike dhe meteorologjike dhe relevanca e tyre për projektin	59
Tabela 35. Vlerësimi i prezencës së elementeve natyrore të ndjeshme në zonën e ndikimit	60
Tabela 36. Të dhënat demografike dhe popullsia potencialisht e ekspozuar.....	63
Tabela 37. Objektet ekzistuese brenda dhe përreth lokacionit	63
Tabela 38. Vlerësimi i prezencës së zonave të veçanta dhe të ndjeshme	65
Tabela 39. Burimet ujore në zonën e projektit dhe relacioni i tyre me veprimtarinë	65
Tabela 40. Gjendja aktuale e faktorëve mjedisor dhe cilësia e të dhënave	66
Tabela 41. Programi i monitorimit bazë (matja bazë referuese) – i detyrueshëm	67
Tabela 42. Përmbledhja e alternativave të analizuar dhe vendimi.....	69
Tabela 43. Krahasimi i alternativave të vendndodhjes	70
Tabela 44. Krahasimi i ndikimeve në mjedis dhe në shëndetin e njeriut sipas alternativave	71
Tabela 45. Krahasimi i teknologjive dhe arsyet e zgjedhjes	72
Tabela 46. Procedurat operative standarde të detyrueshme.....	73

Tabela 47. Materialet dhe pajisjet e përzgjedhura dhe funksioni mjedisor i tyre.....	74
Tabela 48. Derivimi i kapacitetit vjetor nga kapacitetet reale të magazinimit të lokacionit	76
Tabela 49. Masat e kontrollit të ndotjes dhe efikasiteti i pritshëm	76
Tabela 50. Zbatimi i hierarkisë së menaxhimit të mbeturinave dhe shpërndarja sasiore	77
Tabela 51. Vlerësimi i ngarkesës së transportit të gjeneruar nga projekti.....	78
Tabela 52. Ndarja e përgjegjësiave për menaxhimin e mjedisit.....	79
Tabela 53. Programi i trajnimeve të detyrueshme	80
Tabela 54. Planet për situata emergjente dhe veprimet e menjëhershme	80
Tabela 55. Analiza e pasojave të alternativës “pa veprim”	84
Tabela 56. Matrica përmbledhëse e vlerësimit të ndikimeve në mjedis	85
Tabela 57. Burimet e emetimeve në ajër dhe sasitë e vlerësuara	87
Tabela 58. Vlerësimi i ndikimit – cilësia e ajrit	87
Tabela 59. Krahësimi i kontributit të projektit me vlerat kufi referuese të cilësisë së ajrit.....	88
Tabela 60. Bilanci indikativ i emetimeve të gazeve serrë	88
Tabela 61. Ndjeshmëria e projektit ndaj ndryshimeve klimatike dhe masat e përshtatjes	89
Tabela 62. Vlerësimi i ndikimit – cilësia e ujit.....	90
Tabela 63. Ndikimi i ndotësve potencialë në cilësinë e ujërave dhe masat e kontrollit	91
Tabela 64. Sasitë dhe pikat e shkarkimit të ujërave.....	92
Tabela 65. Vlerësimi i ndikimit – toka	92
Tabela 66. Ndikimi i mundshëm i ndotësve në tokë dhe parametrat e monitorimit.....	93
Tabela 67. Vlerësimi i ndikimeve në shëndetin e popullatës dhe të punëtorëve	94
Tabela 68. Vendet e punës të krijuara dhe humbjet e mundshme	95
Tabela 69. Kontributi i projektit në ekonominë rajonale dhe kombëtare	96
Tabela 70. Bilanci i sipërfaqeve të ndërtuara dhe të pa ndërtuara	97
Tabela 71. Përmbledhja e ndikimit në gjenerimin dhe menaxhimin e mbeturinave	98
Tabela 72. Ndikimet nga punimet e largimit dhe masat përkatëse.....	99
Tabela 73. Vlerësimi i ndikimeve kumulative me veprimtaritë ekzistuese në zonë.....	99
Tabela 74. Shtrirja hapësinore e ndikimeve negative të mundshme.....	100
Tabela 75. Masat e parashikuara me legjislacion, afatet dhe përgjegjësitë	102
Tabela 76. Substancat e rrezikshme në lokacion, sasitë, karakteristikat dhe masat e kontrollit.....	103
Tabela 77. Masat specifike për rast aksidentesh dhe fatkeqësive të mëdha	104
Tabela 78. Planet dhe zgjidhjet teknike për mbrojtjen e mjedisit.....	105
Tabela 79. Masat rekomanduese shtesë për mbrojtjen e mjedisit.....	107
Tabela 80. Struktura e programit të monitorimit mjedisor	108
Tabela 81. Parametrat e monitorimit, kriteret e vlerësimit dhe referencat	108
Tabela 82. Programi i detajuar i monitorimit: vendet, metodat, frekuenca dhe kryerësi	109
Tabela 83. Përmbytja dhe dinamika e dorëzimit të raporteve të monitorimit	111
Tabela 84. Mekanizmat e informimit të publikut	112
Tabela 85. Plan i Menaxhimit Mjedisor: objektivat, masat, treguesit dhe verifikimi sipas fazave.....	113
Tabela 86. Mekanizmat e sigurimit të pajtueshmërisë me pëlqimin mjedisor	114
Tabela 87. Përputhshmëria e strukturës së PMM-së me kërkesat e ISO 14001	115
Tabela 88. Kriteret e refuzimit të mbeturinave në praninë.....	116
Tabela 89. Të dhënat e detyrueshme të ditarit të mbeturinave.....	117
Tabela 90. Kufizimet operative të detyrueshme të veprimtarisë	117
Tabela 91. Lista e kontrollit sipas Shtojcës II të UA (MMPHI) nr. 04/2025 – rezultati i vetëkontrollit.....	118
Tabela 92. Korniza ligjore dhe normative e zbatueshme, me statusin e verifikuar	121
Tabela 94. Distanca e qendrës nga banorët dhe objektet e ndjeshme (përmbledhje jo-teknike).....	125
Tabela 95. Sasitë e materialeve që do të pranohen në vit (përmbledhje jo-teknike)	126
Tabela 96. Ndikimet e mundshme dhe masat mbrojtëse (përmbledhje jo-teknike)	126
Tabela 97. Lista e dokumenteve për aplikim sipas Shtojcës III të UA (MMPHI) nr. 04/2025	129

Tabela 98. Shtojcat teknike të raportit.....	129
--	-----

LISTA E SHKURTESAVE DHE E TERMAVE

Tabela 1. Lista e shkurtesave dhe e termave të përdorura në raport

Shkurtesa / termi	Kuptimi
AMMK	Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
ADR	Marrëveshja Evropiane për transportin ndërkombëtar të mallrave të rrezikshme rrugor
ELV	End-of-Life Vehicle – automjet jashtë përdorimit
EN / ISO	Normë evropiane / normë e Organizatës Ndërkombëtare të Standardizimit
GES	Gaze me efekt serrë
HZK	Harta Zonale Komunale
Katalogu	Katalogu Shtetëror i Mbeturinave, sipas UA (MMPH) nr. 13/2013
Lista D	Shtojca I e Ligjit nr. 04/L-060 – operacionet e asgjësimit (D1–D15)
Lista R	Shtojca II e Ligjit nr. 04/L-060 – operacionet e rikuperimit (R1–R13)
MMPHI	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
MPEE	Mbeturina të pajisjeve elektrike dhe elektronike
NS	Nominal Size – madhësia nominale e separatorit sipas EN 858
PM₁₀ / PM_{2.5}	Pluhur i pezullt me diametër aerodinamik $\leq 10 \mu\text{m}$ / $\leq 2.5 \mu\text{m}$
PMM	Plani i Menaxhimit Mjedisor
R12	Shkëmbimi i mbeturinave për t'i nënshtruar ato operacioneve R1–R11 (përfshin çmontimin, klasifikimin, ngjeshjen, paketimin)
R13	Magazinimi i mbeturinave në pritje të një operacioni nga R1 deri R12
SHSP	Siguria dhe shëndeti në punë
TPH	Total Petroleum Hydrocarbons – hidrokarbure totale të naftës
TSS	Total Suspended Solids – lëndë të ngurta të pezulluara
UA	Udhëzim Administrativ
VNM	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis
*	Yll pas kodit – tregon mbeturinë të rrezikshme sipas nenit 2, par. 3.4 të UA nr. 13/2013

1. INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME

Ky Raport i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (në vijim: Raporti i VNM-së) është hartuar për projektin "Qendër për Grumbullimin, Klasifikimin, Magazinimin e Përkohshëm të Mbeturinave Metalike, Plastike, Akumulatorëve të Përdorur dhe Mbeturinave Elektrike/Elektronike, si dhe Çmontimin e Automjeteve dhe Kamionëve Jashtë Përdorimit për Rikuperim të Materialeve", i cili zhvillohet nga kompania Lorea BBV Sh.p.k., me numër biznesi 812014132, në parcelën kadastrale P-71409044-01218-2 (nr. 1218-2), Zona Kadastrale Lipjan, Komuna e Lipjanit.

Raporti është hartuar në përputhje me Ligjin nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 2, 6 janar 2023) dhe me Udhëzimin Administrativ (MMPHI) nr. 04/2025 për përmbajtjen, metodologjinë dhe përputhshmërinë e raportit me kërkesat ligjore, praktikat e zbatueshme dhe aspektet e tjera teknike të raportit. Struktura e raportit ndjek pikë për pikë Shtojcën I – Struktura e Raportit të Udhëzimit Administrativ të lartcekur.

Qëllimi i raportit është identifikimi, analizimi dhe vlerësimi i ndikimeve të mundshme të veprimtarisë në faktorët mjedisorë dhe në shëndetin e njeriut, përcaktimi i masave për parandalimin, reduktimin ose eliminimin e ndikimeve negative, dhe përcaktimi i programit të monitorimit dhe të planit të menaxhimit mjedisor.



Figura 1. Pozita gjeografike e lokacionit të projektit në kuadër të territorit të Republikës së Kosovës

1.1. Të dhënat për aplikuesin

Aplikuesi është personi juridik përgjegjës për saktësinë e të dhënave dhe zbatimin e kushteve mjedisore. Tabela në vijim përmbledh identitetin e tij dhe shënon qartë të dhënat kontaktuese që duhet të plotësohen e nënshkruhen para dorëzimit.

Tabela 2. Të dhënat identifikuese për aplikuesin

Të dhënat	Përmbajtja
Emri i personit juridik	Loresa BBV Sh.p.k.
Forma juridike	Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (Sh.p.k.)
Gjinia (vetëm për aplikues person fizik)	Nuk aplikohet – aplikuesi është person juridik
Numri unik i biznesit (NUI/NRB)	812014132
Adresa e ushtrimit të veprimtarisë	Rr. "Ibrahim Rugova", magjistrallja Prishtinë–Shtime (M-25), Lipjan
Komuna	Lipjan
Emri dhe mbiemri i personit përgjegjës	Blorim Fazliu
Pozita e personit përgjegjës	Pronar
Telefoni kontaktues	044206949
Adresa e postës elektronike	
Veprimtaria kryesore	Grumbullim, klasifikim dhe magazinim i përkohshëm i mbeturinave; çmontim i automjeteve jashtë përdorimit për rikuperim të materialeve

1.2. Të dhënat kryesore për projektin, titulli i plotë, vendndodhja dhe adresa

Projekti zhvillohet në parcelën ekzistuese nr. 1218-2 në ZK Lipjan dhe ka fushëveprim të kufizuar në menaxhimin e rrjedhave të përshkruara në raport. Tabela në vijim unifikon titullin, vendndodhjen, sipërfaqet dhe kapacitetin e deklaruar që duhet të mbështetet me evidencat e aplikuesit.

Tabela 3. Të dhënat kryesore identifikuese të projektit

Të dhënat	Përmbajtja
Titulli i plotë i projektit	Qendër për Grumbullimin, Klasifikimin, Magazinimin e Përkohshëm të Mbeturinave Metalike, Plastike, Akumulatorëve të Përdorur dhe Mbeturinave Elektrike/Elektronike, si dhe Çmontimin e Automjeteve dhe Kamionëve Jashtë Përdorimit për Rikuperim të Materialeve
Lloji i veprimtarisë	Menaxhim i mbeturinave – grumbullim, klasifikim dhe magazinim i përkohshëm; depolitim dhe çmontim i automjeteve jashtë përdorimit. Operacionet ligjore R12/R13 zbatohen vetëm për kodet dhe kapacitetet e përfshira shprehimisht në licencën valide.
Faza e projektit	Operim (objekte ekzistuese, veprimtari në zhvillim)
Komuna	Lipjan
Zona kadastrale	Lipjan
Parcela kadastrale	P-71409044-01218-2 (nr. 1218-2)
Adresa	Rr. "Ibrahim Rugova", magjistrallja Prishtinë–Shtime (M-25), Lipjan
Koordinatat (sistemi KosovaRef01)	Y = 7 509 165.106; X = 4 708 876.373
Lartësia mbidetare	≈ 544 m

Të dhënat	Përmbajtja
Sipërfaqja e parcelës	2916 m ²
Sipërfaqja e ndërtuar (2 hangarë × 845 m ²)	1690 m ² (58.0 % e parcelës)
Sipërfaqja e lirë operative	1226 m ² (42.0 % e parcelës)
Kapaciteti i pranimit	2 000 t/vit – kapacitet maksimal i deklaruar, që konfirmohet me deklaratë të nënshkruar të aplikuesit, regjistra peshimi dhe kapacitetet e pajisjeve.
Numri i punonjësve	6
Orari i punës	08:00–17:00 (e hënë – e premte)
Ditë pune në vit	250
Destinimi i zonës sipas HZK Lipjan	Zonë komerciale / ekonomike

1.3. Të dhëna për hartuesit që kanë marrë pjesë në hartimin e Raportit të VNM-së

Raporti duhet të hartohet dhe nënshkruhet nga person i licencuar, me ekip të përshtatshëm për natyrën e projektit. Tabela në vijim identifikon hartuesin dhe dokumentin e licencës që duhet të jetë pjesë e dosjes së aplikimit.

Tabela 4. Të dhënat për hartuesin e licencuar të Raportit të VNM-së

Të dhënat	Përmbajtja
Personi juridik i licencuar	GeoSource Consulting Sh.p.k.
Adresa	Prishtinë, Republika e Kosovës
Telefoni	+383 44 800 098
Posta elektronike	dsc.rks@gmail.com
Licenca e lëshuar nga MMPHI	Kopja e licencës në Shtojcën A

Përbërja e ekipit profesional, kualifikimet dhe fushat e përgjegjësisë paraqiten në faqen e vërtetimit dhe të nënshkrimeve në pjesën hyrëse të raportit.

1.4. Baza ligjore dhe metodologjike e hartimit të raportit

Raporti është hartuar duke zbatuar kërkesat e mëposhtme, të cilat përbëjnë bazën e detyrueshme metodologjike:

- **Vlerësimi i ndikimit në mjedis:** Ligji Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis; UA (MMPHI) Nr. 04/2025 për përmbajtjen, metodologjinë dhe hartimin e raportit; UA (MMPHI) Nr. 11/2025 për informimin, pjesëmartjen dhe konsultimin e publikut; dhe UA (MMPHI) Nr. 03/2025 për licencimin e personave për hartimin e raporteve të VNM-së.
- **Mbrojtja e mjedisit dhe leja mjedisore:** Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, në versionin e konsoliduar, si dhe UA (MMPHI) Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, i ndryshuar dhe plotësuar me UA (MMPHI) Nr. 01/2025.
- **Ajri dhe zhurma:** Ligji Nr. 08/L-025 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja dhe aktet zbatuese për monitorimin e cilësisë së ajrit dhe vlerat kufitare; Ligji Nr. 02/L-102 për Mbrojtjen nga Zhurma.
- **Ujërat dhe mbeturinat:** Ligji Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës, në versionin e konsoliduar; Ligji Nr. 04/L-060 për Mbeturina, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 08/L-071 dhe ndryshimet e mëvonshme; si dhe aktet për katalogun, transportin dhe trajtimin e mbeturinave.

- **Natyra, toka dhe trashëgimia:** Ligji Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës, me ndryshimet në fuqi; Ligji Nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore, i ndryshuar me Ligjin Nr. 08/L-112; dhe Ligji Nr. 02/L-88 për Trashëgiminë Kulturore.
- **Planifikimi dhe ndërtimi:** Ligji Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor dhe Ligji Nr. 04/L-110 për Ndërtim, me ndryshimet dhe aktet zbatuese në fuqi.
- Shkarkimet dhe infrastruktura ujore: zbatohen Ligji nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës dhe UA (MMPHI) nr. 02/2022 për kushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura. Shkarkimi në kanalizim lejohet vetëm pas lidhjes së rregullt dhe pëlqimit të operatorit, ndërsa separatori i lëngjeve të lehta projektohet, instalohet dhe mirëmbahet sipas EN 858.
- **Siguria:** Ligji Nr. 08/L-261 për Mbrojtje nga Zjarri dhe Ligji Nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, në versionin e konsoliduar, së bashku me kërkesat e autoriteteve kompetente.
 - **UA (MMPHI) nr. 04/2025** – nënshkruar më 04.12.2025; përcakton përmbajtjen, metodologjinë dhe përputhshmërinë e raportit. Struktura e raportit ndjek Shtojcën I, vetëkontrolli është kryer sipas Shtojcës II (Lista e kontrollit), dhe dokumentacioni përcjellës është përgatitur sipas Shtojcës III.
 - Ligji nr. 04/L-060 për Mbeturina, teksti i konsoliduar i publikuar më 03.04.2026; përcakton përkufizimet, hierarkinë e menaxhimit, licencimin dhe operacionet e rikuperimit (Lista R) e të asgjësimit (Lista D).
 - **UA (MMPH) nr. 13/2013 për Katalogun Shtetëror të Mbeturinave** – përcakton strukturën e kodeve gjashtë-shifrore, metodologjinë e identifikimit të kodit (Hapi 1 – Hapi 4) dhe shënjimin e mbeturinave të rrezikshme me yll (*).
 - Për rrjedhat e veçanta zbatohen UA (MMPH) nr. 19/2012 për menaxhimin e automjeteve jashtë përdorimit dhe komponentëve të tyre; UA (MMPH) nr. 25/2014 për menaxhimin e mbeturinave të pajisjeve elektrike dhe elektronike; UA (MMPH) nr. 26/2014 për menaxhimin e mbeturinave nga bateritë dhe akumulatorët; UA nr. 05/2013 për menaxhimin e vajrave të përdorura dhe mbeturinave me vajra; UA (QRK) nr. 03/2021 për menaxhimin e mbeturinave të rrezikshme; dhe UA nr. 09/2014 për licencën e menaxhimit të mbeturinave.

Metodologjia e vlerësimit të ndikimeve është e bazuar në qasjen shkallë-pasoje (burim → shtegu i transmetimit → receptor), duke ndarë në mënyrë të veçantë faktet, supozimet, llogaritjet, rreziqet, gjetjet, rekomandimet dhe referencat ligjore. Llogaritjet e emetimeve të pluhurit bazohen në metodologjinë US EPA AP-42; llogaritjet e emetimeve nga djegia e karburantit bazohen në metodologjinë EMEP/EEA për makineri jashtë-rrugore; vlerësimi i propagimit të zhurmës bazohet në divergjencën gjeometrike hemisferike me korrigjime për zbutje atmosferike dhe ekranim, në përputhje me qasjen e ISO 9613-2.

1.5. Metodologjia dhe niveli i sigurisë së të dhënave

- Metodologjia kombinon burimet dokumentare, vrojtimin e lokacionit, analizën hapësinore dhe vlerësimin teknik. Elementet e mëposhtme zbatohen në mënyrë të integruar për çdo faktor mjedisor:
 - Integrimi i kufirit kadastral me ortofoto dhe hartat tematike kombëtare, me shënim të burimit, shkallës dhe kufizimeve të saktësisë.
 - Shqyrtimi i planimetrisë, skemës së zonimit të mbeturinave, skemës së drenazhimit dhe fletëve teknike të pajisjeve operative e mbrojtëse.
 - Vlerësimi burim-rrugë-receptor dhe klasifikimi i rëndësisë sipas madhësisë, shtrirjes, kohëzgjatjes, kthyeshmërisë dhe ndjeshmërisë së receptorit.
 - Zbatimi i hierarkisë shmangie-zvogëlim-restaurim-kompensim, i lidhur me masa, përgjegjësi, afate dhe monitorim adaptiv.

KONTROLL I DETYRUESHËM PARA OPERIMIT TË PLOTË

Para operimit të plotë dhe para pranimit ose depolutimit të mbeturinave të rrezikshme verifikohen dokumentacioni pronësor e kadastral, pëlqimet dhe licencat për kodet e operacionet e lejuara, platforma e papërshkueshme e depolutimit, separatori koalescent me valvul e kapacitet izolimi, depot me pëllgje mbajtëse, pajisjet e mbrojtjes nga zjarri dhe matjet bazë referuese. Çdo ndryshim material i kapacitetit, kodeve, operacioneve, zonimit, pajisjeve ose drenazhimit i nënshtrohet rishikimit paraprak të fushëveprimit dhe të kushteve ligjore.

1.6. Organizimi i procesit të VNM-së**1.6.1. Fushëveprimi**

Fushëveprimi përfshin tërë parcelën e projektit, rrugën e qasjes, zonat e pranimit, klasifikimit, magazinimit, depolutimit dhe çmontimit, receptorët përreth dhe ndikimet kumulative. Ai trajton përshtatjet përgatitore, operimin, mirëmbajtjen, incidentet, mbylljen dhe rehabilitimin e lokacionit.




Figura 2. Rrjedha e procedurës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis
Burimi: Përpunim i hartuesit sipas Ligjit Nr. 08/L-181 dhe UA (MMPHI) Nr. 04/2025

Mekanizmi i vlerësimit. Për secilin aktivitet identifikohet burimi, rruga e transmetimit dhe receptor. Kufiri i analizës zgjerohet kur ndikimi ndjek pellgun ujëmbledhës, rrugën e transportit, vijën e shikimit ose habitatin.

Kërkesat e projektit dhe masat. Ndryshimet e projektit kalojnë në kontroll formal. Nëse ndryshojnë kapaciteti, kodet e mbeturinave, operacionet R/D, pajisjet kryesore, zonimi ose drenazhimi, rishikohen fushëveprimi, kushtet e licencës dhe nevoja për vlerësim shtesë.

Verifikimi dhe evidenca. Mbahen harta e fushëveprimit, regjistri i receptorëve, lista e çështjeve, procesverbalet e konsultimit dhe matrica e mbylljes së të dhënave.

1.6.2. Qasja burim–rrugë–receptor

Qasja siguron që një aspekt të mos klasifikohet vetëm nga prania e burimit. Ndikimi ekziston kur burimi mund të arrijë një receptor përmes një rruge fizike ose sociale.

Mekanizmi i vlerësimit. Pluhuri kërkon burim, transport nga era dhe receptor; ndotja e ujit kërkon substancë, rrjedhje dhe lidhje hidrologjike; zhurma kërkon burim, përhapje dhe receptor; ndikimi ekologjik kërkon presion dhe specie/habitat të ndjeshëm.

Kërkesat e projektit dhe masat. Masat vendosen fillimisht te burimi, pastaj në rrugë dhe në fund te receptori. Kjo rrit efektivitetin dhe zvogëlon varësinë nga kompensimi.

Verifikimi dhe evidenca. Çdo masë lidhet me aspektin, receptorin, fazën, përgjegjësin, afatin, treguesin dhe kriterin e pranimit.

1.6.3. Klasifikimi i të dhënave

Të dhënat ndahen në të konfirmuara, orientuese dhe për verifikim. Ky klasifikim është i domosdoshëm sepse harta rajonale, vrojtimi i parcelës dhe projekti ekzekutiv kanë nivele të ndryshme saktësie.

Mekanizmi i vlerësimit. Një vlerë e konfirmuar ka burim, datë, koordinatë dhe metodë. Një vlerë orientuese përdoret për skringing, por jo për dimensionim. Një verifikim kritik mund të ndryshojë vendimin, mikro-vendosjen ose masën.

Kërkesat e projektit dhe masat. Projektimi nuk duhet të mbështetet në një të dhënë orientuese kur pasoja është e rëndësishme. Zbatohen supozime konservative deri në verifikim.

Verifikimi dhe evidenca. Regjistri shënon pronarin e të dhënës, metodën e verifikimit, afatin dhe ndikimin e mundshëm në raport.

1.7. Palët e interesit dhe komunikimi

1.7.1. Identifikimi i palëve

Palët përfshijnë pronarët dhe përdoruesit e tokës, banorët, bizneset përreth, Komunën e Lipjanit, MMPHI-në dhe inspektoratin, operatorin e ujësjellësit dhe kanalizimit, operatorët e licencuar të mbeturinave, shërbimet emergjente dhe organizatat me interes mjedisor.

Mekanizmi i vlerësimit. Rëndësia e palës përcaktohet nga ndikimi i mundshëm, përgjegjësia institucionale, njohuria lokale dhe aftësia për të ndikuar në projekt.

Kërkesat e projektit dhe masat. Informimi përshtatet sipas palës dhe fazës. Çështjet e sigurisë që lidhen me mbeturinat e rrezikshme, depolutimin, derdhjet, zjarrin dhe ujin e kontaminuar të reagimit komunikohen qartë, pa minimizim dhe pa krijuar alarm të pabazuar.

Verifikimi dhe evidenca. Mbahen lista e palëve, njoftimet, pjesëmarrja, pyetjet, përgjigjet dhe ndryshimet e projektit që rrjedhin nga konsultimi.

1.7.2. Mekanizmi i ankesave

Mekanizmi duhet të jetë i qasshëm, pa pagesë, konfidencial kur kërkohet dhe i përdorshëm edhe nga personat që nuk kanë qasje digjitale.

Mekanizmi i vlerësimit. Ankesa regjistrohet, klasifikohet, hetohet dhe mbyllet me përgjigje. Ankesat për siguri, ujë, dëmtim prone ose ndikim shëndetësor trajtohen me prioritet.

Kërkesat e projektit dhe masat. Përcaktohen afatet e pranimit, përgjigjes së parë, hetimit dhe mbylljes. Ankesa e përsëritur aktivizon rishikim të kontrollit operacional.

Verifikimi dhe evidenca. Regjistri ruan datën, çështjen, vendin, provat, përgjegjësin, masën, komunikimin dhe konfirmimin e mbylljes.

2. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT TË PROPOZUAR

2.1. Kategoria e projektit të propozuar

Projekti është veprimtari për menaxhimin e mbeturinave dhe i nënshtrohet shqyrtimit sipas Shtojcës 2, pika 12.5 të Ligjit nr. 08/L-181 për VNM: depo për ruajtjen e mbeturinave të hekurit dhe të metaleve të tjera, duke përfshirë skeletet metalike të automjeteve jashtë përdorimit. Fushëveprimi konkret përbëhet nga operacionet e mëposhtme:

- **Mbledhja dhe grumbullimi** – neni 4, par. 1.27 dhe neni 25 i Ligjit nr. 04/L-060: mbledhja dhe transportimi i mbeturinave, duke përfshirë klasifikimin paraprak në lloje.
- **Klasifikimi sipas lloji dhe kodifikimi** – ndarja fizike e fraksioneve dhe caktimi i kodit gjashtë-shifror sipas Katalogut Shtetëror të Mbeturinave (UA nr. 13/2013).
- **Magazinimi i përkohshëm** – neni 4, par. 1.43 dhe neni 32 i Ligjit nr. 04/L-060: ruajtja e sigurt dhe e përkohshme e mbeturinave në objekte të parapara për këtë qëllim.
- **Çmontimi i automjeteve dhe kamionëve jashtë përdorimit** – ndarja mekanike e automjetit në komponentë dhe fraksione materiale, përfshirë heqjen paraprake të lëngjeve dhe komponentëve të rrezikshëm (depolutimin).
- **Përgatitja për ripërdorim dhe për riciklim** – neni 4, par. 1.17, neni 30 dhe neni 31 i Ligjit nr. 04/L-060: kontrollim, pastrim, ngjeshje dhe paketim i fraksioneve për dorëzim tek operatorët e licencuar.

Operacionet e klasifikimit, ndarjes, presimit, paketimit, depolutimit dhe çmontimit përbëjnë përgatitje mekanike paraprake R12, ndërsa magazinimi para rikuperimit përbën R13. Pëlqimi mjedisor nuk e zëvendëson licencën valide për menaxhimin e mbeturinave; pranimi dhe trajtimi paraprak lejohet vetëm për kodet dhe operacionet e përfshira shprehimisht në licencë.

Veprimtaria kontribuon drejtpërdrejt në zbatimin e hierarkisë së menaxhimit të mbeturinave: ripërdorim → riciklim → rikuperim → asgjësim, duke rritur shkallën e rikuperimit të materialeve dhe duke reduktuar sasinë e mbeturinave që përfundojnë në deponi.

2.2. Përshkrim të punëve përgatitore për zbatimin e projektit

Projekti zhvillohet në objekte ekzistuese dhe në sipërfaqe të sistemuara paraprakisht. Nuk parashihet ndërtim i objekteve të reja, nuk parashihen gërmime, nuk parashihet ndryshim i konfiguracionit të terrenit dhe nuk parashihet zaptim i sipërfaqeve shtesë. Për këtë arsye, punët përgatitore kufizohen në përshtatje funksionale, sistemim dhe pajisje teknike brenda kufijve të parcelës kadastrale 1218-2.

Tabela 5. Punët përgatitore për zbatimin e projektit

Nr.	Puna përgatitore	Përshkrimi teknik	Sasia / njësia	Statusi
1	Sistemim dhe shënjim i zonave funksionale	Ndarja fizike dhe shënjimi horizontal i boksesh dhe zonave sipas kodit të mbeturinës; vendosje e tabelave identifikuese me kodin dhe emërtimin	1690 m ² të brendshme; 1226 m ² të jashtme	Për realizim
2	Verifikim i papërshkueshmërisë së sipërfaqeve	Inspektim vizual dhe riparim i çarjeve në shtresën e asfaltit/betonit; verifikim i pjerrësive drejt kanaleve të grumbullimit	1 226 m ² sipërfaqe e jashtme	Për realizim
3	Instalim i separatorit koalescent vaj/ujë	Separator klasa I sipas EN 858, NS 15, me rezervuar rërë-baltë ≥ 1 500 l, kapacitet mbajtjeje vaji ≥ 200 l dhe alarm të nivelit të vajit	1 njësi; sipërfaqe e ndikimit 1000 m ²	Masë e detyrueshme
4	Ndërtim i platformës për depolutim	Sipërfaqe e papërshkueshme, e rezistente ndaj vajrave dhe karburantit, me pellg mbajtës periferik dhe kanal grumbullimi	60 m ²	Masë e detyrueshme

Nr.	Puna përgatitore	Përshkrimi teknik	Sasia / njësia	Statusi
5	Pajisje e depove për mbeturina të rrezikshme	Rafte dhe pëllgje mbajtëse me vëllim $\geq 110\%$ të enës më të madhe; kontejner acid-rezistent për akumulatorë; ventilim natyror	30 m ² (vajra) + 20 m ² (akumulatorë)	Masë e detyrueshme
6	Verifikim i papërshkueshmërisë së gropës septike	Test i papërshkueshmërisë; përcaktimi i vëllimit të dobishëm dhe i frekuencës së zbrazjes në përputhje me vëllimin e gjeneruar (45 m ³ /vit)	1 njësi	Masë e detyrueshme
7	Pajisje kundër zjarrit	Fikëse zjarri me pluhur ABC 6 kg (1 njësi / 150 m ² sipërfaqe e brendshme) dhe CO ₂ 5 kg për panelin elektrik; sinjalistikë dhe plan evakuimi	≈ 12 njësi ABC brenda + 4 jashtë + 2 njësi CO ₂	Për realizim / plotësim
8	Peshojë dhe pikë kontrolli në hyrje	Peshim i mjeteve në hyrje dhe në dalje për regjistrimin e sasive; kontroll vizual dhe verifikim i fletë-përcjellës	1 pikë kontrolli	Për realizim
9	Sinjalistikë dhe shënjim i sigurisë	Sinjalistikë horizontale dhe vertikale për qarkullim; shenja të detyrueshme të mbrojtjes personale; shenja të rrezikshmërisë sipas kodit	sipas planit të sinjalistikës	Për realizim
10	Trajnim fillestar i personelit	Trajnim për identifikimin dhe kodifikimin e mbeturinave, procedurat e depolimit, veprimin në rast derdhjeje dhe SHSP	6 punonjës	Për realizim

Duke qenë se punët përgatitore kufizohen brenda kufijve të parcelës dhe nuk përfshijnë gjurmime, demolime apo ndërtime të reja, gjenerimi i mbeturinave gjatë fazës përgatitore vlerësohet i papërfillshëm dhe kufizohet në ambalazhe të pajisjeve të instaluar (kodet 15 01 01, 15 01 02 dhe 15 01 04), të cilat dorëzohen për riciklim. Nuk parashihen shkarkime në ujë, tokë apo ajër gjatë fazës përgatitore, përveç pluhurit të rastësishëm gjatë punimeve të riparimit të sipërfaqeve.

2.3. Përshkrimin e karakteristikave kryesore të funksionimit të projektit

Objekti funksionon si njësi e centralizuar për pranimin, identifikimin, klasifikimin dhe magazinimin e përkohshëm të fraksioneve të riciklueshme, si dhe për çmontimin e automjeteve dhe kamionëve jashtë përdorimit me qëllim rikuperimin e materialeve dhe të pjesëve të ripërdorshme. Të gjitha operacionet zhvillohen brenda dy hangarëve ekzistues dhe në hapësirën e jashtme operative të parcelës, mbi sipërfaqe të papërshkueshme.

2.3.1. Organizimi funksional i lokacionit

Lokacioni është i organizuar në tri njësi funksionale të ndara, me qëllim parandalimin e përzierjes së fraksioneve dhe izolimin e mbeturinave të rrezikshme nga mbeturinat jo të rrezikshme:

Tabela 6. Organizimi funksional dhe bilanci i sipërfaqeve të lokacionit


Njësia funksionale	Zona	Sipërfaqja (m ²)
Hangari 1 – 845 m²		
	Zona e pranimit, kontrollit dhe regjistrimit	145
	Boks për metale ferroze	250
	Boks për metale joferroze	80
	Boks për plastikë	120
	Zona e presimit dhe paketimit	100

Njësia funksionale	Zona	Sipërfaqja (m ²)
	Korridore dhe qarkullim i brendshëm	150
Hangari 2 – 845 m²		
	Zona e çmontimit (2 pozicione pune)	180
	Zona e depolutimit – heqja e lëngjeve (sipërfaqe e papërshkueshme me pellg mbajtës)	60
	Depo për akumulatorë (kontejner acid-rezistent, i mbuluar)	20
	Depo për vajra dhe lëngje të rrezikshme (pellg mbajtës ≥ 110 %)	30
	Depo për mbeturina të pajisjeve elektrike dhe elektronike (MPEE)	60
	Rafte për pjesë të çmontuara dhe pjesë të ripërdorshme	250
	Depo për gomat e vjetra	60
	Zona për qelqin	25
	Korridore dhe qarkullim i brendshëm	160
Hapësira e jashtme – 1226 m²		
	Zonë pritjeje për automjete jashtë përdorimit para depolutimit (sipërfaqe e papërshkueshme)	300
	Manovrim dhe qarkullim i mjeteve transportuese	700
	Zona e kontrollit në hyrje dhe peshoja	50
	Vendqëndrim i kontejnerit të mbeturinave komunale (1.1 m ³)	10
	Sipërfaqe të gjelbra dhe kufij të parcelës	166
TOTAL		2916

Bilanci i sipërfaqeve: 845 m² (Hangari 1) + 845 m² (Hangari 2) + 1226 m² (hapësirë e jashtme) = 2916 m², i cili korrespondon me sipërfaqen totale të parcelës kadastrale.

ORGANIZIMI FUNKSIONAL I LOKACIONIT - SKEMË E ZONIMIT

Parcela 1218-2, ZK Lipjan · sipërfaqe totale 2916 m² · e ndërtuar 1690 m² · e lirë operative 1226 m²



Skemë funksionale - jo në përpjesë. Përpjesa dhe kuotat e sakta paraqiten në planin e rievimit gjeodezik (Shtojca 12).

Figura 3. Organizimi funksional i lokacionit – skemë e zonimit sipas fraksioneve dhe kodeve të mbeturinave

2.3.2. Karakteristikat teknike të funksionimit

Funksionimi bazohet në pranimin e kontrolluar, ndarjen sipas kodit, magazinimin e veçuar dhe çmontimin në zona të dedikuara. Tabela në vijim paraqet kapacitetet dhe parametrat teknikë që përdoren për dimensionimin e masave dhe që verifikohen gjatë operimit.

Tabela 7. Karakteristikat kryesore teknike të funksionimit të projektit

Karakteristika	Vlera / përshkrimi
Kapaciteti i pranimi	2000 t/vit
Kapaciteti i magazinimit të njëkohshëm	≈ 180 t (fraksione jo të rrezikshme) + ≈ 12 t (fraksione të rrezikshme)
Koha maksimale e magazinimit	6 muaj për mbeturina jo të rrezikshme; 3 muaj për mbeturina të rrezikshme
Automjete jashtë përdorimit të çmontuara	130 njësi/vit (35 automjete të rënda + 95 automjete të lehta)
Pozicione pune të çmontimit	2 (të pajisura me vegla pneumatike dhe ngritës)
Presë hidraulike për ngjeshje dhe paketim	1 njësi, fuqi e instaluar 15 kW
Manipulator teleskopik / karrocë ngritëse	1 njësi, me motor dizel
Konsumi i energjisë elektrike	≈ 33.4 MWh/vit

Karakteristika	Vlera / përshkrimi
Konsumi i ujit	≈ 90 m ³ /vit (vetëm sanitar dhe mirëmbajtje)
Konsumi i karburantit (dizel)	≈ 2400 l/vit
Ujëra teknologjike	Nuk gjenerohen – procesi është plotësisht i thatë, mekanik
Procese termike, kimike ose biologjike	Nuk kryhen
Numri i punonjësve	6 (1 menaxher; 1 përgjegjës për mjedis dhe SHSP; 4 punonjës operativë)
Orari i punës	08:00–17:00 (e hënë – e premte); nuk parashihet punë nate



Figura 4. Pamje e hapësirës së jashtme operative të lokacionit – sipërfaqe të asfaltuara, zona e pritjes për automjete jashtë përdorimit dhe hangarët ekzistues



Figura 5. Kamionë jashtë përdorimit në zonën e pritjes para depolutimit (majtas) dhe organizimi i qarkullimit të brendshëm (djathtas)

2.4. Përshkrimin detal të procesit të planifikimit të prodhimit, duke filluar nga hyrja e lëndëve të para deri te produkti përfundimtar

Veprimtaria nuk është veprimtari prodhuese në kuptimin klasik. “Lënda e parë” e procesit është mbeturina e pranuar, ndërsa “produkti përfundimtar” është fraksioni i klasifikuar, i kodifikuar, i ngjeshur dhe i paketuar, i cili dorëzohet tek operatorët e licencuar për riciklim ose rikuperim, si edhe pjesa e ripërdorshme e automjeteve, e cila del nga statusi i mbeturinës pas kontrollimit dhe pastrimit, në përputhje me nenin 4, par. 1.17 të Ligjit nr. 04/L-060 (përgatitja për ripërdorim).

Procesi zhvillohet në shtatë faza të njëpasnjëshme, të paraqitura në figurën në vijim.




Figura 6. Skema e procesit teknologjik – shtatë fazat e procesit dhe operacionet përkatëse sipas Listës R

2.4.1. Faza 1 – Pranimi, kontrolli dhe regjistrimi

- Mjeti transportues peshohet në hyrje; mbeturina identifikohet vizualisht dhe verifikohet kundrejt fletë-përcjellëses së mbeturinave dhe dokumentacionit të prejardhjes.
- Për automjetet jashtë përdorimit verifikohet dokumentacioni i pronësisë dhe i çregjistrimit; lëshohet certifikatë e shkatërrimit sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.
- Ngarkesat që nuk përputhen me kodet e lejuara, ose që përmbajnë fraksione të papranueshme (mbeturina medicinale, azbest, materiale radioaktive, eksplozivë, mbeturina të biodegradueshme), refuzohen dhe kthehen tek zotëruesi; refuzimi regjistrohet me shkrim.
- Të dhënat regjistrohen në ditarin e mbeturinave: data, zotëruesi, kodi gjashtë-shifror, sasia në ton, targa e mjetit dhe numri i fletë-përcjellëses.

2.4.2. Faza 2 – Klasifikimi dhe kodifikimi sipas Katalogut Shtetëror të Mbeturinave

Kodifikimi kryhet duke zbatuar metodologjinë e përcaktuar në nenet 3–6 të UA (MMPH) nr. 13/2013:

Tabela 8. Metodologjia e kodifikimit të mbeturinave sipas UA (MMPH) nr. 13/2013

Hapi	Përmbajtja metodologjike sipas UA nr. 13/2013	Zbatimi në lokacionin e projektit
Hapi 1	Identifikimi sipas burimit gjenerues të mbeturinës – kapitujt 01 deri 12 dhe 17 deri 20; përzgjedhja e kodit gjashtë-shifror	Zbatohet për skrapin nga ndërtimtaria dhe demolimi (kapitulli 17), për mbeturinat nga trajtimi fiziko-mekanik i metaleve (kapitulli 12) dhe për fraksionet e mbledhura ndaras nga amvisëritë dhe subjektet komerciale (kapitulli 20)
Hapi 2	Identifikimi sipas llojit të mbeturinës – kapitujt 13, 14 dhe 15, kur kodi nuk mund të gjendet sipas burimit	Zbatohet për vajrat dhe karburantet (kapitulli 13), për ambalazhet, absorbuesët dhe lecat e kontaminuara (kapitulli 15)
Hapi 3	Identifikimi në kapitullin 16 – mbeturinat e paspecifikuara ndryshe në listë	Zbatohet për automjetet jashtë përdorimit dhe komponentët e tyre (16 01), për mbeturinat nga pajisjet elektrike dhe elektronike (16 02) dhe për bateritë dhe akumulatorët (16 06)
Hapi 4	Përdorimi i kodeve që përfundojnë me 99 vetëm nëse asnjë kod tjetër nuk aplikohet	Nuk aplikohet – për të gjitha fraksionet është identifikuar kod specifik
Rregull i veçantë	Mbeturinat e paketuara të grumbulluara ndaras klasifikohen sipas 15 01 dhe jo sipas 20 01 (neni 3, par. 1.4)	Zbatohet: ambalazhet e pranuar si fraksion i ndarë klasifikohen me 15 01 01, 15 01 02 dhe 15 01 10*
Rregull i veçantë	Çdo mbeturinë e shënuar me yll (*) konsiderohet e rrezikshme (neni 2, par. 3.4)	Zbatohet: të gjitha kodet e rrezikshme janë shënuar me (*) dhe menaxhohen sipas regjimit të mbeturinave të rrezikshme

2.4.3. Faza 3 – Çmontimi i automjeteve dhe kamionëve jashtë përdorimit

- Automjeti zhvendoset nga zona e pritjes në pozicionin e punës brenda Hangarit 2, mbi sipërfaqe të papërshekueshme.
- Hiqen pjesët e ripërdorshme (motorë, transmise, ura, pjesë të karrocërisë, elemente elektrike funksionale), të cilat kontrollohen, pastrohen dhe etiketohen për ripërdorim.
- Ndahen komponentët sipas materialit përbërës: metale ferroze, metale joferroze, plastikë, qelq, gomë dhe tekstil.
- Çmontimi kryhet manualisht dhe me vegla pneumatike; nuk aplikohet shtypje, grimcim (shredding), prerje me flakë të hapur brenda objektit, apo ndarje kimike e materialeve.

2.4.4. Faza 4 – Depolutimi: heqja e lëngjeve dhe komponentëve të rrezikshëm

Depolutimi është faza kritike mjedisore e procesit dhe kryhet para çdo operacioni tjetër mekanik ndaj automjetit, mbi platformën e dedikuar me pellg mbajtës. Renditja e heqjes është e paracaktuar dhe e detyrueshme:

Tabela 9. Renditja e detyrueshme e depolutimit dhe kodifikimi i fraksioneve të rrezikshme

Nr.	Komponenti / lëngu i hequr	Kodi sipas Katalogut	Ena e grumbullimit	Sasia (t/vit)
1	Akumulatori i plumbit	16 06 01*	Kontejner acid-rezistent, i mbuluar, me pellg mbajtës	5.3
2	Mbetje karburanti; kodi caktohet sipas llojit faktik	13 07 01* / 13 07 02* / 13 07 03*	Enë metalike hermetike, të mbrojtura kundër shkarkimit statik	0.7
3	Vaji i motorit, i transmisionit dhe lubrifikantët	13 02 05*	Depozitë e dyfishtë, mbi pellg mbajtës $\geq 110\%$	4.2
4	Vaji hidraulik	13 01 10*	Depozitë e veçantë, e etiketuar	1.0
5	Lëngu antifrizë (ftohës)	16 01 14*	Enë polietileni, e etiketuar	1.0
6	Lëngu i frenave	16 01 13*	Enë e veçantë, e etiketuar	0.4
7	Filtra vaji; filtrat e karburantit kodifikohen sipas përbërjes dhe kontaminimit faktik	16 01 07*	Enë hermetike me kapak, mbi tabaka kullimi	1.1
8	Qesat e ajrit dhe komponentët piroteknikë	16 01 10*	Kuti metalike e izoluar, e mbrojtur nga goditjet	0.3
9	Komponentë tjerë të rrezikshëm (kondensatorë, kontakte, ndërprerës)	16 01 21*	Enë e veçantë e etiketuar	0.8
	TOTAL FRAKSIONE TË RREZIKSHME NGA DEPOLUTIMI			14.8

Pas përfundimit të plotë të depolutimit, automjeti riklasifikohet nga kodi 16 01 04 në kodin 16 01 06 vetëm pasi të jetë verifikuar dhe dokumentuar largimi i të gjitha lëngjeve dhe komponentëve të rrezikshëm sipas procedurës dhe katalogut. Ky ndryshim i klasifikimit regjistrohet në ditarin e mbeturinave dhe është kusht paraprak për operacionet mekanike të mëtejme.*



Figura 7. Rafte për magazinimin e pjesëve të çmontuara dhe depozita për vajra e lëngje teknike brenda Hangarit 2

2.4.5. Faza 5 – Magazinimi i përkohshëm i ndarë

- Fraksionet magazinohen në bokse dhe enë të dedikuara, të identifikuara me tabelë që përmban kodin gjashtë-shifror, emërtimin sipas Katalogut dhe klasën e rrezikshmërisë.
- Mbeturinat e rrezikshme magazinohen ekskluzivisht brenda objektit, mbi pellgje mbajtëse me vëllim $\geq 110\%$ të enës më të madhe, të mbrojtura nga reshjet.
- Ndalohet përzjerja e fraksioneve me kod të ndryshëm dhe ndalohet përzjerja e mbeturinave të rrezikshme me mbeturina jo të rrezikshme.
- Lartësia maksimale e stivimit të fraksioneve metalike është 1.8 m, me qëllim garantimin e stabilitetit dhe qasjen për fikjen e zjarrit.

2.4.6. Faza 6 – Presimi, paketimi dhe përgatitja për transport

- Fraksionet metalike dhe plastike ngjeshen me presë hidraulike dhe formohen në bala të standardizuara, me qëllim reduktimin e vëllimit dhe optimizimin e transportit.
- Balat etiketohen me kodin e mbeturinës, masën neto dhe datën e formimit.
- Presimi është operacion mekanik i thatë; nuk përdoret ujë, nuk aplikohet nxehtësi dhe nuk shtohen aditivë kimikë.

2.4.7. Faza 7 – Transporti dhe dorëzimi tek operatorët e licencuar

- Dorëzimi kryhet vetëm tek operatorë të pajisur me licencë valide të lëshuar nga MMPHI për kodin përkatës të mbeturinës.
- Transporti i mbeturinave të rrezikshme kryhet me mjete të autorizuara, në përputhje me kërkesat e ADR-së, të shoqëruar me fletë-përcjellëse.
- Kopja e konfirmuar e fletë-përcjellëses arkivohet dhe përbën dëshmi të mbylljes së zinxhirit të kujdestarisë (chain of custody).

2.4.8. Bilanci material i procesit

Bilanci material i çmontimit të automjeteve jashtë përdorimit është hartuar për sasinë vjetore të kodit 16 01 04* dhe është i mbyllur, pra suma e fraksioneve daluese është e barabartë me masën hyrëse.




Figura 8. Bilanci material i çmontimit të automjeteve jashtë përdorimit (kodi 16 01 04*)

Shënim: rrjedha e karburantit klasifikohet sipas përbërjes faktike me kodin 13 07 01*, 13 07 02* ose 13 07 03*; paraqitja grafike nuk paracakton llojin e karburantit.

2.5. Paraqitja e llojit dhe sasisë së burimeve të nevojshme

Veprimtaria karakterizohet nga konsum i ulët i burimeve. Nuk përdoren lëndë të para primare, nuk përdoren reagentë kimikë, nuk përdoret ujë në procesin teknologjik dhe nuk përdoret energji termike. Nuk magazinohen lëndë të rrezikshme si lëndë e parë; lëndët e rrezikshme që paraqiten në lokacion janë ekskluzivisht fraksione mbeturinash të hequra nga automjetet gjatë depolimit, të përshkruara në nënkapitullin 7.2.

2.5.1. Energjia elektrike

Energjia elektrike përdoret për pajisjet mekanike, ndriçimin dhe shërbimet ndihmëse, pa proces termik ose shkrirje. Tabela në vijim jep bilancin e vlerësuar të konsumit dhe pikat kryesore ku mund të arrihet kursim.

Tabela 10. Bilanci i konsumit të energjisë elektrike

Konsumatori	Baza e llogaritjes	Konsumi (MWh/vit)
Ndriçim i brendshëm i dy hangarëve	1 690 m ² × 5 W/m ² × 2 000 h	16.9
Presë hidraulike për paketim	15 kW × 500 h	7.5
Pajisje çmontimi, kompresor pneumatik	5 kW × 800 h	4.0
Ndriçim i jashtëm dhe sistem CCTV	1.0 kW × 2 000 h	2.0
Zyra, administratë, ngrohje elektrike lokale	vlerësim	3.0
TOTAL		33.4

Furnizimi sigurohet nga rrjeti publik i distribuimit, përmes panelit shpërndarës ekzistues. Nuk parashihet grup elektrogjen i përhershëm; në rast nevojë për furnizim rezervë, do të aplikohet grup i lëvizshëm me pellg mbajtës nën rezervuarin e karburantit.

2.5.2. Uji

Uji përdoret kryesisht për nevoja sanitare, pastrim të kontrolluar dhe masa kundër pluhurit. Tabela në vijim përmbledh sasitë e pritshme dhe shërben si bazë për kontrollin e furnizimit dhe të shkarkimeve.

Tabela 11. Bilanci i konsumit të ujit

Përdorimi	Baza e llogaritjes	Konsumi (m³/vit)
Nevoja sanitare të personelit	6 punonjës × 30 l/ditë × 250 ditë	45
Pastrim dhe mirëmbajtje e sipërfaqeve dhe pajisjeve	vlerësim operativ	40
Rimbushje e rezervës kundër zjarrit dhe humbje	vlerësim	5
TOTAL		90

Furnizimi sigurohet nga rrjeti publik i ujësjellësit, i cili mbulon zonën komerciale. Në parcelë ndodhet edhe një pus i hapur ekzistues, i cili shfrytëzohet ekskluzivisht si pikë monitorimi e cilësisë së ujërave nëntokësore dhe nuk shfrytëzohet si burim furnizimi. Nuk gjenerohen ujëra teknologjike.

2.5.3. Karburanti dhe materialet shpenzuese

Karburantet dhe materialet shpenzuese mund të krijojnë rrezik vetëm nëse magazinohen ose përdoren pa mbajtje sekondare. Tabela në vijim paraqet llojet, sasitë orientuese dhe kushtet e ruajtjes së sigurt.

Tabela 12. Materialet shpenzuese dhe kushtet e magazinimit

Materiali	Sasia vjetore	Përdorimi	Kushtet e magazinimit
Karburant dizel	≈ 2400 l	Manipulator teleskopik / karrocë ngritëse	Furnizim i jashtëm nga pika e karburantit; nuk magazinohet në lokacion
Vaj hidraulik dhe lubrifikantë (të rinj)	≈ 120 l	Mirëmbajtja e presës hidraulike dhe e manipulatorit	Në original, brenda objektit, mbi pellg mbajtës
Absorbues (rërë kuarci, granulat mineral)	≈ 300 kg	Mbulimi i derdhjeve aksidentale	Kontejner i mbuluar, pranë pikave të rrezikut
Materialet paketime (teli, rripa, fletë PE)	≈ 500 kg	Lidhja dhe paketime i balave	Depo e thatë
Pajisje mbrojtëse personale (PMP)	sipas nevojës	Doreza, syze, mbrojtje respiratore, veshje, mbathje sigurie	Depo e dedikuar në zyrë

2.5.4. Burimet natyrore

Projekti nuk shfrytëzon burime natyrore dhe nuk zaptin tokë të re. Brenda parcelës ekzistojnë rreth 1.690 m² objekte, rreth 1.060 m² sipërfaqe operative të asfaltuara/betonuara dhe rreth 166 m² sipërfaqe të gjelbra. Këto të fundit ruhen, ndahen fizikisht dhe përjashtohen nga pranimi, manipulimi dhe magazinimi i mbeturinave.

2.6. Vlerësimin e gjenerimit të llojit dhe sasisë së mbeturinave, emetimeve gjatë procesit teknologjik

Ky nënkapitull, së bashku me nënkapitullin 2.7, përbën përgjigjen e drejtpërdrejtë ndaj kërkesës së Komisionit për VNM (ref. 26/3238/522/DMM) për identifikimin e kodeve sipas Katalogut Shtetëror të Mbeturinave dhe të operacioneve që u kryhen këtyre mbeturinave.

2.6.1. Klasifikimi i mbeturinave të pranuar sipas Katalogut Shtetëror të Mbeturinave

Tabela në vijim paraqet regjistrin e plotë të kodeve të mbeturinave që pranohen në lokacion, sipas UA (MMPH) nr. 13/2013. Emërtimet janë riprodhuar fjalë për fjalë sipas Shtojcës I të Udhëzimit Administrativ, me qëllim që të mundësohet verifikimi i drejtpërdrejtë nga organi shqyrtues. Sasitë paraqesin kapacitetin maksimal vjetor të pranimi, të derivuar nga kapacitetet reale të lokacionit (sipërfaqja e boksesh, lartësia e stivimit dhe numri i qarkullimeve në vit).

Tabela 13. Regjistri i kodeve të mbeturinave që pranohen në lokacion, sipas UA (MMPH) nr. 13/2013

Nr.	Kodi	Emërtimi sipas Katalogut Shtetëror të Mbeturinave	Klasifikimi	Sasia (t/vit)	Burimi / prejardhja
1	16 01 04*	Automjetet e vjetra	e rrezikshme	375	Automjete dhe kamionë jashtë përdorimit, të papastruara nga lëngjet dhe komponentët e rrezikshëm
2	16 01 06	Automjetet jashtë përdorimit që nuk përmbajnë lëngje apo komponente tjera të rrezikshme	jo e rrezikshme	40	Automjete të depolutuara paraprakisht nga operatorë të autorizuar
3	17 04 05	Hekuri dhe çeliku	jo e rrezikshme	820	Skrap ferroz nga ndërtimtaria, demolimi dhe subjektet ekonomike
4	20 01 40	Metalet	jo e rrezikshme	320	Fraksione metalike të mbledhura ndaras nga amvisëritë dhe subjektet komerciale
5	12 01 01	Tallashi dhe thërmijat metalike që përmbajnë hekur	jo e rrezikshme	70	Punishte mekanike dhe metalpunuese (pa përmbajtje vajrash)
6	17 04 01	Bakri, bronzi, tunxhi	jo e rrezikshme	35	Instalime, kabllo, pjesë mekanike
7	17 04 02	Alumini	jo e rrezikshme	45	Profile, radiatorë, pjesë automjetesh
8	17 04 07	Metalet e përziera	jo e rrezikshme	40	Fraksione të përziera metalike
9	17 04 11	Kabllo, tjera nga ato të përmendura në 17 04 10	jo e rrezikshme	25	Kabllo bakri/alumini pa bitumen dhe pa substanca të rrezikshme
10	15 01 02	Ambalazh plastike	jo e rrezikshme	30	Paketime industriale dhe komerciale
11	17 02 03	Plastika	jo e rrezikshme	25	Profile, tuba, elemente plastike ndërtimore
12	20 01 39	Plastika	jo e rrezikshme	25	Fraksione plastike të mbledhura ndaras
13	16 02 14	Pajisjet tjera për hudhje, tjera nga ato të përmendura në 16 02 09 deri 16 02 13	jo e rrezikshme	30	MPEE pa komponentë të rrezikshëm
14	20 01 36	Pajisjet elektrike dhe elektronike për hudhje, tjera nga ato të përmendura në 20 01 21, 20 01 23 dhe 20 01 35	jo e rrezikshme	15	MPEE nga amvisëritë

Nr.	Kodi	Emërtimi sipas Katalogut Shtetëror të Mbeturinave	Klasifikimi	Sasia (t/vit)	Burimi / prejardhja
15	16 02 13*	Pajisjet për hudhje që përmbajnë komponentë tjerë të rrezikshëm, tjera nga ato të përmendura në 16 02 09 deri 16 02 12	e rrezikshme	8	MPEE me komponentë të rrezikshëm
16	20 01 35*	Pajisjet elektrike dhe elektronike për hudhje, tjera nga ato të përmendura në 20 01 21 dhe 20 01 23 që përmbajnë komponentë të rrezikshëm	e rrezikshme	5	MPEE nga amvisëritë me komponentë të rrezikshëm
17	16 06 01*	Bateritë e plumbit	e rrezikshme	25	Akumulatorë të përdorur nga automjete dhe pajisje
18	20 01 33*	Bateritë dhe akumulatorët e përfshirë në 16 06 01, 16 06 02 ose 16 06 03 dhe bateritë dhe akumulatorët e pandarë	e rrezikshme	3	Bateri të mbledhura ndaras
19	16 01 03	Gomat e vjetra	jo e rrezikshme	40	Automjete dhe kamionë
20	15 01 01	Ambalazh letre dhe kartoni	jo e rrezikshme	10	Paketime
21	20 01 01	Letër dhe karton	jo e rrezikshme	5	Fraksione të mbledhura ndaras
22	16 01 20	Qelqi	jo e rrezikshme	9	Qelq nga automjete
		TOTAL – mbeturina jo të rrezikshme		1584	79.2 % e sasisë totale
		TOTAL – mbeturina të rrezikshme (*)		416	20.8 % e sasisë totale
		KAPACITETI TOTAL I PRANIMIT		2000	

Shënim metodologjik: kodi 17 04 05 “Hekuri dhe çeliku” aplikohet vetëm për skrapin ferroz që rrjedh nga ndërtimtaria dhe demolimi (kapitulli 17). Metalet ferroze që rrjedhin nga çmontimi i automjeteve jashtë përdorimit kodifikohen me 16 01 17 “Metale ferore” (kapitulli 16), dhe metalet joferroze me 16 01 18 “Metale joferroze”. Në versionin paraprak të raportit kodi 17 04 05 ishte aplikuar gabimisht edhe për fraksionet nga çmontimi; kjo është korrigjuar.

2.6.2. Mbeturinat e gjeneruara nga çmontimi i automjeteve jashtë përdorimit

Çmontimi i sasisë vjetore të kodit 16 01 04* (375 t/vit, përkatësisht 130 njësi) gjeneron fraksionet e mëposhtme. Përbërja materiale është përcaktuar duke ponderuar përbërjen tipike të automjeteve të rënda (74.7 % e masës hyrëse) dhe të automjeteve të lehta (25.3 %), sipas të dhënave të pranuar në literaturën teknike për çmontimin e automjeteve jashtë përdorimit.

Tabela 14. Bilanci material dhe kodifikimi i fraksioneve nga çmontimi i automjeteve jashtë përdorimit (kodi 16 01 04*)

Nr.	Kodi	Emërtimi sipas Katalogut Shtetëror të Mbeturinave	Klasifikimi	Pjesa (%)	Sasia (t/vit)
1	16 01 17	Metale ferore	jo e rrezikshme	75.47	283.0
2	16 01 18	Metale joferore	jo e rrezikshme	6.50	24.4
3	16 01 19	Plastika	jo e rrezikshme	6.27	23.5
4	16 01 03	Gomat e vjetra	jo e rrezikshme	4.50	16.9
5	16 01 20	Qelqi	jo e rrezikshme	1.88	7.0
6	16 06 01*	Bateritë e plumbit	e rrezikshme	1.42	5.3
7	13 02 05*	Vajra motori, ingranazhesh/dhëmbzorët dhe lubrifikues të pa kloruar me bazë minerale	e rrezikshme	1.12	4.2
8	13 01 10*	Vajrat hidraulike të pakloruara me bazë minerale	e rrezikshme	0.27	1.0
9	16 01 14*	Lëngje antingrirës që përmbajnë substanca të rrezikshme	e rrezikshme	0.27	1.0
10	16 01 13*	Lëngje frenash	e rrezikshme	0.11	0.4
11	13 07 01* / 13 07 02* / 13 07 03*	Mbetje karburanti (dizel/mazut, benzinë ose karburante të tjera); kodë caktohet sipas llojit faktik	e rrezikshme	0.19	0.7
12	16 01 07*	Filtra vaji	e rrezikshme	0.29	1.1
13	16 01 21*	Përbërës të rrezikshëm, tjerë nga ato të përmendura në 16 01 07 deri 16 01 11, 16 01 13 dhe 16 01 14	e rrezikshme	0.21	0.8
14	16 01 10*	Komponente shpërthyes (p.sh. qese ajri)	e rrezikshme	0.08	0.3
15	16 01 12	Tampone frenash, tjera nga ato të përmendura në 16 01 11	jo e rrezikshme	0.24	0.9
16	16 01 22	Komponentet tjerë të paspecifikuara	jo e rrezikshme	1.20	4.5
		TOTAL – fraksione jo të rrezikshme		96.06	360.2
		TOTAL – fraksione të rrezikshme (*)		3.96	14.8
		MASA HYRËSE = MASA DALËSE (bilanc i mbyllur)		100.00	375.0

Sasia prej 40 t/vit e kodit 16 01 06 (automjete të depolituara paraprakisht) gjeneron të njëjtat fraksione jo të rrezikshme në proporcion të përafërt, pa fraksione të rrezikshme lëngëzore, dhe është përfshirë në bilancin e përgjithshëm të fraksioneve daluese (Tabela e bilancit të përgjithshëm).

2.6.3. Mbeturinat e gjeneruara nga funksionimi i objektit

Përveç fraksioneve që rrjedhin nga procesi, funksionimi i objektit gjeneron sasi të kufizuara mbeturinash të veta, të cilat identifikohen dhe menaxhohen në mënyrë të ndarë:

Tabela 15. Mbeturinat e gjeneruara nga funksionimi i objektit (jo nga procesi teknologjik)

Nr.	Kodi	Emërtimi sipas Katalogut Shtetëror të Mbeturinave	Klasifikimi	Sasia (t/vit)	Burimi	Destinacioni
1	20 03 01	Mbeturina e përziera komunale	jo e rrezikshme	1.2	Aktiviteti i personelit (6 punonjës)	Kontejner 1.1 m ³ , KRM 'Pastrimi'
2	20 03 04	Ujëra dhe llumra nga gropa septike	jo e rrezikshme	≈ 45.0	Ujëra sanitare: 45 m ³ /vit; për bilancin masor përdoret dendësi indikative 1.0 t/m ³	Operator i licencuar, me autocisternë; sasia dhe frekuenca provohen me fatura/fletë-përcjellëse
3	15 01 01	Ambalazh letre dhe kartoni	jo e rrezikshme	0.3	Paketime nga furnizimi i pajisjeve dhe materialeve	Riciklim
4	15 02 02*	Absorbuesit, filterat nga materiali, lekat për fshirje dhe veshjet mbrojtëse të kontaminuara me substanca të rrezikshme	e rrezikshme	0.5	Mbulimi i derdhjeve, mirëmbajtja e pajisjeve	Operator i licencuar për mbeturina të rrezikshme
5	15 01 10*	Ambalazhe që përmbajnë ose janë të kontaminuara me substanca të rrezikshme	e rrezikshme	0.8	Enë të zbrazura të vajrave dhe lëngjeve teknike	Operator i licencuar për mbeturina të rrezikshme
6	13 05 01*	Pjesë të ngurta nga seperatorët ujë/vaj	e rrezikshme	0.3	Mirëmbajtja e separatorit koalescent	Operator i licencuar për mbeturina të rrezikshme
7	13 05 02*	Llumrat nga ndarja ujë/vaj	e rrezikshme	0.4	Mirëmbajtja e separatorit koalescent	Operator i licencuar për mbeturina të rrezikshme
		TOTAL		48.5	nga të cilat të rrezikshme: 2.0 t/vit	

2.6.4. Bilanci i përgjithshëm i mbeturinave

Bilanci i mbeturinave lidh sasitë hyrëse me fraksionet dalëse dhe me destinacionin e licencuar të secilës rrjedhë. Tabela në vijim përmbledh këtë bilanc dhe duhet të verifikohet çdo vit me regjistrat e peshimit dhe dokumentet e dorëzimit.

Tabela 16. Bilanci i përgjithshëm i mbeturinave në nivel objekti

Rrjedha	Sasia (t/vit)	Vërejtje
Mbeturina të pranuar nga jashtë (input)	2000.0	Kapacitet maksimal vjetor i pranimit
Mbeturina të gjeneruara nga funksionimi i objektit	48.5	1.2 t mbeturina komunale; ≈ 45.0 t ujëra/llumra septike për bilanc indikativ; 2.3 t rrjedha të tjera
Sasia totale që kalon nëpër objekt	2048.5	Bilanci hyrje = dalje; nuk ka akumulim afatgjatë
Rrjedha potencialisht të dërguara për rikuperim jashtë lokacionit	≤ 2002.3	Maksimum teorik; rezultati real verifikohet me kontrata, licenca dhe fletë-përcjellëse të operatorëve pranues
Rrjedha të dërguara për asgjësim jashtë lokacionit	≥ 46.2	Mbeturina komunale + $45 \text{ m}^3/\text{vit}$ ujëra/llumra septike; si dhe çdo rrjedhë tjetër e kontraktuar për operacion D
Magazinin maksimal i njëkohshëm në lokacion	≈ 192	≈ 180 t jo të rrezikshme + ≈ 12 t të rrezikshme

Sasia potencialisht e drejtuar për rikuperim është deri në 2.002,3 t/vit, por nuk deklarohet normë e garantuar rikuperimi. Rezultati real përcaktohet nga operacioni i shënuar në licencën e operatorit pranues dhe nga fletë-përcjellëset vjetore. Të paktën rreth 46,2 t/vit – 1,2 t mbeturina komunale dhe $45 \text{ m}^3/\text{vit}$ ujëra/llumra septike, të konvertuara vetëm për bilanc me dendësi indikative $1,0 \text{ t/m}^3$ – si dhe çdo rrjedhë tjetër e kontraktuar për D1/D8/D9/D10, raportohet veçmas si asgjësim jashtë lokacionit. Frekuenca reale e zbrazjes përcaktohet nga vëllimi i dobishëm i gropës dhe provohet me dokumentet e operatorit të licencuar.

2.6.5. Emetimet në ajër

Procesi nuk përfshin djegie, shkrirje, trajtim termik apo proces kimik, dhe për këtë arsye nuk ekziston burim i drejtuar (i kanalizuar) i emetimeve në ajër. Nuk ka oxhak, nuk ka filtër industrial dhe nuk ka pikë matjeje të emetimeve të drejtuara. Emetimet e identifikueshme janë vetëm difuze (fugitive) dhe nga djegia e karburantit të makinerisë së manipulimit.

2.6.5.1. Pluhuri difuz nga manipulimi i materialeve

Llogaritja është kryer sipas metodologjisë US EPA AP-42, Kapitulli 13.2.4 (Aggregate Handling and Storage Piles):

$$E = k \times 0.0016 \times (U / 2.2)^{1.3} / (M / 2)^{1.4} \quad [\text{kg/Mg material i manipuluar}]$$

- $k = 0.35$ për PM_{10} ; $k = 0.74$ për TSP; $k = 0.053$ për $\text{PM}_{2.5}$
- $U = 2.0 \text{ m/s}$ – shpejtësia mesatare e erës në zonën e Fushës së Kosovës
- $M = 2\%$ – përmbajtja e lagështisë e fraksioneve metalike
- Numri i pikave të transferimit: 4 (shkarkim, klasifikim, magazinim, ngarkim)
- Sasia e manipuluar: $2000 \text{ t/vit} \times 4 = 8000 \text{ Mg-transferime}$

Tabela 17. Emetimet e pluhurit difuz nga manipulimi i materialeve (US EPA AP-42, kap. 13.2.4)

Ndotësi	Faktori i emetimit (kg/Mg)	Emetimi vjetor (kg/vit)	Emetimi mesatar orar (g/h)
TSP (pluhur total)	1.05×10^{-3}	8.4	3.73
PM ₁₀	4.95×10^{-4}	3.96	1.76
PM _{2.5}	7.50×10^{-5}	0.60	0.27

Llogaritja AP-42 për qarkullimin mbi sipërfaqe të asfaltuara paraqitet vetëm si inventar paraprak i emetimit. Baza operative është skenari i projektimit prej rreth 910 lëvizjesh të mjeteve të rënda në vit; numri real, distanca e brendshme dhe ngarkesa me baltë/pluhur verifikohen me regjistrat e hyrje-daljeve. Ky inventar nuk është model dispersioni dhe nuk provon përqendrimin e PM₁₀ në receptorë.

2.6.5.2. Emetimet nga djegia e karburantit

Llogaritur sipas metodologjisë EMEP/EEA për makineri jashtë-rrugore, për konsum vjetor prej 2400 l dizel (2004 kg):

Tabela 18. Emetimet nga djegia e karburantit dizel në makinerinë e manipulimit

Ndotësi	Faktori i emetimit (g/kg karburant)	Emetimi vjetor (kg/vit)
NO _x	33.70	67.50
CO	15.80	31.70
Hidrokarbure totale (HC)	4.40	8.80
Pluhur (PM)	2.30	4.60
SO ₂	0.02	0.04

Sasitë e emetuara janë të papërfillshme në krahasim me burimet e tjera në zonë, veçanërisht me trafikun në magjistralen M-25. Nuk ekziston burim i drejtuar emetimi për të cilin do të kërkohej vlerësim i përqendrimeve në oxhak apo krahasim me vlerat kufi të emetimit.

2.6.5.3. Zhurma dhe dridhjet

Burimet e zhurmës dhe fuqia akustike e vlerësuar e secilit burim:

Tabela 19. Burimet e zhurmës dhe fuqia akustike e vlerësuar

Burimi i zhurmës	Lp në 1 m, dB(A)	Lw i vlerësuar, dB(A)	Kohëzgjatja e ekspozimit
Shkarkim i skrapit metalik (impulsiv)	95	106	e ndërprerë, vetëm gjatë orarit të punës
Vegla pneumatike të çmontimit	92	103	e ndërprerë, vetëm gjatë orarit të punës
Kamion në manovrim brenda lokacionit	82	93	e ndërprerë, vetëm gjatë orarit të punës
Presë hidraulike për paketim	84	95	e ndërprerë, vetëm gjatë orarit të punës
Manipulator teleskopik / karrocë ngritëse	80	91	e ndërprerë, vetëm gjatë orarit të punës
Fuqia akustike e kombinuar		108.2	




Figura 9. Vlerësimi i propagimit të zhurmës nga lokacioni drejt receptorëve më të afërt

Shënim: nivelet e paraqitura janë llogaritje orientuese me dobësim gjeometrik dhe nuk zëvendësojnë matjet bazë dhe operative të zhurmës në kufi dhe te receptorët.

Tabela 20. Nivelet e vlerësuara të zhurmës në receptorët më të afërt

Receptori	Distanca (m)	Lp vetëm zbutje gjeometrike, dB(A)	Lp me zbutje atmosferike dhe ekranim, dB(A)	Vlerësimi
Qendra urbane e Lipjanit	508	46.1	≈ 40	Nën vlerën referuese ditore prej 55 dB(A)
Objekt fetar (xhami)	650	43.9	≈ 38	Nën vlerën referuese ditore prej 55 dB(A)
Vendbanimi Hallaq i Vogël	901	41.1	≈ 34	Nën vlerën referuese ditore prej 55 dB(A)

Dridhjet mund të gjenerohen nga presa hidraulike dhe nga shkarkimi i fraksioneve metalike. Distanca dhe mungesa e lidhjes strukturore me objektet fqinje e ulin mundësinë e transmetimit, por niveli real verifikohet gjatë operimit me inspektim dhe, në rast ankese ose shenje shqetësimi, me matje nga subjekt kompetent.

2.6.5.4. Ujërat e zeza

Nuk gjenerohen ujëra teknologjike. Rrjedhat e ujërave të zeza janë:

Tabela 21. Rrjedhat e ujërave të zeza dhe menaxhimi i tyre

Rrjedha	Sasia	Përbërja e pritshme	Menaxhimi
Ujëra sanitare	45 m ³ /vit (6 punonjës × 30 l/ditë × 250 ditë)	Ngarkesë organike tipike komunale	Gropë septike e papërshkueshme; zbrazje nga operator i licencuar; zgjidhje e preferuar – lidhje me rrjetin publik të kanalizimit
Ujëra atmosferike nga sipërfaqet me rrezik ndotjeje	≈ 552 m ³ /vit; rrjedhje maksimale e projektimit 13.5 l/s	Lëndë të ngurta të pezulluara, hidrokarbure, gjurmë metalesh të rënda	Separator koalescent vaj/ujë klasa I, NS 15 (EN 858), me rezervuar rërë-baltë; shkarkim në rrjetin publik sipas UA (MMPHI) nr. 02/2022
Ujëra atmosferike nga sipërfaqet e tjera	≈ 1059 m ³ /vit	Të pakontaminuara	Drenazhim i kontrolluar; shkarkim pa trajtim
Ujëra nga pastrimi i sipërfaqeve	≈ 40 m ³ /vit	Lëndë të ngurta, gjurmë vajrash	Drejtuar në separatorin koalescent; ndalohet shkarkimi i drejtpërdrejtë

Dimensionimi i separatorit: sipërfaqja me rrezik ndotjeje 1000 m²; intensiteti i projektimit $i = 0.015 \text{ l/(s} \cdot \text{m}^2)$ sipas EN 858-2; koeficienti i rrjedhjes $\psi = 0.90$; rrjedhja e projektimit $Q_r = 0.015 \times 1000 \times 0.90 = 13.5 \text{ l/s}$. Përzgjidhet separator me madhësi nominale NS 15, klasa I (përmbajtje hidrokarburesh në dalje $\leq 5 \text{ mg/l}$), me kapacitet mbajtjeje vaji $\geq 200 \text{ l}$, rezervuar rërë-baltë $\geq 1 \text{ 500 l}$ dhe alarm të nivelit të vajit.

2.6.5.5. Rrezatimi, drita dhe nxehtësia

Veprimtaria nuk gjeneron rrezatim jonizues dhe nuk përfshin burime rrezatimi. Rrezatimi jojonizues (elektromagnetik) kufizohet në nivelet tipike të instalimeve elektrike me tension të ulët (0.4 kV) dhe është i papërfillshëm. Ndriçimi i jashtëm është i drejtuar nga poshtë dhe i ekranuar, me qëllim shmangjen e ndotjes ndriçuese ndaj zonave përreth; nuk aplikohet ndriçim nate përveç ndriçimit të sigurisë. Nuk gjenerohet nxehtësi teknologjike dhe nuk ka shkarkim të nxehtësisë në mjedis.

2.7. Prezantimi i teknologjisë së trajtimit, përpunimit, riciklimit, dhe asgjësimit të të gjitha llojeve të mbeturinave

2.7.1. Sqarim terminologjik: baza e riformulimit të titullit dhe kufizimi i veprimtarisë ndaj konceptit ligjor “trajtim”

Komisioni për VNM, me Njoftimin ref. 26/3238/522/DMM, datë 27.07.2026, ka kërkuar sqarim të arsyes pse në titullin e projektit figuron termi “trajtim”, dhe – në rast se veprimtaria përbën trajtim – identifikimin e kodeve sipas Katalogut Shtetëror të Mbeturinave dhe të trajtimit që u bëhet këtyre mbeturinave. Përgjigjja paraqitet në vijim.

2.7.1.1. Analiza e konceptit ligjor “trajtim” në legjislacionin e Republikës së Kosovës

Në kuptimin e Ligjit nr. 04/L-060 për Mbeturina (teksti i konsoliduar), trajtimi përfshin operacionet e rikuperimit ose të asgjësimit, duke përfshirë përgatitjen paraprake. Për këtë projekt termi përdoret vetëm në formën e kualifikuar “trajtim paraprak mekanik (R12)” dhe nuk nënkupton riciklim përfundimtar.

- R12: depolutimi dhe çmontimi manual i automjeteve jashtë përdorimit, si dhe klasifikimi, ndarja, presimi/ngjeshja dhe paketimi mekanik i fraksioneve para një operacioni R1–R11 te operatori pranues i licencuar.
- R13: magazinimi i përkohshëm vetëm i rrjedhave që, sipas kontratës dhe licencës së operatorit pranues, destinohen për një operacion rikuperimi R1–R12. Mbeturinat e gjeneruara në lokacion që

destinohen për D1, D8, D9 ose D10 mbahen përkohësisht te gjeneruesi dhe dorëzohen drejtpërdrejt; operacioni D15 nuk kërkohet dhe nuk kryhet në këtë lokacion.

Në lokacion nuk kryhet shkrirje, grimcim industrial (shredding), riciklim përfundimtar R3/R4/R5, trajtim kimik, biologjik ose termik, incinerim apo asgjësim. Çdo proces i tillë mbetet jashtë fushëveprimit të këtij raporti dhe kryhet vetëm nga operatori pranues sipas licencës së tij.

2.7.1.2. Veprimi i ndërmarrë: saktësimi juridik i titullit

Për t'iu përgjigjur vërejtjes së Ministrisë, titulli zyrtar i projektit nuk përmban termin e përgjithshëm “trajtim”. Për qëllime të klasifikimit juridik dhe të licencimit, raporti sqaron veçmas se veprimet faktike të ndarjes, presimit, paketimit, depolutimit dhe çmontimit përbëjnë operacione paraprake mekanike R12, ndërsa magazinimi para rikuperimit përbën R13; në lokacion nuk kryhet trajtim kimik, biologjik ose termik, shkrirje apo riciklim përfundimtar:

Saktësimi nuk ndryshon kapacitetin e propozuar prej 2.000 t/vit; ai përcakton kufirin juridik të veprimtarisë. MPEE-të dhe bateritë/akumulatorët magazinohen të pandryshuara nën R13, ndërsa R12 zbatohet vetëm për kodet dhe proceset e identifikuara në Tabelën 27.

2.7.1.3. Deklarim eksplicit i operacioneve që kryhen dhe që nuk kryhen në lokacion

Operacionet e projektuara janë R12 dhe R13. Ato mund të ushtrohen vetëm pasi licenca valide e menaxhimit të mbeturinave të përmbajë kodin përkatës, llojin e mbeturinës, kapacitetin dhe operacionin. Pëlqimi mjedisor nuk autorizon vetvetiu pranimin ose trajtimin e mbeturinave.

Tabela 22. Deklarim eksplicit i operacioneve që kryhen dhe që nuk kryhen në lokacion

Kategoria	Operacioni	Kryhet në lokacion?	Baza ligjore / vërejtje
Operacione rikuperimi (Lista R)	R13 – Magazinimi i mbeturinave në pritje të një operacioni nga R1 deri R12	PO	PO vetëm për rrjedhat e destinuara për rikuperim R1–R12 dhe vetëm brenda fushës së licencës valide.
	R12 – Shkëmbimi i mbeturinave për t'i nënshtruar ato operacioneve R1–R11 (klasifikim, çmontim, ndarje, ngjeshje, paketim)	PO	Klasifikim, ndarje, presim/ngjeshje, paketim, depolutim dhe çmontim mekanik para rikuperimit; vetëm sipas kodit dhe licencës.
	R3 – Riciklimi i substancave organike (plastikë, gomë)	JO	Kryhet nga operatori i licencuar, jashtë lokacionit
	R4 – Riciklimi i metaleve dhe komponimeve metalike (shkrirje, rafinim)	JO	Kryhet nga uzinat e licencuara, jashtë lokacionit
	R1 – Përdorimi kryesor si karburant ose burim energjie	JO	Nuk aplikohet
Operacione asgjësimi (Lista D)	D1 – Deponimi në ose mbi tokë	JO	Nuk ka deponi në lokacion; sipërfaqet janë të papërshkueshme
	D10 – Djegie në tokë (incinerim)	JO	Nuk ka impiant termik
	D8 / D9 – Trajtim biologjik / fiziko-kimik	JO	Nuk kryhet asnjë proces biologjik apo kimik

Kategoria	Operacioni	Kryhet në lokacion?	Baza ligjore / vërejtje
	D15 – Magazinim në pritje të operacioneve D1–D14	JO	Mbeturinat e gjeneruara në lokacion për D1/D8/D9/D10 dorëzohen drejtpërdrejt nga gjeneruesi. Pranimi/magazinimi D15 nuk lejohet pa autorizim të veçantë dhe është jashtë projektit.
Procese që nuk kryhen në lokacion	Trajtim fiziko-kimik (neni 27)	JO	Nuk kryhet neutralizim, mineralizim, oksidim, reduktim, absorbim, distilim, shkëmbim jonik apo osmozë
	Trajtim biologjik (neni 28)	JO	Nuk kryhet zbërthim aerob apo anaerob; nuk pranohen mbeturina të biodegradueshme
	Trajtim termik (neni 29)	JO	Nuk kryhet djegie, shkrirje, pirolizë apo prerje me flakë të hapur
Operacione mekanike të tjera	Grimcim (shredding) i automjeteve	JO	Nuk ka impiant grimcimi; çmontimi kryhet manualisht
	Larje me presion e komponentëve	JO	Nuk gjenerohen ujëra teknologjike
	Rigjenerim i vajrave mbeturinë	JO	Neni 4, par. 1.18; kryhet nga operatori i licencuar

2.7.1.4. Përfundim

Përfundimisht, projekti është qendër për klasifikim dhe menaxhim të mbeturinave me trajtim paraprak mekanik R12 dhe magazinim të përkohshëm R13, pa riciklim përfundimtar dhe pa operacione D në lokacion. Lejimi i veprimtarisë kushtëzohet me pëlqimin mjedisor, licencën valide të menaxhimit të mbeturinave, kontratat me operatorët pranues dhe zbatimin paraprak të masave teknike të këtij raporti.

2.7.2. Operacionet e kryera për secilin kod mbeturine

Tabela në vijim përcakton, për secilin kod të identifikuar, operacionin konkret që kryhet në lokacion, kushtet teknike të magazinimit dhe destinacionin e mëtejshëm. Kjo tabelë përbën përgjigjen e drejtpërdrejtë ndaj kërkesës së Komisionit për VNM për të cekur “cilat kode janë dhe çfarë trajtimi u bëhet këtyre mbeturinave”.


Tabela 23. Operacionet e kryera, kushtet e magazinimit dhe destinacioni i mëtejshëm për secilin kod të mbeturinës

Kodi / kodet	Klasifikimi	Operacioni që kryhet në lokacion (Lista R)	Kushtet teknike të magazinimit	Destinacioni i mëtejshëm (operator i licencuar)
16 01 04*	e rrezikshme	R12 – depolutim dhe çmontim manual	Zonë pritjeje mbi sipërfaqe të papërshkueshme; çmontim mbi platformë me pellg mbajtës	Fraksionet daluese dorëzohen sipas kodit përkatës; lëshohet certifikatë e shkatërrimit
16 01 06	jo e rrezikshme	R12 – çmontim manual; R13 – magazinim	Zonë e dedikuar brenda Hangarit 2	Fraksionet dorëzohen sipas kodit përkatës
16 01 17 / 17 04 05 / 20 01 40 / 12 01 01 / 17 04 07	jo e rrezikshme	R12 – klasifikim, ndarje, ngjeshje, paketim; R13 – magazinim	Boks i dedikuar, lartësi stivimi ≤ 1.8 m, mbi sipërfaqe të papërshkueshme	Uzina të licencuara të shkrirjes dhe riciklimit të metaleve (R4)
16 01 18 / 17 04 01 / 17 04 02 / 17 04 11	jo e rrezikshme	R12 – ndarje manuale dhe mekanike, klasifikim sipas aliazhit; R13 – magazinim	Boks i veçantë, i ndarë nga fraksionet ferroze; kabllot pa heqje izolimi me flakë	Industri metalurgjike të licencuara për ripërpunim (R4)
16 01 19 / 15 01 02 / 17 02 03 / 20 01 39	jo e rrezikshme	R12 – klasifikim sipas polimerit, ngjeshje, paketim; R13 – magazinim	Boks i mbuluar për të parandaluar shpërndarjen nga era	Fabrika riciklimi (R3)
16 02 14 / 20 01 36	jo e rrezikshme	R13 – magazinim i përkohshëm i paçmontuar; klasifikim sipas kategorisë	Depo e mbuluar, e thatë, pa stivim që shkakton thyerje	Qendra të licencuara për trajtimin e MPEE (R4, R5)
16 02 13* / 20 01 35*	e rrezikshme	R13 – magazinim i përkohshëm i paçmontuar, i izoluar	Depo e veçantë brenda objektit, mbi pellg mbajtës, e etiketuar	Operatorë të licencuar për MPEE të rrezikshme
16 06 01* / 20 01 33*	e rrezikshme	R13 – magazinim i përkohshëm i pandryshuar	Kontejner acid-rezistent, i mbuluar, mbi pellg mbajtës; polet e izoluar; ndalohet zbrazja e elektrolitit	Operatorë të licencuar për riciklimin e baterive të plumbit (R4)
13 02 05* / 13 01 10*	e rrezikshme	R13 – magazinim i përkohshëm në depozita të mbyllura	Depozitë e dyfishtë ose mbi pellg mbajtës ≥ 110 %; ventilim; absorbues pranë	Kompani të licencuara për rigjenerim ose rikuperim energjetik të vajrave (R9, R1)
16 01 13* / 16 01 14* / 13 07 01* / 13 07 02* / 13 07 03*	e rrezikshme	R13 vetëm kur kontrata parashikon rikuperim; kur destinacioni është D9, largim i drejtpërdrejtë si mbeturinë e gjeneruar në lokacion, pa D15	Enë të përputhshme kimikisht, të mbyllura, mbi pellg mbajtës; karburanti në enë antistatike	Operatorë të licencuar për rikuperim (p.sh. R9) ose për D9, sipas kontratës dhe licencës për kodin konkret

Kodi / kodet	Klasifikimi	Operacioni që kryhet në lokacion (Lista R)	Kushtet teknike të magazinimit	Destinacioni i mëtejshëm (operator i licencuar)
16 01 07*	e rrezikshme	R13 – magazinim i përkohshëm pas kullimit; kodi 16 01 07* zbatohet për filtrat e vajit, ndërsa filtrat e karburantit kodifikohen sipas përbërjes dhe kontaminimit faktik	Enë hermetike me kapak, mbi tabaka kullimi brenda objektit	Operatorë të licencuar për mbeturina të rrezikshme (R4, D10)
16 01 10*	e rrezikshme	R13 – magazinim i përkohshëm, i pa aktivizuar	Kuti metalike e izoluar, e mbrojtur nga goditjet dhe nxehësia; ndalohe aktivizimi	Operatorë të specializuar dhe të licencuar
16 01 21*	e rrezikshme	R13 – magazinim i përkohshëm i izoluar	Enë e veçantë e etiketuar, brenda objektit	Operatorë të licencuar për mbeturina të rrezikshme
16 01 03	jo e rrezikshme	R12 – ndarje gjatë çmontimit; R13 – magazinim	Depo e dedikuar; stivim i kontrolluar; ndalohe grumbullimi i ujit brenda gomave (kontroll i vektorëve)	Fabrika riciklimi ose rikuperim energjetik (R3, R1)
16 01 20 / 17 02 02 / 20 01 02	jo e rrezikshme	R12 – ndarje dhe klasifikim; R13 – magazinim	Kontejner i veçantë; qelqi laminuar i ndarë nga qelqi i temperuar	Fabrika riciklimi të qelqit (R5)
16 01 12	jo e rrezikshme	R13 – magazinim i përkohshëm	Enë e veçantë; verifikim paraprak i mungesës së azbestit (përfshirë i kodit 16 01 11*)	Operatorë të licencuar
16 01 22	jo e rrezikshme	R12 – klasifikim; R13 – magazinim	Boks i dedikuar për komponentë të përzier	Operatorë të licencuar
15 01 01 / 20 01 01	jo e rrezikshme	R12 – ngjeshje dhe paketim; R13 – magazinim	Depo e thatë, e mbrojtur nga reshjet	Fabrika riciklimi të letrës (R3)
15 01 10* / 15 02 02*	e rrezikshme	R13 – magazinim i përkohshëm i izoluar	Enë të mbyllura, mbi pellg mbajtës, brenda objektit	Operatorë të licencuar për mbeturina të rrezikshme
13 05 01* / 13 05 02*	e rrezikshme	Nuk kryhet operacion; largohen drejtpërdrejt nga separatori	Zbrazje me autocisternë nga operator i licencuar; nuk magazinohen	Operatorë të licencuar për mbeturina të rrezikshme (D9)
20 03 01	jo e rrezikshme	Nuk kryhet operacion – grumbullim dhe largim	Kontejner standard 1.1 m ³ , i mbuluar	Deponi komunale e licencuar (D1), përmes KRM “Pastrimi”
20 03 04	jo e rrezikshme	Nuk kryhet operacion – zbrazje periodike	Gropë septike e papërshkueshme	Impiant i licencuar për trajtimin e ujërave të zeza (D8)

SKEMA E MENAXHIMIT TË MBETURINAVE SIPAS KODIT DHE OPERACIONIT

Kodet sipas UA (MMPH) nr. 13/2013 – Katalogu Shtetëror i Mbeturinave · Operacionet sipas Shtojcës II (Lista R) të Ligjit nr. 04/L-060



Asnjë fraksion mbeturine nuk asgjësohet, nuk digjet, nuk shkrihet dhe nuk trajtohet kimikisht në lokacion.

Magazinimi maksimal i njëkohshëm në lokacion: ≈ 192 t (≈ 180 t jo të rrezikshme + ≈ 12 t të rrezikshme). Koha maksimale: 6 muaj jo të rrezikshme; 3 muaj të rrezikshme.

Figura 10. Skema e menaxhimit të mbeturinave sipas kodit dhe operacionit përkatës

2.7.3. Kërkesat e përbashkëta teknike për magazinimin

- Të gjitha operacionet e pranimit, manipulimit dhe magazinimit kryhen vetëm në 1.060 m² sipërfaqe operative të papërshkueshme ose brenda hangarëve; 166 m² sipërfaqe të gjelbra përjashtohen dhe mbrohen nga çdo rrjedhje.
- Mbeturinat e rrezikshme magazinohen ekskluzivisht brenda objektit, mbi pellgje mbajtëse me vëllim jo më të vogël se 110 % të enës më të madhe, të mbrojtura nga reshjet dhe nga rrezatimi i drejtpërdrejtë i diellit.
- Çdo enë dhe boks etiketohet me kodin gjashtë-shifror, emërtimin sipas Katalogut, klasën e rrezikshmërisë dhe datën e fillimit të magazinimit.
- Ndalohet përzierja e fraksioneve me kod të ndryshëm, si edhe hollimi i mbeturinave të rrezikshme me qëllim ndryshimin e klasifikimit.
- Koha maksimale e magazinimit është 6 muaj për mbeturina jo të rrezikshme dhe 3 muaj për mbeturina të rrezikshme; tejkalimi i afateve regjistrohet dhe justifikohet me shkrim.
- Pranë secilës zonë të mbeturinave të rrezikshme mbahet komplet reagimi ndaj derdhjeve (absorbues, lopatë antishkëndijë, enë e zbrazët, pajisje mbrojtëse personale).

– Ndalohej magazinimi i mbeturinave jashtë zonave të përcaktuara dhe ndalohej stivimi që pengon qasjen e mjeteve të fikjes së zjarrit.

2.7.4. Zinxhiri i mëtejme i trajtimit tek operatorët e licencuar

Aplikuesi është i detyruar të mbajë kontrata valide dhe kopje të licencave për të gjithë operatorët tek të cilët dorëzohen mbeturinat. Regjistri i operatorëve mbahet i përditësuar dhe verifikohet së paku një herë në vit.

Tabela 24. Zinxhiri i mëtejme i trajtimit dhe statusi i kontratave me operatorët e licencuar

Fraksioni	Kodi / kodet	Operacioni i mëtejme jashtë lokacionit	Statusi i kontratës
Metale ferroke	16 01 17, 17 04 05, 20 01 40, 12 01 01, 17 04 07	R4 – riciklim / shkrirje në uzinë të licencuar	Kontratë – për verifikim
Metale joferroke	16 01 18, 17 04 01, 17 04 02, 17 04 11	R4 – riciklim metalurgjik	Kontratë – për verifikim
Plastikë	16 01 19, 15 01 02, 17 02 03, 20 01 39	R3 – riciklim mekanik	Kontratë – për verifikim
MPEE	16 02 14, 20 01 36, 16 02 13*, 20 01 35*	R4, R5 – çmontim dhe rikuperim në qendër të licencuar	Kontratë – për verifikim
Akumulatorë plumbi	16 06 01*, 20 01 33*	R4 – riciklim i plumbit dhe neutralizim i elektrolitit	Kontratë – për verifikim
Vajra dhe lëngje të rrezikshme	13 02 05*, 13 01 10*, 16 01 13*, 16 01 14*, 13 07 01*, 13 07 02*, 13 07 03*	R9/R1 ose D9, vetëm sipas licencës së operatorit pranues dhe karakteristikës së rrjedhës	Kontratë – për verifikim
Filtra vaji dhe komponentë të rrezikshëm; filtrat e karburantit kodifikohen veçmas sipas përbërjes/kontaminimit	16 01 07*, 16 01 21*, 16 01 10*; kod shtesë sipas rastit	R4 ose D10, vetëm sipas kodit dhe licencës së operatorit pranues	Kontratë – për verifikim
Gomat e vjetra	16 01 03	R3, R1 – riciklim ose rikuperim energjetik	Kontratë – për verifikim
Qelqi	16 01 20	R5 – riciklim	Kontratë – për verifikim
Mbeturina komunale	20 03 01	D1 – deponim i kontrolluar	Kontratë ekzistuese – KRM “Pastrimi”
Llum septik	20 03 04	D8 – trajtim biologjik në impiant	Kontratë – për verifikim

Masë e detyrueshme: para lëshimit të pëlqimit mjedisor, aplikuesi duhet të dorëzojë kopjet e kontratave dhe të licencave valide për të gjithë operatorët e listuar, veçanërisht për fraksionet e rrezikshme.

2.8. Program për ndërtimin, kohëzgjatjen e ndërtimit, kohëzgjatjen e planifikuar të funksionimit të projektit, kohën e mundshme të përfundimit të funksionimit të projektit dhe sipas rastit edhe fazën e planifikuar të rehabilitimit të sipërfaqes pas mbarimit të funksionimit të projektit

Objektet ekzistojnë dhe janë funksionale; nuk parashihet fazë ndërtimi. Programi kohor përfshin zbatimin e masave përgatitore mjedisore, fazën e operimit dhe fazën e mundshme të mbylljes dhe rehabilitimit.

Tabela 25. Programi kohor i fazave të projektit

Faza	Aktiviteti	Kohëzgjatja / afati	Vërejtje
Faza 0 – Përgatitje mjedisore	Instalimi i separatorit koalescent; ndërtimi i platformës së depolutimit; pajisja e depove për mbeturina të rrezikshme; verifikimi i gropës septike; shënjimi i zonave	Para pranimit të mbeturinave të rrezikshme dhe para depolutimit/çmontimit të automjeteve jashtë përdorimit	Kusht paraprak; operimi i plotë ndalohet pa verifikim
	Trajnimi fillestar i personelit; vendosja e ditarit të mbeturinave; nënshkrimi i kontratave me operatorë të licencuar	Para operimit të plotë dhe para dorëzimit të parë	Kusht paraprak i dokumentuar
Faza 1 – Operim	Grumbullim, klasifikim, magazinim i përkohshëm dhe çmontim; monitorim sipas Kapitullit 8	E papërcaktuar; e kushtëzuar me vlefshmërinë e pëlqimit mjedisor dhe të licencës	Rishikim periodik i pëlqimit sipas legjislacionit
Faza 2 – Mbyllje	Ndërprerja e pranimit; largimi i të gjitha mbeturinave të magazinuara tek operatorë të licencuar; zbrazja dhe pastrimi i depozitave, enëve, separatorit dhe gropës septike	6 muaj nga vendimi për ndërprerje	Njoftim paraprak i MMPHI-së dhe i Komunës
	Pastrimi i sipërfaqeve; kampionimi verifikues i tokës në zonën e depolutimit dhe të magazinimit të lëngjeve (metale të rënda, TPH)	Brenda 3 muajve pas largimit të mbeturinave	Raport i gjendjes përfundimtare drejtuar MMPHI-së
Faza 3 – Rehabilitim	Riparim i shtresës së papërshkueshme; rehabilitim i pikave me ndotje të konstatuar (nëse konstatohet); dorëzimi i lokacionit në gjendje të sigurt	Sipas gjetjeve të kampionimit	Rehabilitim vetëm nëse kampionimi konstaton tejkalim

Rehabilitimi përfshin largimin e plotë të mbeturinave dhe substancave ndotëse, verifikimin e tokës dhe ujërave sipas nevojës, si dhe ruajtjen ose rikthimin e rreth 166 m² sipërfaqeve të gjelbra. Sipërfaqet operative dhe objektet dorëzohen në gjendje të sigurt për shfrytëzim të mëtejshëm komercial ose industrial.

2.9. Të dhëna për infrastrukturën e nevojshme

Lokacioni ka objekte ekzistuese, por operimi i plotë kushtëzohet me realizimin e masave teknike të identifikuar në raport. Tabela në vijim dallon infrastrukturën ekzistuese nga ndërhyrjet që duhet të instalohen, testohen dhe dokumentohen para përdorimit.

Tabela 26. Infrastruktura ekzistuese dhe ndërhyrjet e nevojshme

Sistemi	Gjendja ekzistuese	Ndërhyrja e nevojshme	Statusi
Qasja rrugore	Qasje e drejtpërdrejtë nga magjistralja M-25 Prishtinë–Shtime; hyrje/dalje e mjaftueshme për mjete të rënda	Vendosje e sinjalistikës horizontale dhe vertikale; shënjimi i drejtimit të qarkullimit të brendshëm	Për realizim
Energjia elektrike	Lidhje ekzistuese me rrjetin publik; panel shpërndarës	Kontroll periodik i instalimeve; mbrojtje me fikëse CO ₂ pranë panelit	Në funksion
Furnizimi me ujë	Lidhje ekzistuese me rrjetin publik të ujësjellësit; ujëmatës	Nuk kërkohet ndërhyrje; monitorim i konsumit	Në funksion

Sistemi	Gjendja ekzistuese	Ndërhyrja e nevojshme	Statusi
Kanalizimi sanitar	Gropë septike në pjesën fundore të parcelës	Test i papërshkueshmërisë; përcaktimi i vëllimit të dobishëm dhe i frekuencës së zbrazjes; zgjidhje e preferuar – lidhje me rrjetin publik të kanalizimit	Masë e detyrueshme
Ujërat atmosferike	Drenazhim i pjesshëm i sipërfaqes	Ndarje e rrjetit të ujërave atmosferike nga ai sanitar; instalim i separatorit koalescent NS 15, klasa I (EN 858), për sipërfaqen me rrezik prej 1000 m ²	Masë e detyrueshme
Mbrojtja kundër zjarrit	Pajisje të pjesshme	Plotësim i fikëseve ABC 6 kg (1 njësi/150 m ²) dhe CO ₂ 5 kg; plan evakuimi; sinjalistikë emergjente; rezervë ujore për fikje sipas kushteve të autoritetit kompetent	Për plotësim
Sigurimi fizik	Rrethojë e parcelës; kamera CCTV; sistem alarmi	Mbulim i plotë i pikave të pranimit dhe të magazinimit të mbeturinave të rrezikshme me CCTV	Për plotësim
Peshimi	Nuk ka peshojë të instaluar	Instalim i peshojës ose marrëveshje për peshim në peshojë të certifikuar në afërsi; peshimi është kusht për regjistrimin e saktë të sasive	Masë e detyrueshme

Nuk kërkohet hapje e rrugëve të reja, nuk kërkohet zgjerim i rrjetit elektrik dhe nuk kërkohet ndërtim i infrastrukturës jashtë kufijve të parcelës.

2.10. Të dhëna për aktivitete të tjera që mund të nevojiten për zbatimin e projektit, si ndërtimi i kampeve apo rezidencave

Nuk parashihet ndërtimi i kampeve të punëtorëve, i rezidencave, i depove të përkohshme jashtë parcelës apo i infrastrukturës ndihmëse jashtë kufijve të lokacionit. Personeli është vendor dhe nuk kërkon akomodim.

Aktivitetet ndihmëse kufizohen brenda parcelës dhe përfshijnë:

- transportin e brendshëm të materialeve me manipulator teleskopik dhe karrocë ngritëse;
- operacionet e ngarkim-shkarkimit në zonat e dedikuara;
- mirëmbajtjen rutinore të pajisjeve, të kryer mbi sipërfaqe me pellg mbajtës;
- pastrimin e rregullt të sipërfaqeve operative, me largim të mbetjeve në separator;
- menaxhimin administrativ të ditarit të mbeturinave dhe të fletë-përcjellëseve.

2.11. Informacion për lejet dhe licencat e nevojshme për projektin

Pëlqimi mjedisor është vetëm një nga autorizimet e nevojshme dhe nuk zëvendëson licencën e menaxhimit të mbeturinave. Tabela në vijim paraqet lejet, pëlqimet dhe dokumentet sipas fazës dhe institucionit përgjegjës.

Tabela 27. Lejet, licencat dhe dokumentet e nevojshme për projektin

Nr.	Akti / dokumenti	Institucioni kompetent	Baza ligjore	Statusi
1	Pëlqim mjedisor	MMPHI – Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit	Ligji nr. 08/L-181 për VNM	Në procedurë – objekt i këtij raporti
2	Licencë për menaxhimin e mbeturinave (grumbullim, magazinim, operacione R12/R13)	MMPHI	Ligji nr. 04/L-060 për Mbeturina (teksti i konsoliduar)	Për aplikim / rinovim

Nr.	Akti / dokumenti	Institucioni kompetent	Baza ligjore	Statusi
3	Leje mjedisore komunale / pëlqim për ushtrimin e veprimtarisë	Komuna e Lipjanit	Ligji për mbrojtjen e mjedisit; legjislacioni komunal	Për verifikim
4	Informacion i lokacionit urban / pajtueshmëri me HZK	Komuna e Lipjanit – Drejtoria e Urbanizmit	Ligji nr. 04/L-174 për planifikim hapësinor	Ekzistues – dokumenti përkatës bashkëngjitet në Shtojcën D
5	Certifikatë e regjistrimit të biznesit	ARBK	Legjislacioni për shoqëritë tregtare	Ekzistuese
6	Certifikatë mbi të drejtat e pronës së paluajtshme	Agjencia Kadastrale / Komuna	Legjislacioni kadastral	Ekzistuese
7	Plan i rlevimit të terrenit nga gjeodet i licencuar, me koordinata KosovaRef	Gjeodet i licencuar	Shtojca III e UA nr. 04/2025	Për dorëzim
8	Pëlqim / kushte për shkarkimin e ujërave në rrjetin publik	Operatori i shërbimeve të ujit; MMPHI	UA (MMPHI) nr. 02/2022	Për aplikim
9	Autorizim për lëshimin e certifikatave të shkatërrimit të automjeteve	Autoriteti kompetent për automjete	Legjislacioni për automjete dhe për mbeturina	Për verifikim
10	Kontrata me operatorë të licencuar për mbeturinat e rrezikshme dhe jo të rrezikshme	Operatorë privatë të licencuar	Ligji nr. 04/L-060	Për dorëzim
11	Pëlqim / kushte të mbrojtjes kundër zjarrit	Autoriteti kompetent për mbrojtje nga zjarri	Ligji nr. 08/L-261 për Mbrojtje nga Zjarri	Për verifikim
12	Vlerësim i rreziqeve në punë dhe akte të SHSP-së	Aplikuesi; inspektorati i punës	Ligji nr. 04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë	Për hartim / plotësim

Statusi i akteve ligjore paraqitet në nënkapitullin 10.3. Kopjet e lejeve, licencave dhe dokumenteve të projektit bashkëngjiten në Shtojcën 12 si pjesë e dosjes administrative.

2.12. Informacion për ndërlidhjet e mundshme të projektit me projekte të tjera ekzistuese

Lokacioni ndodhet në zonë komerciale dhe industriale të Komunës së Lipjanit, ku zhvillohen veprimtari të natyrës së ngjashme: qendra për grumbullimin dhe përpunimin e materialeve metalike, depo materialeve ndërtimore, betonjerë dhe shërbime logjistike.

Aplikuesi ka ushtruar më herët veprimtari të njëjtë në një parcelë ngjitur, në pronësi të përbashkët familjare. Pas ndarjes së pronësisë dhe riorganizimit të aseteve, veprimtaria është zhvendosur pjesërisht në parcelën 1218-2, për të cilën kërkohet pëlqimi mjedisor. Veprimtaria e re përbën vazhdimësi funksionale të së njëjtës veprimtari ekonomike, në një hapësirë të veçantë dhe të strukturuar sipas ndarjes së re pronësore.

Tabela 28. Vlerësimi i ndërlidhjeve me projekte dhe veprimtari të tjera ekzistuese

Aspekti i ndërlidhjes	Vlerësimi
Konflikt i përdorimit të tokës	Nuk ekziston – veprimtaria është në përputhje me destinimin komercial/ekonomik të zonës sipas HZK Lipjan
Ndërlidhje infrastrukturore	Shfrytëzim i njëjtë i rrjetit rrugor, elektrik dhe të ujësjellësit; pa mbingarkesë shtesë të konsiderueshme
Ndërlidhje funksionale me veprimtarinë ngjitur	Veprimtaritë janë të ngjashme dhe plotësuese; nuk ndajnë objekte, pajisje apo zona magazinimi; regjistrat e mbeturinave mbahen të ndarë për secilin subjekt
Rrezik i përzierjes së rrjedhave të mbeturinave	Rrezik i identifikuar – kërkohet ndarje fizike e qartë e kufirit, hyrje e veçantë dhe regjistër i ndarë; kjo është përcaktuar si masë e detyrueshme
Ndikime kumulative	Të vlerësuara në nënkapitullin 6.39; kontributi i projektit vlerësohet i vogël në raport me ngarkesën ekzistuese të zonës
Ndërlidhje me projekte të planifikuara	Nuk janë identifikuar projekte të planifikuara në afërsi të drejtpërdrejtë që do të ndërveprojnë me këtë projekt



Figura 11. Objektet ekzistuese brenda parcelës dhe veprimtaritë e ngjashme në afërsi të drejtpërdrejtë

3. PËRSHKRIMI I LOKACIONIT TË PROPOZUAR

3.1. Të dhënat për emrin e lokacionit ku është planifikuar të zbatohet projekti

Të dhënat për lokacionin paraqiten në dy nivele – makrolokacion dhe mikrolokacion – në përputhje me nenin 7, paragrafi 1 të UA (MMPHI) nr. 04/2025.

Tabela 29. Të dhënat për makrolokacionin dhe mikrolokacionin e projektit

Niveli	Elementi	Të dhënat
Makrolokacioni	Njësia administrative	Komuna e Lipjanit, Republika e Kosovës
	Njësia gjeografike	Pjesa qendrore e Fushës së Kosovës (Rrafshi i Kosovës)
	Korridori kryesor i transportit	Magjistralla M-25 Prishtinë–Shtime
	Pellgu hidrografik	Pellgu i Lumit Sitnica – rrjedhë drejt Ibrit dhe Danubit
Mikrolokacioni	Zona kadastrale	Lipjan
	Parcela kadastrale	P-71409044-01218-2 (nr. 1218-2)
	Adresa	Rr. "Ibrahim Rugova", magjistralla Prishtinë–Shtime (M-25), Lipjan
	Koordinatat (KosovaRef01)	Y = 7 509 165.106; X = 4 708 876.373
	Lartësia mbidetare	≈ 544 m
	Sipërfaqja	2916 m ²
	Destinimi sipas HZK Lipjan	Zonë komerciale / ekonomike
	Shfrytëzimi ekzistues	Objekte industriale (2 hangarë) dhe sipërfaqe të asfaltuara operative – tërësisht i transformuar antropogjenikisht
	Kufizimet e identifikuar	Sipas HZK-së dhe shtresave hartografike të konsultuara nuk janë identifikuar zona të mbrojtura natyrore, zona të trashëgimisë kulturore, zona të mbrojtjes sanitare ose zona të veçanta të mbrojtura brenda parcelës; ky përfundim verifikohet me shkresat e autoriteteve kompetente para dorëzimit.

Parcela është e kufizuar qartë me parcelat fqinje, ka qasje të drejtpërdrejtë nga rruga ekzistuese dhe është e rrethuar. Nuk parashihet shfrytëzim i përkohshëm apo i përhershëm i sipërfaqeve të tokës jashtë kufijve të parcelës kadastrale.




Figura 12. Pozita e parcelës kadastrale sipas Hartës Zonale Komunale të Lipjanit (HZK Lipjan) – destinimi komercial i zonës

3.2. Skicën dhe planimetrinë e vendndodhjes së projektit

Planimetria e parcelës kadastrale nr. 1218-2, ZK Lipjan, me kufijtë e parcelës, objektet ekzistuese dhe elementet e infrastrukturës (linja e kanalizimit, puseta, gropa sepike), është paraqitur në figurat në vijim. Parcela ka formë të rregullt të zgjatur, të orientuar përafërsisht verilindje–jugperëndim, me hyrje nga ana verilindore.



Figura 13. Situacion i ngushtë – pozita e parcelës në raport me parcelat fqinje dhe rrjetin rrugor




Figura 14. Situacion gjeodezik i parcelës dhe i zonës përreth



Figura 15. Plan i lokacionit – kufijtë e parcelës, objektet ekzistuese, linja e kanalizimit, pusetat dhe gropa septike (ortofoto, Geoportali Shtetëror)

Shënim teknik: ortofotot janë paraqitje orientuese pa shkallë. Koordinatat, kufijtë, kuotat dhe distancat zyrtare merren vetëm nga plani i rilevimit të terrenit i hartuar nga gjeodeti i licencuar (Shtojca C).

Tabela 30. Të dhënat e planimetrisë së lokacionit

Elementi i planimetrisë	Të dhënat
Forma e parcelës	E rregullt, e zgjatur; orientim përafërsisht verilindje–jugperëndim
Sipërfaqja totale	2916 m ²
Objektet ekzistuese	2 hangarë industriale, 845 m ² secili (gjithsej 1690 m ²)
Koeficienti i ndërtimit	0.58 (1690 m ² / 2916 m ²)
Sipërfaqja e lirë	1226 m ² , e asfaltuar/betonuar dhe e papërshkueshme
Hyrja / dalje	1 hyrje-dalje e drejtpërdrejtë nga rruga ekzistuese, në anën verilindore
Rrethimi	Rrethojë metalike përgjatë kufirit të parcelës
Elementet e infrastrukturës	Linjë e kanalizimit, puseta, gropë septike, pus i hapur ekzistues, panel elektrik shpërndarës
Ndërhyrje të planifikuara ndërtimore	Nuk parashihen; vetëm pajisje dhe sistemim funksional
Koordinatat e kulmeve të kufirit të parcelës (P1–Pn)	Plotësohen nga plani i rilevimit të terrenit i hartuar dhe nënshkruar nga gjeodeti i licencuar; sistemi KosovaRef01; për bashkëngjitje në Shtojcën C para dorëzimit.

Sqarim për koordinatat: koordinata Y/X e paraqitur në Tabelat 3 dhe 29 është pikë qendrore orientuese e lokacionit. Përkufizimi juridik dhe teknik i sipërfaqes bëhet vetëm me koordinatat e të gjitha kulmeve P1–Pn në planin e rilevimit të licencuar; këto të dhëna nuk duhet të zëvendësohen me vlera të përafërta ose të derivuara nga ortofoto.

3.3. Distancën me të dhënat për qendrat e banuara në raport me lokacionin ku propozohet të zbatohet projekti, shoqëruar me fotografi

Receptorët e ndjeshëm janë analizuar sipas distancës dhe rrugës së mundshme të ekspozimit, jo vetëm sipas pranisë së tyre në hartë. Tabela në vijim përmbledh distancat orientuese, të cilat konfirmohen me planin gjeodezik ose matje GIS të dokumentuar.

Tabela 31. Distancat nga receptorët e ndjeshëm dhe nga elementet kryesore hapësinore

Receptori / objekti	Distanca (m)	Drejtimi	Karakteristika
Qendra urbane e qytetit të Lipjanit	508	Lindje	Zonë e banimit dhe shërbimeve
Objekt fetar (xhami)	650	Lindje-juglindje	Objekt me ndjeshmëri sociale
Vendbanimi më i afërt – Hallaq i Vogël	901	Perëndim	Vendbanim rural i shpërndarë
Lumi Sitnica (receptor hidrografik)	450	Jugperëndim	Trup uhor sipërfaqësor
Magjistralla M-25 Prishtinë–Shtime	0 (kufi)	Verilindje	Qasje e drejtpërdrejtë

Distanca e përdorur në vlerësim deri në lumin Sitnica është rreth 450 m, sipas matjes së paraqitur në hartën e afërsisë me receptorët. Vlera trajtohet si orientuese dhe konfirmohet me planin gjeodezik ose matje GIS të dokumentuar.

Lokacioni ndodhet jashtë zonave të dendura të banimit, në zonë me karakter komercial dhe ekonomik. Distancat ekzistuese ndaj receptorëve më të ndjeshëm tejkalojnë 500 m, gjë që kontribuon në zvogëlimin e ndikimeve akustike dhe të pluhurit ndaj popullatës, sikurse vërtetohet me llogaritjet e paraqitura në nënkapitullin 2.6.




Figura 16. Afërsia e lokacionit me vendbanimet dhe me receptorët e ndjeshëm, me distancat e matura



Figura 17. Fotografi nga terreni – pamje e brendshme e lokacionit dhe e ndarjes ndaj parcelave fqinje



Figura 18. Pamje nga terreni ku zhvillohet veprimtaria

3.4. Paraqitjen e karakteristikave pedologjike, gjeomorfologjike, gjeologjike, hidrogeologjike dhe sizmologjike të terrenit

3.4.1. Karakteristikat pedologjike

Terreni karakterizohet nga toka livadhore-teltylore, e zhvilluar mbi sedimentet aluviale dhe deluviale të Fushës së Kosovës, me përbërje mekanike të mesme deri të rëndë dhe përmbajtje të konsiderueshme të fraksioneve të argjilës, pluhurit dhe rërës së imët.

- kapacitet i mirë për mbajtjen e lagështisë;
- përshkueshmëri mesatare deri e ulët në shtresat sipërfaqësore;
- stabilitet relativisht i mirë për objekte industriale pas përgatitjes së terrenit;
- pjellori natyror mesatare deri e lartë në gjendje natyrore.

Në gjendjen aktuale, rreth 2.750 m² të parcelës mbulohen nga objektet dhe sipërfaqet operative të asfaltuara/betonuara, ndërsa rreth 166 m² mbeten sipërfaqe të gjelbra. Funkzioni pedologjik në zonën operative është kufizuar para fillimit të veprimtarisë; projekti nuk duhet ta zgjerojë këtë kufizim mbi sipërfaqet e gjelbra.




Figura 19. Harta pedologjike e zonës

3.4.2. Karakteristikat gjeomorfologjike

Lokacioni ndodhet në pjesën qendrore të Fushës së Kosovës, në terren me reliev kryesisht të rrafshët deri lehtësisht valëzor. Lartësia mbidetare është ≈ 544 m, ndërsa pjerrësitë e terrenit përgjithësisht nuk kalojnë 2–5 %.

- terren i qëndrueshëm, i favorshëm për shfrytëzim industrial;
- mungesë e proceseve intensive erozive;
- mungesë e rrëshqitjeve aktive të dheut;
- drenazh natyror relativisht i mirë i ujërave sipërfaqësore.



Figura 20. Harta e relievit të zonës

3.4.3. Karakteristikat gjeologjike

Lokacioni ndodhet mbi depozitime kuaternare aluviale të lidhura me pellgun sedimentar të Kosovës. Formacionet gjeologjike përbëhen kryesisht nga rëra, zhavorre, argjila, pluhur sedimentar (silt) dhe depozitime aluviale të lumenjve e përrenjve të lashtë. Zona bën pjesë në rajonin e depozitave të linjtit të Fushës së Kosovës, ku në thellësi më të mëdha paraqiten shtresat e qymyrit linjitik.

- kapacitet i mirë mbajtës për objektet industriale ekzistuese;
- mundësi të favorshme për themele sipërfaqësore;
- nuk janë identifikuar struktura tektonike aktive apo fenomene gjeologjike që përbëjnë kufizim për veprimtarinë.

Aspekti hidrogeologjik	Karakteristika	Implikimi për projektin
Pusi ekzistues në parcelë	Pus i hapur	Shfrytëzohet ekskluzivisht si pikë monitorimi e cilësisë së ujërave nëntokësore




Figura 22. Harta hidrologjike dhe relievore e zonës




Figura 23. Harta e zonave mbishtresore – Lipjan

3.4.5. Karakteristikat sizmologjike

Sipas hartave sizmike rajonale të Kosovës, territori i Komunës së Lipjanit bën pjesë në zonën me intensitet sizmik VIII shkallë sipas MCS/MSK-64, që konsiderohet zonë me rrezik sizmik mesatar deri relativisht të lartë.

Për këtë arsye, konstruksionet ekzistuese dhe të gjitha instalimet e reja (rafte, depozita, separator, pellgje mbajtëse) duhet të verifikohen ose të projektohen në përputhje me Eurokodin 8 (EN 1998) dhe me kërkesat e legjislacionit të Republikës së Kosovës për sigurinë strukturore. Në kontekstin mjedisor, kërkesa kritike është që depozitat dhe enët e mbeturinave të rrezikshme të jenë të ankoruara dhe të vendosura mbi pellgje mbajtëse, në mënyrë që një ngjarje sizmike të mos shkaktojë derdhje të pakontrolluar.

3.4.6. Vlerësimi i përgjithshëm i përshtatshmërisë së terrenit

Bazuar në karakteristikat e identifikuara, lokacioni paraqet kushte të favorshme për veprimtarinë e planifikuar: terren i rrafshët, stabilitet i mirë gjeomorfologjik dhe gjeologjik, dhe infrastrukturë ekzistuese. Kufizimi kryesor lidhet me mbrojtjen e akuiferëve me përshkueshmëri të lartë, i cili menaxhohet përmes masave teknike të detyrueshme të përcaktuara në Kapitullin 7.

3.5. Të dhënat për burimin e furnizimit me ujë

Furnizimi me ujë dhe mënyra e shkarkimit duhet të jenë të rregullta dhe të dokumentuara nga operatori përkatës. Tabela në vijim paraqet burimin, përdorimet dhe kushtet që parandalojnë shkarkime të pakontrolluara.

Tabela 33. Të dhënat për burimin e furnizimit me ujë

Elementi	Të dhënat
Burimi kryesor	Rrjeti publik i ujësjellësit që mbulon zonën komerciale
Distanca deri në pikën e lidhjes	Lidhje ekzistuese brenda parcelës
Kapaciteti i kërkuar	$\approx 90 \text{ m}^3/\text{vit}$ ($\approx 0.36 \text{ m}^3/\text{ditë pune}$)
Matja e konsumit	Ujëmatës i instaluar; regjistrim mujor i konsumit
Burim plotësues	Pus i hapur ekzistues brenda parcelës – nuk shfrytëzohet për furnizim ; përdoret vetëm si pikë monitorimi e ujërave nëntokësore
Zona e mbrojtjes sanitare	Lokacioni nuk ndodhet brenda zonë të mbrojtjes sanitare të burimeve të furnizimit me ujë të pijshëm
Rreziku për burimin	I papërfillshëm – nuk gjenerohen ujëra teknologjike; ujërat sanitare menaxhohen të ndara
Karakteristikat hidrologjike themelore	Pellgu i Lumit Sitnica; reshje mesatare vjetore 650 mm; rrjedhje sipërfaqësore e kontrolluar përmes drenazhimit të lokacionit

3.6. Paraqitjen e karakteristikave klimatike me tregues të përshtatshëm meteorologjik

Kushtet klimatike ndikojnë në përhapjen e pluhurit, rrjedhjen e ujërave atmosferike dhe planifikimin e masave operative. Tabela në vijim përmbledh treguesit rajonale dhe shpjegon rëndësinë e tyre për lokacionin.

Tabela 34. Karakteristikat klimatike dhe meteorologjike dhe relevanca e tyre për projektin

Treguesi meteorologjik	Vlera	Relevanca për projektin
Tipi i klimës	Kontinentale e butë, me ndikime të theksuara kontinentale të Fushës së Kosovës	Kushte të favorshme për operim gjatë tërë vitit
Temperatura mesatare vjetore	10–11 °C	Pa kufizime operationale
Temperatura minimale e dimrit	Nën 0 °C, me minimume deri –15 °C	Rrezik i ngrirjes së lëngjeve në enë – kërkohet magazinim brenda objektit
Temperatura maksimale e verës	30–35 °C	Rrezik i shtuar i avullimit të hidrokarbureve dhe i zjarrit; kërkohet mbrojtje nga rrezatimi i drejtpërdrejtë i diellit
Reshjet mesatare vjetore	650–700 mm	Bazë për dimensionimin e drenazhimit dhe të separatorit (1611 m ³ /vit ujë atmosferik)
Shpërndarja e reshjeve	Maksimum në pranverë dhe vjeshtë	Periudha me rrezik më të lartë të rrjedhjes sipërfaqësore
Reshje bore	Të pranishme gjatë dimrit, kohëzgjatje e kufizuar	Kërkohet pastrim i sipërfaqeve; ndalohet përdorimi i kripës në zonat me mbeturina metalike
Drejtimi mbizotërues i erës	Veriperëndim dhe verilindje	Përcakton pozicionimin e pikës së monitorimit të PM ₁₀ në kufirin e parcelës
Shpejtësia mesatare e erës	≈ 2.0 m/s (e ulët deri mesatare)	Parametër hyrës në llogaritjen e pluhurit difuz (AP-42)
Ditë me erë të fortë	Të rralla, gjatë stuhive atmosferike	Rrezik i shpërndarjes së fraksioneve të lehta – kërkohet mbulim i boksesh




Figura 24. Harta mesatare e reshjeve dhe e temperaturave në Kosovë

3.7. Prezantimi i karakteristikave natyrore

Lokacioni ndodhet në zonë urbane të përcaktuar sipas HZK Lipjan si zonë komerciale dhe industriale. Territori përreth ka karakter të njëjtë funksional, ku dominojnë veprimtari ekonomike dhe industriale. Brenda kufijve të parcelës nuk ekzistojnë elemente natyrore të paprekura.

Tabela 35. Vlerësimi i prezencës së elementeve natyrore të ndjeshme në zonën e ndikimit

Elementi natyror i vlerësuar	Prezenca në zonën e ndikimit	Vlerësimi
Ligatina	Nuk janë identifikuar	Pa ndikim
Grykëderdhje lumore	Nuk janë identifikuar	Pa ndikim

Elementi natyror i vlerësuar	Prezenca në zonën e ndikimit	Vlerësimi
Ujëra sipërfaqësore	Lumi Sitnica, ≈ 450 m në jugperëndim	Pa ndikim të drejtpërdrejtë; ndikim i mundshëm indirekt vetëm në rast dështimi të masave – i menaxhuar përmes separatorit
Toka bujqësore	Sipërfaqe bujqësore në pjesën perëndimore të zonës	Pa ndikim – nuk ka zaptim të sipërfaqeve bujqësore
Zona malore dhe pyjore	Nuk janë të pranishme në zonën e ndikimit	Pa ndikim
Zona të mbrojtura natyrore	Lokacioni nuk ndodhet brenda apo në afërsi të drejtpërdrejtë të zonë të mbrojtur	Pa ndikim
Zona me popullsi të dendur	Qendra urbane e Lipjanit, ≈ 508 m në lindje	Ndikim akustik dhe i pluhurit i vlerësuar nën vlerat referuese
Zona me rëndësi historike, kulturore ose arkeologjike	Nuk janë identifikuar brenda lokacionit apo në afërsi të drejtpërdrejtë	Pa ndikim
Habitatet e ndjeshme dhe speciet e mbrojtura	Nuk është kryer inventar sezonal; parcela ka rreth 166 m ² sipërfaqe të gjelbra dhe ndodhet në zonën më të gjerë të korridorit të Sitnicës	Ndikim i drejtpërdrejtë i ulët, i kushtëzuar me ruajtjen e sipërfaqeve të gjelbra dhe parandalimin e shkarkimeve



Figura 25. Sipërfaqe të gjelbra brenda kufijve të parcelës (majtas) dhe pamje e përgjithshme e zonës (djathtas)

3.8. Rishikimi i karakteristikave themelore të peisazhit

Peizazhi i zonës është urban-industrial, i formuar nga zhvillimi i veprimtarive ekonomike dhe infrastrukture në zonën komerciale të Lipjanit. Dominon një mozaik objektsh industriale, magazinash dhe sipërfaqesh të hapura të shfrytëzuara për veprimtari teknike dhe logjistike. Relievi i rrafshët kontribuon në peizazh vizual të hapur, ku objektet janë të dukshme në distanca mesatare.

Prania e zonave bujqësore në perëndim krijon tranzicion të butë vizual nga zona industriale drejt peizazhit rural. Peizazhi nuk ka vlera të veçanta natyrore apo estetike të mbrojtura, pasi është tashmë i transformuar nga veprimtaria njerëzore.

Vlerësim: veprimtaria nuk shkakton ndryshim të karakterit vizual të zonës, pasi zhvillohet në objekte ekzistuese dhe nuk ndryshon vëllimin e ndërtimit. Rreziku i vetëm vizual lidhet me stivimin e pakontrolluar të fraksioneve metalike në hapësirën e jashtme; për këtë arsye lartësia maksimale e stivimit është kufizuar në 1.8 m dhe magazinimi i pjesës më të madhe të fraksioneve është planifikuar brenda hangarëve.



Figura 26. Karakteristikat themelore të peizazhit urban-industrial të zonës

3.9. Rishikimi i objekteve të mbrojtura të trashëgimisë kulturore dhe historike

Lokacioni ndodhet në zonë komerciale/industriale të zhvilluar dhe nuk është i regjistruar si hapësirë me vlera të veçanta të trashëgimisë kulturore apo historike. Sipas të dhënave të Planit Hapësinor dhe të HZK-së të Komunës së Lipjanit, zona përreth është kryesisht e transformuar nga veprimtaritë urbane dhe ekonomike, pa prezencë të monumenteve të mbrojtura në afërsi të drejtpërdrejtë të parcelës.

Objekti fetar më i afërt (xhamia) ndodhet në distancë prej ≈ 650 m dhe nuk ka status të trashëgimisë kulturore të mbrojtur. Në distanca më të largëta të Komunës së Lipjanit gjenden elemente të trashëgimisë kulturore dhe arkeologjike me rëndësi lokale dhe kombëtare, por këto nuk ndodhen në zonën e ndikimit të projektit.

Duke qenë se nuk parashihen gërmime apo punime tokësore, rreziku i gjetjeve arkeologjike të rastësishme është i papërfillshëm. Megjithatë, në rast të gjetjeve eventuale gjatë punimeve të riparimit të sipërfaqeve, aplikuesi obligohet të ndalë punimet dhe të njoftojë menjëherë institucionet kompetente të trashëgimisë kulturore.

3.10. Të dhënat për popullsinë, përqendrimin e popullsisë dhe karakteristikat demografike në lidhje me projektin e planifikuar

Ekspozimi i popullsisë varet nga dendësia, distanca, drejtimi i transportit dhe natyra e receptorëve përreth. Tabela në vijim paraqet të dhënat demografike të përdorura dhe kufizimet e tyre në nivel lokal.

Tabela 36. Të dhënat demografike dhe popullsia potencialisht e ekspozuar

Treguesi demografik	Vlera	Burimi
Popullsia e Komunës së Lipjanit	≈ 55 044 banorë	Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), Regjistrimi i Popullsisë 2024
Popullsia e qytetit të Lipjanit	≈ 13 092 banorë	ASK, Regjistrimi 2024
Vendbanimi më i afërt (Hallaq i Vogël)	Vendbanim rural i shpërndarë, ≈ 901 m	Analizë hartografike
Densiteti i banimit në zonën e projektit	I ulët – zonë komerciale/industriale	HZK Lipjan
Popullsia rezidente brenda rrezes 200 m	Nuk është identifikuar banim i përhershëm	Analizë hartografike dhe vizitë në terren
Popullsia potencialisht e ekspozuar (rrezja 500–1 000 m)	Banorë të periferisë lindore të qytetit dhe të vendbanimit Hallaq i Vogël	Analizë hartografike
Punësimi i drejtpërdrejtë nga projekti	6 vende pune	Të dhëna të aplikuesit

Duke qenë se zona ka densitet më të lartë të veprimtarive ekonomike sesa të banimit, ndikimi i drejtpërdrejtë në popullsinë rezidente është i kufizuar. Ndikimi social kryesor lidhet me punësimin dhe me veprimtarinë ekonomike lokale.

3.11. Të dhëna për objektet ekzistuese

Objektet ekzistuese brenda parcelës përcaktojnë organizimin e punës, ndërsa objektet përreth ndikojnë në ndjeshmërinë e zonës. Tabela në vijim identifikon funksionin, gjendjen dhe relevancën mjedisore të tyre.

Tabela 37. Objektet ekzistuese brenda dhe përreth lokacionit

Kategoria	Objektet e identifikuar	Distanca / pozita	Ndjeshmëria
Brenda parcelës	2 hangarë industriale, 845 m ² secili; sipërfaqe të asfaltuara; gropë septike; pus i hapur	Brenda kufijve	—
Objekte industriale/komerciale fqinje	Qendra për grumbullimin dhe përpunimin e materialeve metalike; depo materialeve ndërtimore; betonjerë; shërbime logjistike	Ngjitur dhe në afërsi të drejtpërdrejtë	E ulët – funksion i njëjtë
Objekte banimi	Banim i shpërndarë në periferi	> 500 m	E lartë
Objekte infrastrukturore	Magjistrallja M-25; rrjeti elektrik; ujësjellësi; kanalizimi	Ngjitur	E ulët
Objekte sociale (shkolla, objekte shëndetësore, çerdhe)	Nuk janë identifikuar brenda rrezes 500 m	> 500 m	E lartë – pa ekspozim
Objekte fetare	Xhami	≈ 650 m	E lartë – ndjeshmëri akustike



Figura 27. Ortofoto e zonës me objektet ekzistuese brenda dhe përreth parcelës (Geoportali Shtetëror)

3.12. Në varësi të karakteristikave të zonës, përshkrimi i lokacionit përmban edhe të dhëna për zonat e përcaktuara për kërkime shkencore, vendet arkeologjike, zonat veçanërisht të ndjeshme, zonat me qëllime të veçanta dhe të ngjashme

Kontrolli hapësinor nuk ka identifikuar mbivendosje të drejtpërdrejtë me zona të mbrojtura ose vende të veçanta, por kjo nuk zëvendëson verifikimin institucional. Tabela në vijim paraqet kategoritë e kontrolluara, burimin e të dhënave dhe përfundimin e kushtëzuar.

Tabela 38. Vlerësimi i prezencës së zonave të veçanta dhe të ndjeshme

Kategoria e zonës	Prezenca	Baza e vlerësimit
Zonë e përcaktuar për kërkime shkencore	Nuk është identifikuar	HZK Lipjan; Plani Hapësinor i Komunës
Vend arkeologjik i regjistruar	Nuk është identifikuar	Të dhënat e institucioneve të trashëgimisë kulturore
Zonë veçanërisht e ndjeshme mjedisore	Nuk është identifikuar	Regjistri i zonave të mbrojtura
Zonë e mbrojtur natyrore (park, rezervë, monument natyre)	Nuk është identifikuar	Regjistri i zonave të mbrojtura
Zonë e rrjetit Natura 2000 / zonë e propozuar	Nuk është identifikuar	Të dhënat e disponueshme institucionale
Zonë e mbrojtjes sanitare të burimeve ujore	Nuk është identifikuar	Të dhënat e operatorit të shërbimeve të ujit
Zonë me qëllim të veçantë (ushtarake, e sigurisë)	Nuk është identifikuar	HZK Lipjan
Zonë e rrezikuar nga vërshime	Nuk është identifikuar brenda parcelës; Lumi Sitnica në distancë ≈ 450 m	Analizë relievore dhe hartografike

Vërejtje: konfirmimi zyrtar i mospërkatësisë ndaj zonave të mbrojtura dhe zonave të mbrojtjes sanitare duhet të merret me shkrim nga institucionet kompetente dhe të bashkëngjitet në Shtojcën 12.

3.13. Të dhënat për burimet ujore në sipërfaqen ku realizohet projekti dhe në afërsi të saj

Ujërat nëntokësore përbëjnë receptorin më të ndjeshëm, ndërsa Sitnica është trupi sipërfaqësor më i afërt i identifikuar. Tabela në vijim përmbledh lidhjet e mundshme, distancat dhe masat e kontrollit për secilin burim ujor.

Tabela 39. Burimet ujore në zonën e projektit dhe relacioni i tyre me veprimtarinë

Burimi ujor	Pozita / distanca	Karakteristika	Relacioni me projektin
Lumi Sitnica	≈ 450 m në jugperëndim	Receptor kryesor hidrografik i rajonit; gjendje ekologjike e ndikuar nga shkarkimet urbane dhe industriale përgjatë rrjedhës	Receptor përfundimtar i mundshëm i ujërave atmosferike; pa shkarkim të drejtpërdrejtë
Akuiferi aluvial	Nën lokacionin, thellësi e ndryshueshme	Porozitet intergranular; përshkueshmëri e lartë deri mesatare	Receptor i më i ndjeshëm – kërkon masa të detyrueshme mbrojtëse
Pus i hapur ekzistues	Brenda parcelës	Pus i hapur, thellësi e cekët	Pikë monitorimi e cilësisë së ujërave nëntokësore; nuk shfrytëzohet për furnizim
Rrjeti publik i ujësjellësit	Lidhje brenda parcelës	Furnizim i kontrolluar	Burim i vetëm i furnizimit me ujë
Përrenj sezonale	Nuk janë identifikuar në afërsi të drejtpërdrejtë	—	—

4. GJENDJA AKTUALE E FAKTORËVE MJEDISOR

4.1. Raport për gjendjen aktuale të faktorëve mjedisor

Gjendja aktuale (gjendja bazë – baseline) është vlerësuar duke marrë parasysh karakterin ekzistues industrial dhe komercial të zonës, praninë e veprimtarive të ngjashme në afërsi, nivelin e transformimit antropogjenik të mjedisit dhe të dhënat mjedisore të disponueshme. Vlerësimi paraqet ndarje të qartë ndërmjet fakteve të konstatuara, supozimeve dhe boshllëqeve të të dhënave.

4.1.1. Gjendja aktuale sipas faktorëve mjedisorë

Gjendja aktuale është përshkruar nga të dhëna dokumentare dhe vërtetimi, por për disa faktorë mungojnë matje lokale. Tabela në vijim dallon të dhënat e konfirmuara nga ato orientuese dhe përcakton verifikimet bazë që duhen kryer.

Tabela 40. Gjendja aktuale e faktorëve mjedisor dhe cilësia e të dhënave

Faktori mjedisor	Gjendja aktuale e konstatuar	Burimi kryesor i ngarkesës ekzistuese	Cilësia e të dhënave
Cilësia e ajrit	Mesatare; ngritje lokale dhe të përkohshme të pluhurit (PM ₁₀ , PM _{2.5}); pa përqendrim ekstreme të vazhdueshme	Veprimtaritë industriale përreth; qarkullimi i mjeteve të rënda në M-25; djegia e karburanteve fosile	E tërthortë – nuk ka stacion monitorimi në zonë; kërkohet matje bazë
Ujërat sipërfaqësore	Lumi Sitnica – cilësi e ulët deri mesatare në segmente të veçanta	Shkarkime urbane dhe industriale përgjatë rrjedhës	E tërthortë – të dhëna rajonale të AMMK-së
Ujërat nëntokësore	Pa të dhëna për ndotje të theksuar lokale brenda parcelës; ndjeshmëri e lartë ndaj ndotjes	Potencial nga veprimtaritë ekzistuese metalpunuese në zonë	Boshllëk i të dhënave – kërkohet kampionim bazë në pusin ekzistues
Toka	Pjesërisht e transformuar: 1.690 m ² objekte, rreth 1.060 m ² sipërfaqe operative të papërshtueshme dhe rreth 166 m ² sipërfaqe të gjelbra; pa ndotje të dokumentuar	Veprimtaritë industriale ekzistuese në zonë	Boshllëk i të dhënave – kërkohet kampionim bazë në zonën e depolutimit
Zhurma	Mesatare deri e ngritur gjatë orarit të punës; qetësi relative jashtë orarit	Makineritë e punës në zonë; kamionët transportues; M-25	E tërthortë – kërkohet matje bazë në kufirin e parcelës
Biodiversiteti dhe vegjetacioni	I kufizuar; vegjetacion i rrallë ruderal jashtë kufijve të asfaltuar; brenda parcelës praktikisht i mangut	Urbanizim dhe industrializim i zonës	E drejtpërdrejtë – vizitë në terren
Peizazhi	Urban-industrial, i transformuar; pa vlera estetike të mbrojtura	Zhvillimi i zonës komerciale	E drejtpërdrejtë – vizitë në terren
Trashëgimia kulturore	Pa elemente të mbrojtura brenda zonës së ndikimit	—	E tërthortë – të dhëna institucionale
Ndotja e trashëguar (historike)	Nuk është identifikuar ndotje e dokumentuar; nuk përjashtohet ndotje lokale nga veprimtaritë e mëparshme	Veprimtari e mëparshme e ngjashme në parcelën ngjitur	Boshllëk i të dhënave – kërkohet kampionim bazë

4.1.2. Boshllëqet e të dhënave dhe monitorimi bazë i detyrueshëm

Vlerësimi ka identifikuar boshllëqe të të dhënave për cilësinë lokale të ujërave nëntokësore, tokës, ajrit dhe zhurmës. Meqë veprimtaria është ekzistuese, matjet e reja nuk quhen “matje zero”, por matje bazë referuese

nga data e kampionimit. Ato duhet të kryhen dhe dokumentohen para operimit të plotë dhe para pranimit/depolutimit të mbeturinave të rrezikshme.

Tabela 41. Programi i monitorimit bazë (matja bazë referuese) – i detyrueshëm

Matja bazë	Pika e matjes	Parametrat	Metoda / standardi	Afati
Ujërat nëntokësore	Së paku dy pika të përcaktuara hidrogeologjikisht: një pikë referuese sipër rrjedhjes hidraulike dhe një piezometër poshtë rrjedhjes. Pusi ekzistues mund të përdoret vetëm nëse plotëson kriteret teknike; përndryshe instalohen pikat e nevojshme.	pH, përcjellshmëri elektrike, hidrokarbure totale (C ₁₀ –C ₄₀), Pb, Zn, Cu, Cd, Cr, Ni	Kampionim dhe analizë në laborator të akredituar	Para operimit të plotë dhe para pranimit të rrjedhave të rrezikshme
Toka	2 pika – zona e depolutimit dhe zona e magazinimit të lëngjeve	Metale të rënda (Pb, Zn, Cu, Cd, Cr, Ni), TPH	Kampionim 0–30 cm nën shtresën e papërshkueshme; laborator i akredituar	Para operimit të plotë
Cilësia e ajrit (imision)	Së paku dy pika: një sipër erës dhe një nën erë. Kur era vjen nga veriperëndimi/verilindja, pika nën erë vendoset në sektorin juglindor/jugperëndimor (JL/JP); drejtimi real dokumentohet gjatë kampionimit.	PM ₁₀ dhe PM _{2.5} (mesatare 24-orëshe, 7 ditë); Pb, Cd dhe Ni në fraksionin PM ₁₀ kur masa e mostrës lejon analizë të vlefshme	Metoda gravimetrike sipas EN 12341	Para operimit të plotë
Zhurma	3 pika në kufirin e parcelës drejt receptorëve	LAeq ditor, L _A max	ISO 1996-2	Para operimit të plotë
Papërshkueshmëria e gropës septike	Gropa septike	Test i papërshkueshmërisë; përcaktim i vëllimit të dobishëm	Provë hidrostatike	Para operimit të plotë

Kusht ndalues i matshëm: rezultatet e matjeve bazë të ujërave nëntokësore, tokës, ajrit dhe zhurmës, testi i papërshkueshmërisë së gropës septike dhe certifikatat e laboratorit duhet të jenë të dokumentuara para operimit të plotë dhe para pranimit ose depolutimit të mbeturinave të rrezikshme. Deri atëherë nuk lejohet deklarimi i pajtueshmërisë numerike me vlerat kufi.

4.1.3. Ndryshimet e mundshme në gjendjen e mjedisit nëse projekti nuk zbatohet

Në përputhje me nenin 8 të UA (MMPHI) nr. 04/2025, paraqiten ndryshimet e pritshme në gjendjen e mjedisit në rast të mos zbatimit të projektit:

- Alternativa ligjore pa projekt: ndërpritet pranimi; të gjitha mbeturinat ekzistuese inventarizohen dhe dorëzohen te operatorë të licencuar; sipërfaqet, depozitat, separatori dhe gropa septike pastrohen; kryhet kampionimi verifikues dhe rehabilitimi sipas rezultateve. Braktisja e mbeturinave nuk merret si alternativë e lejueshme.
- Rrjedhat e ardhshme të mbeturinave do të orientoheshin drejt operatorëve të tjerë të licencuar. Distanca e transportit dhe shkalla e rikuperimit varen nga operatorët alternativë dhe nuk mund të parashikohen pa kontrata.

- Automjetet jashtë përdorimit nuk do të pranoheshin në këtë lokacion dhe duhet të dorëzoheshin te qendra të tjera të autorizuar për depolitim dhe çmontim.
- Përfitimi klimatik nga rikuperimi i materialeve do të zhvendosej te operatorët alternativë; vlerat e CO₂e në këtë raport janë vetëm vlerësime indikative dhe jo rezultat i verifikuar i projektit.
- **Aspekti socio-ekonomik:** do të humbeshin 6 vende pune të drejtpërdrejta dhe kontributi në zinxhirin lokal të riciklimit.
- **Gjendja e faktorëve mjedisorë:** cilësia e ajrit, e zhurmës dhe e peizazhit në zonë do të mbetet praktikisht e pandryshuar, pasi kontributi i projektit ndaj ngarkesës ekzistuese është i vogël.

Përfundim: alternativa pa projekt është mbyllja dhe rehabilitimi i kontrolluar, jo lënia e mbeturinave në lokacion. Projekt është i pranueshëm vetëm nëse masat paraprake të Kapitullit 7 zbatohen para operimit të plotë dhe verifikohen me dokumente.



Figura 28. Lokacioni i parcelës ku zhvillohet veprimtaria – gjendja aktuale

5. PËRSHKRIMI I ALTERNATIVAVE TË PROJEKTIT

5.1. Përshkrimi i alternativave të realizueshme

Duke qenë se veprimtaria zhvillohet në objekte ekzistuese, hapësira e alternativave është e kufizuar. Janë analizuar pesë alternativa të realizueshme, të lidhura me hartimin e projektit, teknologjinë, lokacionin, madhësinë dhe qëllimin e projektit.

Tabela 42. Përmbledhja e alternativave të analizuara dhe vendimi

Alternativa	Përshkrimi	Vlerësimi mjedisor	Vendimi
A0 – Pa veprim	Moszbatimi i projektit; ndërprerja e pranimit; transferimi i mbeturinave të operatorë të licencuar; pastrimi, verifikimi dhe rehabilitimi	Ndikim i ulët nëse mbyllja zbatohet ligjërisht; humbet kapaciteti lokal dhe gjashtë vende pune	Nuk është zgjedhur për arsye funksionale dhe socio-ekonomike; shih 5.21
A1 – Lokacion alternativ	Zhvendosja e veprimtarisë në lokacion të re	Kërkon zaptim të sipërfaqes së re, ndërtim të objekteve dhe infrastrukturës; ndikim më i lartë kumulativ; humbje të infrastrukturës ekzistuese	Refuzuar – shih 5.3
A2 – Teknologji me grimcim (shredder)	Instalimi i impianti të grimcimit mekanik të automjeteve	Emetime dukshëm më të larta të pluhurit dhe zhurmës; kërkesë e lartë energjetike; gjenerim i fraksionit të lehtë (fluff) të klasifikuar si mbeturinë e rrezikshme; kërkon licencë të veçantë	Refuzuar – shih 5.5
A3 – Kapacitet i zgjeruar (> 5 000 t/vit)	Rritja e kapacitetit të pranimit mbi kufijtë e lokacionit	Tejkalim i kapacitetit të magazinimit të sigurt; rritje e trafikut dhe e ndikimeve akustike; pamundësi e ndarjes së duhur të fraksioneve në 2916 m ²	Refuzuar – shih 5.11
A4 – Alternativa e zgjedhur	Grumbullim dhe klasifikim; trajtim paraprak mekanik R12; magazinim i përkohshëm R13; depolitim dhe çmontim R12, me kapacitet projektues 2.000 t/vit dhe me masa teknike paraprake	Ndikime të pritshme të ulëta dhe të kontrollueshme, të kushtëzuara me matjet bazë, masat teknike dhe verifikimin vjetor të destinacionit të rrjedhave	E ZGJEDHUR

5.2. Përshkrimi i alternativave të realizueshme përmban edhe përshkrimin e arsyeve kryesore për zgjedhjen e një alternative të caktuar

Arsyet kryesore për zgjedhjen e alternativës A4 janë të natyrës mjedisore, teknike dhe ekonomike, dhe analizohen në nënkapitujt 5.3 – 5.20 sipas kriterëve të përcaktuara në nenin 9, paragrafi 2 të UA (MMPHI) nr. 04/2025. Përmbledhja e arsyeve:

- 1) Shfrytëzimi i objekteve dhe i infrastrukturës ekzistuese eliminon nevojën për zaptim të sipërfaqes së re dhe për ndërtim, duke evituar ndikimet e fazës së ndërtimit.
- 2) Zgjedhja e çmontimit manual në vend të grimcimit mekanik redukton në mënyrë të konsiderueshme emetimet e pluhurit, zhurmën, konsumin e energjisë dhe gjenerimin e fraksionit të lehtë të rrezikshëm.
- 3) Kufizimi i kapacitetit në 2000 t/vit garanton që sasia e magazinuar të mbetet brenda kapacitetit të sigurt të ndarjes dhe të mbrojtjes së fraksioneve.

- 4) Vendorsja e të gjitha operacioneve mbi sipërfaqe të papërshkueshme, me pellgje mbajtëse dhe separator koalescent, adreson drejtpërdrejt kufizimin kryesor mjedisor të lokacionit – akuiferin me përshkueshmëri të lartë.
- 5) Distanca ndaj receptorëve të ndjeshëm (> 500 m) e zvogëlon ekspozimin e prithshëm ndaj zhurmës; pajtueshmëria me vlerat referuese verifikohet me matje bazë dhe operative, ndërsa barriera akustike vendoset nëse rezultatet ose ankesat e arsyetuara e kërkojnë.
- 6) Projekti krijon potencial për rikuperim të materialeve. Bilanci i gazeve serrë është vetëm skenar indikativ me faktorë të përgjithshëm; nuk paraqitet si rezultat i verifikuar dhe përditësohet me sasitë reale të transferuara dhe operacionet e operatorëve pranues.

5.3. Vendndodhjes ose rrugës

Alternativat e vendndodhjes vlerësohen ndaj përdorimit të tokës, receptorëve, infrastrukturës dhe rrezikut të ndotjes. Tabela në vijim tregon arsyet pse lokacioni ekzistues mund të mbahet vetëm me zbatimin e masave teknike paraprahe.

Tabela 43. Krahësimi i alternativave të vendndodhjes

Kriteri	Lokacioni ekzistues (A4)	Lokacion alternativ (A1)
Zaptimi i sipërfaqes së re	Zero – objekte ekzistuese	Kërkon 3 000–5 000 m ² sipërfaqe të re
Faza e ndërtimit	Nuk aplikohet	Gërmime, themele, ndërtim – emetime pluhuri, zhurmë, mbeturina ndërtimore
Infrastruktura	Ekzistuese: qasje rrugore, energji, ujë, kanalizim	Kërkon ndërtim ose zgjerim
Distanca ndaj receptorëve	> 500 m ndaj banimit; > 650 m ndaj objektit fetar	E papërcaktuar; rrezik i distancave më të vogla
Përputhshmëria me HZK	E konfirmuar – zonë komerciale	Kërkon verifikim dhe procedura të reja planifikuese
Ndjeshmëria hidrogeologjike	E identifikuar; e menaxhueshme me masa teknike	E panjohur; mund të jetë më e pafavorshme
Qasja në korridorin e transportit	Qasje e drejtpërdrejtë nga M-25 – minimizon kilometrazhin brenda zonave të banuara	Rrezik i kalimit të mjeteve të rënda nëpër zona banimi
Vlerësim	I favorshëm	I pafavorshëm



Figura 29. Vendndodhja e projektit dhe rrjeti rrugor i qasjes

5.4. Ndikimet në mjedis dhe shëndetin e njeriut

Çdo alternativë krijon profil të ndryshëm ndikimesh për mjedisin dhe shëndetin e njeriut. Tabela në vijim krahason ndikimet pas masave dhe evidenton kushtet që e bëjnë variantin e zgjedhur të pranueshëm.

Tabela 44. Krahasimi i ndikimeve në mjedis dhe në shëndetin e njeriut sipas alternativave

Faktori	A0 – Pa veprim	A2 – Grimcim mekanik	A4 – Alternativa e zgjedhur
Ajri (pluhur)	Pa emetime operative pas pastrimit; ndikim i ulët	I lartë – grimcimi gjeneron sasi të mëdha pluhuri; kërkon sistem aspirimi dhe filtër	I ulët sipas inventarit paraprak; verifikohet me matje bazë dhe monitorim, jo me përqendrim të modeluar
Zhurma	Pa burime operative zhurme	I lartë – grimcuesi gjeneron $L_w > 115 \text{ dB(A)}$	I ulët sipas vlerësimit orientues; pajtueshmëria verifikohet me matje të zhurmës në kufi dhe te receptorët
Ujërat nëntokësore	I ulët pas largimit të mbeturinave dhe verifikimit të ujërave	I moderuar – kërkon trajtim të ujërave të procesit	I ulët – sipërfaqe të papërshkueshme, pellgje mbajtëse, separator
Toka	I ulët pas pastrimit, kampionimit dhe rehabilitimit sipas rezultateve	I moderuar	I ulët – kontakt i eliminuar me tokën
Mbeturinat	Mbeturinat transferohen te operatorë të licencuar; nuk lejohen të mbeten	I moderuar – gjenerim i fraksionit të lehtë (fluff) të rrezikshëm	I ulët dhe i menaxhueshëm – $\approx 48.5 \text{ t/vit}$ rrjedha të veta, prej të cilave $\approx 45.0 \text{ t/vit}$ janë ujëra/llumra sanitare të larguara me autocisternë; 2.0 t/vit janë të rrezikshme

Faktori	A0 – Pa veprim	A2 – Grimecim mekanik	A4 – Alternativa e zgjedhur
Shëndeti i punëtorëve	Nuk aplikohet pas mbylljes; rreziku menaxhohet gjatë çmobilizimit	Rrezik i lartë mekanik dhe i ekspozimit ndaj pluhurit	Rrezik i moderuar mekanik, i kontrollueshëm me PMP dhe procedura
Shëndeti i popullatës	Neutral pas mbylljes së kontrolluar	Rrezik nga pluhuri dhe zhurma	I papërfillshëm – distanca > 500 m
Energjia / GES	Pa konsum në lokacion; rrjedhat e riciklueshme kalojnë te operatorë të tjerë	Konsum i lartë – grimcuesi > 400 kW	33,4 MWh/vit sipas skenarit; bilanci i GES është indikativ dhe përditësohet me të dhëna reale

5.5. Proceset, teknologjia e prodhimit

Proceset janë krahasuar sipas intensitetit të pluhurit, zhurmës, energjisë dhe rrezikut nga mbeturinat e rrezikshme. Tabela në vijim arsyeton përzgjedhjen e operacioneve mekanike paraprake pa shkrirje, djegie ose riciklim përfundimtar në lokacion.

Tabela 45. Krahasimi i teknologjive dhe arsytet e zgjedhjes

Operacioni	Teknologjia e zgjedhur (A4)	Teknologji alternative	Arsyeja e zgjedhjes
Çmontim i automjeteve	Manual, me vegla pneumatike dhe ngritës hidraulik	Grimecim mekanik (shredder); prerje me flakë	Emetime dhe zhurmë dukshëm më të ulëta; nuk gjeneron fraksion të lehtë të rrezikshëm; mundëson rikuperim më të lartë të pjesëve për ripërdorim; nuk kërkon licencë për trajtim termik
Depolutim	Heqje me gravitet dhe me pompë vakuumi, mbi platformë me pellg mbajtës	Heqje pa platformë të dedikuara	Eliminon rrezikun e derdhjes në tokë; mundëson grumbullim të plotë të lëngjeve
Klasifikim	Manual, i mbështetur me mjete mekanike të manipulimit	Klasifikim automatik me separator magnetik dhe eddy-current	Investim i papërshtatshëm për kapacitetin 2000 t/vit; klasifikimi manual arrin saktësi të mjaftueshme për kodifikim
Reduktim vëllimi	Presë hidraulike (ngjeshje e ftohtë), 15 kW	Prerje me gijotinë; prerje me flakëoksi-acetileni	Proces i thatë, pa emetime termike; konsum i ulët energjetik; pa rrezik zjarri nga flakë e hapur
Trajtim i ujërave atmosferike	Separator koalescent klasa I, NS 15 (EN 858)	Shkarkim pa trajtim; pellg sedimentimi	Klasa I garanton përmbajtje hidrokarburesh ≤ 5 mg/l; e domosdoshme për akuifer të ndjeshëm
Trajtim i vajrave	Nuk kryhet – dorëzim tek operator i licencuar	Rigjenerim në lokacion	Kërkon licencë të veçantë për trajtim fiziko-kimik; kapaciteti nuk e justifikon; rrezik mjedisor i shtuar

5.6. Metodat e punës gjatë zbatimit dhe funksionimit të projektit

Metodat e punës janë të standardizuara përmes procedurave të shkruara operative (SOP), të cilat përcaktojnë renditjen e operacioneve, përgjegjësitë dhe kriteret e kontrollit. Procedurat minimale të detyrueshme:

Tabela 46. Procedurat operative standarde të detyrueshme

Nr.	Procedura operative standarde (SOP)	Përmbajtja kryesore
SOP-01	Pranimi dhe kontrolli i mbeturinave	Verifikimi i fletë-përcjellëses; kontroll vizual; peshimi; kriteret e refuzimit; regjistrimi
SOP-02	Identifikimi dhe kodifikimi sipas Katalogut	Zbatimi i Hapave 1–4 të UA nr. 13/2013; etiketimi i boksesh dhe enëve
SOP-03	Depolutimi i automjeteve jashtë përdorimit	Renditja e detyrueshme e heqjes së lëngjeve dhe komponentëve; kontrolli i plotësisë; ndryshimi i statusit 16 01 04* → 16 01 06
SOP-04	Çmontimi mekanik	Renditja e demontimit; ndarja sipas materialit; identifikimi i pjesëve për ripërdorim
SOP-05	Magazinimi i mbeturinave të rrezikshme	Kushtet e enëve; pellgjet mbajtëse; ndalimi i përzierjes; afatet maksimale
SOP-06	Presimi dhe paketimi	Kushtet e sigurisë; etiketimi i balave
SOP-07	Dorëzimi tek operatorët e licencuar	Verifikimi i licencës; plotësimi i fletë-përcjellëses; arkivimi i konfirmimit
SOP-08	Reagimi ndaj derdhjeve aksidentale	Izolimi; mbulimi me absorbues; grumbullimi; kodifikimi 15 02 02*; raportimi
SOP-09	Reagimi ndaj zjarrit	Alarmimi; evakuimi; fikja fillestare; njoftimi i shërbimit të zjarrfikjes
SOP-10	Mirëmbajtja e separatorit dhe e gropës septike	Frekuenca e inspektimit; kriteret e zbrazjes; dokumentimi
SOP-11	Mbajtja e ditarit të mbeturinave	Të dhënat e detyrueshme; afatet e regjistrimit; arkivimi
SOP-12	Pastrimi i sipërfaqeve operative	Frekuenca; ndalimi i shpëlarjes drejt tokës; drejtimi i ujërave në separator




Figura 30. Skema e metodave të punës, e masave të mbrojtjes së mjedisit dhe e masave të sigurisë në punë

5.7. Planin e lokacionit

Plani i lokacionit dhe organizimi funksional i zonave paraqiten në Figurën 3 (skema e zonimit) dhe në Figurën 15 (plani i lokacionit mbi ortofoto). Bilanci i sipërfaqeve është paraqitur në Tabelën 6. Kriteret e organizimit funksional të zgjedhur:

- ndarja e plotë e rrjedhave të mbeturinave të rrezikshme (Hangari 2) nga fraksionet jo të rrezikshme (Hangari 1);
- vendosja e zonës së depolutimit brenda objektit, në pikën më të largët nga hyrja dhe nga kufiri i parcelës;
- qarkullim njëkahor i mjeteve transportuese, me hyrje dhe dalje përmes pikës së kontrollit;
- vendosja e separatorit në pikën më të ulët të drenazhimit të sipërfaqes me rrezik ndotjeje;
- ruajtja e korridoreve të lirë për qasjen e mjeteve të zjarrfikjes në të dy hangarët.

5.8. Llojin dhe përzgjedhjen e materialeve për realizimin e projektit

Pajisjet dhe materialet mbrojtëse zgjidhen sipas përputhshmërisë kimike, qëndrueshmërisë dhe aftësisë për të kufizuar derdhjet. Tabela në vijim lidh secilin element me funksionin e tij mjedisor dhe kriterin e pranim.

Tabela 47. Materialet dhe pajisjet e përzgjedhura dhe funksioni mjedisor i tyre

Materiali / pajisja	Specifikimi teknik	Funksioni mjedisor
Shtresë e papërshkueshme	Asfalt-beton ose beton i klasës $\geq C25/30$, me trajtim sipërfaqësor rezistent ndaj hidrokarbureve	Barrierë kundër infiltrimit drejt akuiferit
Separator koalescent	Klasa I sipas EN 858, NS 15, rezervuar rërë-baltë $\geq 1\,500\text{ l}$, kapacitet vaji $\geq 200\text{ l}$, alarm i nivelit	Mbrojtje e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore

Materiali / pajisja	Specifikimi teknik	Funksioni mjedisor
Pellgje mbajtëse	Polietilen ose çelik i galvanizuar, vëllim $\geq 110\%$ i enës më të madhe	Mbajtja e derdhjeve aksidentale
Depozita për vajra	Çelik me mure të dyfishta ose enë IBC mbi pellg mbajtës, me etiketim dhe ventilim	Parandalimi i derdhjeve
Kontejner për akumulatorë	Polietilen acid-rezistent, i mbuluar, me kapak	Parandalimi i derdhjes së elektrolitit dhe i kontaktit me reshjet
Absorbues	Granulat mineral ose rërë kuarci, kapacitet absorbimi $\geq 1:1$	Reagim i shpejtë ndaj derdhjeve
Fikëse zjarri	Pluhur ABC 6 kg; CO ₂ 5 kg për instalime elektrike	Mbrojtje kundër zjarrit
Sinjalistikë dhe etiketa	Materiale rezistente ndaj kushteve atmosferike; simbole sipas standardeve	Identifikim i kodeve dhe i rrezikshmërisë
Pajisje mbrojtëse personale	Doreza mekanike, syze, mbrojtje respiratore FFP2, veshje e dukshme, mbathje sigurie S3	Mbrojtja e shëndetit të punëtorëve

MATERIALET E PËRDORURA PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT

MATERIALE NDËRTIMORE



Betoni i armuar
Për dysheme, themele dhe struktura mbajtëse.



Shtresa mbrojtëse rezistente
Rezistente ndaj vajrave, karburanteve dhe substancave kimike.



Struktura metalike çeliku
Për hangare, mbulesa dhe konstruksione ndihmëse.



Panele sanduiç
Për mure dhe çati, izolim termik dhe akustik.



Sisteme kullimi
Kanale dhe pusët a për mbledhjen e ujërave industriale.

MATERIALE PËR SISTEMET E MAGAZINIMIT DHE PËRMBAJTJES



Kontejnerë metalikë të galvanizuar
Për grumbullim dhe transport të mbetjeve.



Rezervuarë për vajra dhe lëngje
Materiale rezistente ndaj korrozionit dhe rrjedhjeve.



Kontejnerë për akumulatorë
Të izoluar dhe të sigurta për magazinimin e baterive.



Kontejnerë për mbetje të rrezikshme
Materiale të certikuara dhe rezistente ndaj kimikateve.



Rafta metalike
Për magazinim të sigurt të materialeve dhe pajisjeve.

PAJISJE DHE MJETE PUNE



Mjete për çmontim
Ekskavatorë dhe kapëse hidraulike për çmontimin e automjeteve.



Pajisje për ngritje dhe transport
Forklift dhe karroca për levizjen e materialeve.



Presë hidraulike
Për kompresimin e metaleve dhe materialeve të tjera.



Sisteme transportuese
Për ndarjen dhe levizjen e fraksioneve të mbetjeve.



Makinë copëtuese
Për reduktimin e volumit të materialeve të ndryshme.

MATERIALE TË TJERA NDHËMËSE



Rrethim metalik
Për sigurinë dhe kontrollin e aksesit në qendër.



Pajisje mbrojtëse personale (PPE)
Për sigurinë e punëtorëve gjatë proceseve të punës.



Materiale absorbuese
Për menaxhimin e derdhjeve të vajrave dhe kimikateve.



Sisteme kundër zjarrit
Pajisje zjarrfikëse dhe hidrante për sigurinë e objekteve.



Sisteme sigurie dhe monitorimi
Për mbikëqyrjen dhe kontrollin e aktiviteteve në qendër.

Figura 31. Materialet dhe pajisjet e përzgjedhura për realizimin e projektit

5.9. Afati kohor për ekzekutimin dhe përfundimin e funksionimit të projektit sipas legjislacionit

Afatet kohore janë paraqitur në Tabelën e programit kohor (nënkapitulli 2.8). Veprimtaria është ekzistuese dhe kohëzgjatja e funksionimit është e kushtëzuar me vlefshmërinë e pëlqimit mjedisor dhe të licencës për menaxhimin e mbeturinave. Aplikuesi obligohet të aplikojë për rinovim para skadimit të afateve dhe të njoftojë MMPHI-në për çdo ndryshim material të veprimtarisë, të kapacitetit ose të llojeve të mbeturinave të pranuar.

5.10. Madhësia e lokacionit ose objektit

Madhësia e lokacionit është e fiksuar nga kufijtë e parcelës kadastrale (2916 m²) dhe nga objektet ekzistuese (1690 m²). Nuk është analizuar alternativë me madhësi më të vogël, pasi reduktimi i sipërfaqes operative do të pamundësonte ndarjen e duhur të fraksioneve sipas kodit. Alternativa me sipërfaqe më të madhe (A1, A3) është refuzuar për arsyet e paraqitura në nënkapitujt 5.3 dhe 5.11.

5.11. Vëllimi i prodhimit

Vëllimi i veprimtarisë është përcaktuar në bazë të kapaciteteve reale të lokacionit dhe nuk është vlerë e deklaruar në mënyrë arbitrare. Metodologjia e derivimit:

Tabela 48. Derivimi i kapacitetit vjetor nga kapacitetet reale të magazinimit të lokacionit

Fraksioni kryesor	Baza e kapacitetit të magazinimit	Kapacitet i njëkohshëm (t)	Qarkullime / vit	Kapacitet vjetor (t/vit)
Metale ferroke	Boks 250 m ² × 1.8 m × 0.9 t/m ³ × 0.55 faktor mbushjeje	≈ 223	≈ 5.4	≈ 1 210
Metale joferroke	Boks 80 m ² × 1.5 m × 0.8 t/m ³ × 0.40 faktor mbushjeje	≈ 38	≈ 5	≈ 185
Plastikë	Boks 120 m ² × 1.8 m × 0.15 t/m ³ × 0.55 faktor mbushjeje	≈ 18	≈ 4	≈ 80
Automjete jashtë përdorimit	Zonë pritjeje 300 m ² – kapacitet ≈ 12 njësi njëkohësisht	≈ 55	—	≈ 415 (130 njësi)
Fraksione të tjera (MPEE, bateri, goma, qelq, letër)	Depo të dedikuara, gjithsej 165 m ²	≈ 20	≈ 5	≈ 110
	TOTAL	≈ 354		≈ 2000

Supozime të deklaruara: dendësi e grumbulluar 0,9 t/m³ për skrap ferroz të përzier, 0,8 t/m³ për metale joferroke dhe 0,15 t/m³ për plastikë të papresuar; lartësi efektive 1,5–1,8 m; faktor mbushjeje 0,40–0,55. Llogaritja 250 m² × 1,8 m × 0,9 t/m³ × 0,55 jep rreth 223 t. Kapaciteti teorik i njëkohshëm është rreth 354 t, ndërsa kufiri operativ mbahet rreth 192 t për siguri. Kapaciteti 2.000 t/vit duhet të konfirmohet me deklaratë të nënshkruar të aplikuesit, peshime dhe kapacitetet e pajisjeve.

Kapaciteti i pranimit është kufizuar në 2000 t/vit. Tejkalmimi i këtij kapaciteti kërkon modifikim të pëlqimit mjedisor. Aplikuesi obligohet të ndalë pranimin kur sasia e magazinuar arrin kufirin e lejuar për fraksionin përkatës.

5.12. Kontrolli i ndotjes

Kontrolli i ndotjes zbatohet fillimisht në burim dhe plotësohet me mbajtje, trajtim dhe monitorim. Tabela në vijim paraqet masat kryesore dhe efikasitetin e pritshëm, i cili verifikohet me inspektime e matje.

Tabela 49. Masat e kontrollit të ndotjes dhe efikasiteti i pritshëm

Rrjedha e ndotjes	Burimi	Masa e kontrollit	Efikasiteti i pritshëm
Pluhur difuz	Manipulim i fraksioneve; qarkullim i mjeteve	Lagja e sipërfaqeve në periudha të thata; mbulim i boksesh me fraksione të lehta; kufizim i shpejtësisë në 10 km/h; pastrim i rregullt	Reduktim i pritshëm i emetimit difuz; efikasiteti nuk kreditohet numerikisht pa verifikim me MN-04

Rrjedha e ndotjes	Burimi	Masa e kontrollit	Efikasiteti i pritshëm
Emetime nga djegia	Manipulator dizel	Mirëmbajtje periodike; ndalim i xhirimit të pandërprerë në pritje (idling); shfrytëzim i optimizuar	Reduktim i pritshëm pas mirëmbajtjes dhe kufizimit të punës në pritje; verifikohet me regjistrat e karburantit dhe të mirëmbajtjes
Ndotje e tokës dhe e ujërave nëntokësore	Derdhje aksidentale të vajrave, karburantit, elektrolitit	Sipërfaqe të papërshkueshme; pellgje mbajtëse $\geq 110\%$; platformë e dedikuar e depolutimit; komplete reagimi ndaj derdhjeve; ndalim i magazinimit të lëngjeve jashtë objektit	Rreziku i infiltrimit minimizohet; gjendja verifikohet me inspektime, testet e papërshkueshmërisë dhe monitorimin e ujërave nëntokësore
Ndotje e ujërave atmosferike	Rrjedhje nga sipërfaqet operative	Separator koalescent klasa I, NS 15; ndarje e rrjetit atmosferik nga sanitari; mirëmbajtje dhe zbrazje periodike	Objektivi teknik në dalje është $\leq 5 \text{ mg/l}$ hidrokarbure pas vënies në punë dhe mirëmbajtjes sipas EN 858; pajtueshmëria provohet me analizë
Ujëra sanitare	Personeli	Gropë septike e papërshkueshme; zbrazje nga operator i licencuar; zgjidhje e preferuar – lidhje me rrjetin publik	Eliminim i shkarkimit të pakontrolluar
Zhurma	Çmontim, presim, shkarkim, qarkullim	Operim vetëm ditën; kryerja e operacioneve më të zhurmshme brenda objektit; mirëmbajtje e pajisjeve; ndalim i shkarkimit të lirë të skrapit nga lartësi	Pajtueshmëria me vlerat kufi nuk deklarohet pa matje në kufi dhe, sipas rezultatit, te receptori më i ekspozuar
Mbeturina	Procesi dhe funksionimi	Ndarje në burim; kodifikim; magazinim i ndarë; dorëzim vetëm tek operatorë të licencuar	Gjurmueshmëri 100 %; norma e rikuperimit verifikohet çdo vit
Ndotje vizuale	Stivim i fraksioneve	Kufizim i lartësisë së stivimit në 1.8 m; magazinim kryesor brenda objektit; mirëmbajtje e rregullit të lokacionit	Ndikim vizual i papërfillshëm

5.13. Trajtimin e mbeturinave, përfshirë riciklimin, ripërdorimin, asgjësimin dhe deponimin përfundimtar

Menaxhimi i mbeturinave është përshkruar në detaje në nënkapitujt 2.6 dhe 2.7, duke përfshirë regjistrin e plotë të kodeve sipas Katalogut Shtetëror të Mbeturinave, operacionet e kryera për secilin kod (R12 dhe R13), kushtet teknike të magazinimit dhe destinacionin e mëtejshëm. Për të evituar përsëritjen e informacionit – në përputhje me nenin 4, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.4 dhe 1.5 të UA (MMPHI) nr. 04/2025 – në këtë nënkapitull paraqitet vetëm përmbledhja sipas hierarkisë së menaxhimit të mbeturinave.

Tabela 50. Zbatimi i hierarkisë së menaxhimit të mbeturinave dhe shpërndarja sasiore

Niveli i hierarkisë	Zbatimi në projekt	Sasia (t/vit)	Pjesa (%)
1. Parandalim	Nuk aplikohet – mbeturinat pranohen si input i veprimtarisë	—	—
2. Përgatitje për ripërdorim	Vetëm pjesë të verifikuara teknikisht për përgatitje për ripërdorim; dalja nga statusi i mbeturinës nuk supozohet automatikisht	Përcaktohet nga evidenca reale	Raportohet veçmas

Niveli i hierarkisë	Zbatimi në projekt	Sasia (t/vit)	Pjesa (%)
3. Riciklim	Metale, plastikë, qelq, letër dhe bateri të dorëzuara te operatorë të licencuar; operacioni final verifikohet nga licenca dhe pranimi	Pjesë e potencialit ≤ 2002.3	Jo normë e garantuar
4. Rikuperim tjetër	Vajra dhe goma vetëm kur operatori pranues është i licencuar për operacionin e deklaruar R1/R9	Sipas fletë-përcjellëseve	Raportohet realisht
5. Asgjësim	Mbeturina komunale, llum septik dhe çdo rrjedhë tjetër e destinuar për D1/D8/D9/D10 jashtë lokacionit	≥ 46.2	Minimum i njohur: 1.2 t/vit mbeturina komunale + ≈ 45.0 t/vit ujëra/llumra septike; shtohen rrjedhat D sipas kontratave
	TOTAL	2048.5	Bilanci total: 2000.0 t/vit input + 48.5 t/vit rrjedha të gjeneruara nga funksionimi

Sasitë janë të rrumbullakuara; shpërndarja sipas kodit të mbeturinës është paraqitur në Tabelat e nënkapitullit 2.6. Nuk kryhet asnjë operacion asgjësimi brenda lokacionit; operacionet D kryhen ekskluzivisht jashtë lokacionit, nga operatorë të licencuar.

5.14. Rregullimi i infrastrukturës rrugore të qasjes në projekt dhe rrugë të komunikacionit

Qasja realizohet drejtpërdrejt nga magjistralla M-25 Prishtinë–Shtime, përmes hyrjes ekzistuese. Rregullimi i qasjes dhe i qarkullimit të brendshëm përfshin:

- hyrje-dalje me gjerësi të mjaftueshme për mjete të rënda, sipas kushteve të autoritetit kompetent rrugor;
- qarkullim njëkahor brenda parcelës, me pikë kontrolli dhe peshim në hyrje;
- sinjalistikë horizontale dhe vertikale për orientim dhe kufizim të shpejtësisë në 10 km/h;
- sipërfaqe qarkullimi të asfaltuara dhe të papërshkueshme, me pjerrësi drejt kanaleve të grumbullimit;
- zonë manovrimi prej 700 m², e dimensionuar për kthimin e kamionëve pa lëvizje mbrapa në rrugën publike;
- ndalim i qëndrimit dhe i shkarkimit të mjeteve në rrugën publike;
- pastrim i rrotave dhe kontroll vizual i mjeteve në dalje, për të evituar bartjen e materialeve në rrugën publike.

Tabela 51. Vlerësimi i ngarkesës së transportit të gjeneruar nga projekti

Rrjedha e transportit	Baza e llogaritjes	Ngarkesa / vit
Pranim i mbeturinave metalike, plastike, MPEE, bateri, goma, letër	1 585 t / 6 t për ngarkesë	264
Pranim i automjeteve jashtë përdorimit	130 njësi / 2 njësi për transport	65
Dërgesa e fraksioneve të klasifikuara dhe të presuara	2 006 t / 20 t për ngarkesë	100
Dërgesa e mbeturinave të rrezikshme	12 t, mjete të specializuara ADR	12

Rrjedha e transportit	Baza e llogaritjes	Ngarkesa / vit
Zbrazje e gropës septike dhe e separatorit	autocisternë	14
TOTAL ngarkesa (hyrje)		455
Lëvizje totale (hyrje + dalje)		910
Lëvizje mesatare në ditë pune	250 ditë pune/vit	≈ 3.6

Skenari i projektimit parashikon rreth 3,6 lëvizje të mjeteve të rënda dhe rreth 12 lëvizje të veturave të personelit në ditë pune. Përqindja ndaj trafikut në M-25 nuk përcaktohet pa numërim zyrtar ose matje specifike; ndikimi verifikohet me regjistrin e hyrje-daljeve dhe, nëse kërkohet nga autoriteti, me numërim trafiku.

5.15. Përgjegjësia dhe procedura për menaxhimin e mjedisit

Përgjegjësitë duhet të jenë të ndara qartë ndërmjet drejtimit, personit përgjegjës për mjedisin dhe operatorëve. Tabela në vijim përcakton detyrat, evidencat dhe rrugën e raportimit për secilin rol.

Tabela 52. Ndarja e përgjegjësiave për menaxhimin e mjedisit

Roli	Përgjegjësitë mjedisore	Kualifikimi i kërkuar
Menaxheri i objektit / drejtori	Përgjegjësi e përgjithshme për pajtueshmërinë me pëlqimin mjedisor dhe licencën; sigurimi i burimeve për zbatimin e masave; nënshkrimi i raporteve drejtuar MMPHI-së	Përfaqësues i autorizuar i subjektit
Përgjegjësi për mjedis dhe SHSP	Zbatimi i Planit të Menaxhimit Mjedisor; mbajtja e ditarit të mbeturinave; kodifikimi i mbeturinave; organizimi i monitorimit; raportimi; trajnimi i personelit; hetimi i incidenteve	Arsim i lartë në fushën e mjedisit, teknologjisë ose të afërt; trajnim i dokumentuar
Operatori i çmontimit	Zbatimi i SOP-03 dhe SOP-04; kontrolli i plotësisë së depolutimit; raportimi i derdhjeve	Trajnim i dokumentuar; PMP i detyrueshëm
Operatori i magazinës	Ndarja e fraksioneve sipas kodit; etiketimi; kontrolli i afateve të magazinimit; kontrolli i pëllgjeve mbajtëse	Trajnim i dokumentuar
Personeli i pranimi	Zbatimi i SOP-01; verifikimi i fletë-përcjellës; refuzimi i ngarkesave të papërshtatshme; peshimi dhe regjistrimi	Trajnim i dokumentuar
Operatorët e jashtëm të licencuar	Transporti dhe trajtimi i mëtejshëm sipas licencës; konfirmimi i pranimi	Licencë valide e lëshuar nga MMPHI

Procedura e menaxhimit mjedisor ndjek ciklin Planifiko–Zbato–Kontrollo–Vepro (PDCA): planifikimi vjetor i masave dhe i monitorimit; zbatimi përmes SOP-eve; kontrolli përmes inspektimeve të brendshme dhe matjeve; dhe veprimi korrigjues i dokumentuar në rast të konstatimit të mospajtueshmërisë.

5.16. Trajnime

Personeli nuk mund të kryejë pranimin, kodifikimin ose depolutimin pa trajnim të dokumentuar. Tabela në vijim përcakton temat, grupet e synuara, shpeshësinë dhe provën e kompetencës.

Tabela 53. Programi i trajnimeve të detyrueshme

Trajnimi	Grupi i synuar	Përmbajtja	Frekuenca
Trajnim hyrës mjedisor	Të gjithë punonjësit e rinj	Politika mjedisore; kodifikimi i mbeturinave; ndarja në burim; ndalimet	Para fillimit të punës
Identifikimi dhe kodifikimi i mbeturinave	Personeli i pranimit dhe i magazinës	Struktura e kodeve sipas UA nr. 13/2013; Hapat 1–4; shënjimi (*); kriteret e refuzimit	1 herë / vit
Depolutimi i automjeteve	Operatorët e çmontimit	Renditja e detyrueshme e heqjes; kontrolli i plotësisë; ndryshimi i statusit të kodit	1 herë / vit
Reagimi ndaj derdhjeve	Të gjithë punonjësit operativë	Izolimi; përdorimi i absorbuesve; kodifikimi i mbeturinave të krijuara; raportimi	2 herë / vit, me ushtrim praktik
Mbrojtja kundër zjarrit dhe evakuimi	Të gjithë punonjësit	Klasat e zjarrit; përdorimi i fikëseve; rrugët e evakuimit; pikat e mbledhjes	1 herë / vit, me ushtrim
Siguria dhe shëndeti në punë	Të gjithë punonjësit	Rreziqet mekanike; përdorimi i PMP; ergonomia; ndihma e parë	1 herë / vit
Transporti i mbeturinave të rrezikshme	Personeli i ngarkim-shkarkimit	Kërkesat e ADR-së; etiketimi; fletë-përcjellësja	1 herë / vit

Të gjitha trajnimet dokumentohen me listë prezence, përmbajtje dhe nënshkrim të pjesëmarrësve. Regjistri i trajnimeve mbahet për së paku 5 vjet dhe është i disponueshëm për inspektim.

5.17. Monitorimi

Programi i detajuar i monitorimit është paraqitur në Kapitullin 8. Në kuadër të alternativës së zgjedhur, monitorimi është ndërtuar në tri nivele: monitorim bazë (matja bazë referuese, Kapitulli 4), monitorim operativ i vazhdueshëm (ditari i mbeturinave, inspektimet vizuale) dhe monitorim analitik periodik (matje laboratorike të ujit, tokës, ajrit dhe zhurmës).

5.18. Planet për situata emergjente

Situatat emergjente kryesore janë derdhja, zjarri, pranimi i ngarkesës së papranueshme dhe dështimi i sistemit të drenazhimit. Tabela në vijim përcakton veprimin e menjëhershëm, njoftimin dhe evidencën për secilin skenar.

Tabela 54. Planet për situata emergjente dhe veprimet e menjëhershme

Skenari emergjent	Shkaku i mundshëm	Pasoja e pritshme	Veprimi i menjëhershëm
Derdhje e vajit ose e karburantit	Dëmtim i enës; gabim gjatë depolutimit; dështim i pellgut mbajtës	Ndotje lokale e sipërfaqes; rrezik i infiltrimit në rast çarjeje	Ndalimi i burimit; izolimi me barrierë; mbulimi me absorbues; grumbullimi në enë; kodifikimi 15 02 02*; njoftimi i përgjegjës; regjistrimi i incidentit
Derdhje e elektrolitit të akumulatorit	Dëmtim mekanik i akumulatorit	Ndotje acidike lokale; rrezik për punëtorët	Neutralizim me agjent bazik (sodë kaustike/gëlqere); mbledhje; PMP i detyrueshëm; njoftim
Zjarr në fraksionet e magazinuar	Shkëndijë nga vegla; mbeturinë me lëndë ndezëse; vetëndezje e gomave	Emetime toksike në ajër; ujë i kontaminuar nga fikja; dëmtim i objektit	Alarmi; evakuimi; fikja fillestare me pajisje në lokacion; njoftimi i shërbimit të zjarrfikjes; izolimi i ujit të fikjes në separator

Skenari emergjent	Shkaku i mundshëm	Pasoja e pritshme	Veprimi i menjëhershëm
Aktivizim i paqëllimshëm i qeses së ajrit	Manipulim i gabuar gjatë çmontimit	Lëndim mekanik i punëtorit	Ndalimi i punës; ndihma e parë; njoftimi; rishikimi i SOP-03
Tejmbushje ose dështim i separatorit	Mungesë e mirëmbajtjes; reshje ekstreme	Shkarkim i hidrokarbureve në rrjetin publik	Ndalimi i shkarkimit; zbrazja urgjente; njoftimi i operatorit të shërbimeve të ujit
Rrjedhje e gropës septike	Papërshkueshmëri e humbur; tejmbushje	Ndotje e tokës dhe rrezik për akuiferin	Ndalimi i shfrytëzimit; zbrazja urgjente; riparim ose zëvendësim; njoftim
Tërmet (zonë sizmike VIII)	Ngjarje sizmike	Rrëzimi i stivave; derdhje nga depozitat; dëmtim strukturor	Evakuimi; kontrolli i integritetit të depozitave dhe pellgjeve; izolimi i derdhjeve
Pranim i gabuar i mbeturinës së papranueshme	Kontroll i mangut në pranim; deklarim i gabuar nga zotëruesi	Rrezik i papërcaktuar; mospajtueshmëri ligjore	Izolimi i ngarkesës; identifikimi; njoftimi i zotëruesit dhe i MMPHI-së; kthimi ose dorëzimi tek operator i licencuar

Plani i situatave emergjente shoqërohet me: listë të kontakteve emergjente (shërbimi i zjarrfikjes, ambulanca, policia, MMPHI, Komuna, operatori i shërbimeve të ujit), skemë të rrugëve të evakuimit dhe të pikave të mbledhjes, dhe regjistër të incidenteve. Të gjitha incidentet mjedisore regjistrohen dhe raportohen në MMPHI brenda afatit të përcaktuar me legjislacion.

SKEMA E MENAXHIMIT TË EMERGJENCEVE

LLOJI I EMERGJENCËS	SHKAQET E MUNDSHME	MASAT PARANDALUESE	VEPRIMET E MENJËHERSHME	PËRGJEGJËSI
 Derdhje e vajrave / substancave të rrezikshme	Çmontimi i automjeteve, rrjedhje nga kontejnerët ose rezervuarët	- Magazininim i sigurt - Përdorimi i kontejnerëve të mbyllur - Kontroll periodik	- Ndalimi i rrjedhjes - Përdorimi i materialeve absorbuese - Izolimi i zonës	Përgjegjësi i mjedisit / Punonjësit 
 Zjarr në depo ose zonë pune	Pajisje elektrike, materiale të ndezshme, akumulatorë dhe lëndë të rrezikshme	- Pajisje zjarrfikëse funksionale - Ndarje e zonave sipas rrezikut - Ndalim i burimeve të ndezjes	- Aktivizimi i pajisjeve zjarrfikëse - Evakuimi i personelit - Njoftimi i shërbimit zjarrfikës	Menaxhmenti / HSE 
 Aksidente me punonjësit	Pajisje mekanike, mosrespektim i procedurave të sigurisë, mungesë kujdesi	- Trajnime periodike - Përdorimi i PPE - Sinjalistikë e sigurisë	- Dhënia e ndihmës së parë - Njoftimi i shërbimeve emergjente - Transportimi në institucion shëndetësor	Përgjegjësi i sigurisë 
 Ndotje e tokës	Rrjedhje e vajrave, karburanteve, kimikateve ose baterive	- Sipërfaqe të papërshkueshme nga lëngjet - Kontrole dhe mirëmbajtje periodike	- Izolimi i zonës - Pastrimi me materiale absorbuese - Grumbullimi dhe trajtimi i mbetjeve të kontaminuara	Përgjegjësi i mjedisit 
 Ndotje e ujërave	Derdhje në kanalizime, kanale kulluese ose rrjedha ujore	- Sistem i kontrolluar kullimi - Zona të mbrojtura për magazinim	- Ndalimi i menjëhershëm i burimit - Vendosja e barrierave mbrojtëse - Njoftimi i autoriteteve kompetente	Menaxhmenti / Përgjegjësi i mjedisit 
 Ngjarje natyrore (stuhi, përmbytje, erëra të forta)	Kushte atmosferike ekstreme	- Mirëmbajtja e infrastrukturës - Monitorimi i parashikimeve meteorologjike - Plan evakuimi	- Sigurimi i pajisjeve dhe materialeve - Ndërprerja e aktiviteteve - Evakuimi nëse paraqitet rrezik	Menaxhmenti 

Figura 32. Skema e organizimit të reagimit në situata emergjente

5.19. DEMOLIMI DHE REHABILITIMI

Gjatë fazës së rregullt të operimit nuk parashihet demolimi i objekteve ekzistuese, pasi veprimtaria do të zhvillohet brenda infrastrukturës së përshtatur për grumbullimin, klasifikimin, magazinimin e përkohshëm dhe çmontimin e kontrolluar të automjeteve jashtë përdorimit. Objektet, platformat operative, depot dhe sistemet përcjellëse do të mirëmbahen në gjendje funksionale dhe të sigurt gjatë gjithë kohëzgjatjes së projektit.

Në rast të ndërprerjes së përhershme, të parakohshme ose të detyrueshme të veprimtarisë, lokacioni nuk do të braktiset pa përfunduar masat e mbylljes dhe rehabilitimit. Do të zbatohen fazat 2 dhe 3 të programit kohor të paraqitur në nënkapitullin 2.8, të cilat përfshijnë ndërprerjen e pranimi të mbeturinave, largimin e të gjitha materialeve dhe substancave të magazinuara, pastrimin dhe dekontaminimin e zonave operative, verifikimin e gjendjes së tokës dhe ujërave nëntokësore dhe, nëse konstatohet ndotje, rehabilitimin e zonave të prekura.

Qëllimi i mbylljes është që lokacioni të dorëzohet në gjendje të qëndrueshme, të sigurt dhe të përshtatshme për përdorim të mëtejshëm, pa mbeturina të braktitura, pa lëngje të lira, pa substanca të rrezikshme dhe pa burime aktive të ndotjes. Ndërprerja e aktivitetit nuk do të konsiderohet e përfunduar vetëm me ndalimin e punës; përgjegjësitë mjedisore të aplikuesit vazhdojnë deri në realizimin, dokumentimin dhe pranimin e masave përfundimtare nga autoritetet kompetente.

Procedura e mbylljes dhe rehabilitimit do të përfshijë masat vijuese:

– **Njoftimi dhe përgatitja e planit të mbylljes.** Si masë minimale planifikuese, së paku 90 ditë para datës së parashikuar të mbylljes, aplikuesi do të njoftojë MMPHI-në dhe Komunën e Lipjanit dhe do të paraqesë planin e detajuar të mbylljes. Planin do të përmbajë afatet e realizimit, personat përgjegjës, inventarin e mbeturinave dhe substancave, mënyrën e çmontimit të pajisjeve, operatorët e angazhuar, destinacionet përfundimtare të çdo rrjedhe, programin e kampionimit dhe vlerësimin e kostos së rehabilitimit.

– **Ndërprerja e pranimi dhe sigurimi i lokacionit.** Para fillimit të pastrimit do të ndërpritet pranimi i mbeturinave të reja. Zonat e punës do të sigurohen, qasja e personave të paautorizuar do të kufizohet dhe do të vendoset sinjalistikë e përkohshme deri në përfundimin e procesit. Pajisjet dhe sistemet me rrezik potencial do të çaktivizohen në mënyrë të kontrolluar.

– **Inventarizimi i mbeturinave dhe substancave.** Do të përgatitet inventar përfundimtar për të gjitha mbeturinat metalike dhe plastike, bateritë dhe akumulatorët, mbeturinat e pajisjeve elektrike dhe elektronike, automjetet jashtë përdorimit, vajrat, karburantet, lëngjet ftohëse, filtrat, absorbuesit e kontaminuar, llumrat dhe mbeturinat e tjera të pranishme. Çdo rrjedhë do të identifikohet sipas kodit përkatës, sasisë, karakteristikave dhe destinacionit të planifikuar.

– **Ndarja dhe dorëzimi i mbeturinave.** Mbeturinat do të mbahen të ndara sipas llojit dhe karakteristikave të rrezikshmërisë dhe do t'u dorëzohen vetëm operatorëve të licencuar. Për çdo ngarkesë do të ruhen fletë-përcjellëset, evidencat e peshimit, faturat dhe vërtetimet e pranimi. Ndalohet përzierja, djegia, groposja, derdhja ose braktisja e mbeturinave brenda apo jashtë parcelës.

– **Pastrimi dhe dekontaminimi.** Platforma e depolutimit, sipërfaqet e klasifikimit, depot, hangarët, kontejnerët, enët, pellgjet mbajtëse, kanalet kulluese, pusetat, separatori koalescent dhe gropa septike do të zbrazen dhe pastrohen nga operatorë kompetentë. Vëmendje e veçantë do t'u kushtohet pikave ku janë magazinuar bateritë, vajrat, karburantet dhe komponentët e automjeteve jashtë përdorimit.

– **Menaxhimi i ujërave dhe mbetjeve të pastrimit.** Ujërat, llumrat, absorbuesit dhe mbetjet e krijuara gjatë pastrimit do të mblidhen veçmas në enë të përshtatshme. Ato nuk do të shkarkohen në tokë, në sistemin e

ujërave atmosferike ose në kanalizim pa karakterizim paraprak dhe pa plotësimin e kushteve të përcaktuara nga legjislacioni dhe operatori përkatës i shërbimit.

– **Çmontimi i pajisjeve dhe demolimi eventual.** Pajisjet e punës, instalimet dhe konstruksionet e lëvizshme do të çmontohen në mënyrë të kontrolluar, duke favorizuar ripërdorimin dhe riciklimin e materialeve. Nëse në të ardhmen konstatohet nevoja për demolimin e ndonjë objekti, paraprakisht do të hartohet plan teknik i veçantë, do të verifikohet prania e materialeve të rrezikshme dhe do të sigurohen miratimet përkatëse. Punimet do të realizohen me masa për kontrollin e pluhurit, zhurmës, ujërave të ndotura dhe mbeturinave të demolimit.

– **Inspektimi përfundimtar i sipërfaqeve.** Pas pastrimit do të kryhet kontroll vizual dhe teknik i platformave, dysHEMEVE, nyjeve, kanaleve dhe zonave të magazinimit. Çarjet, dëmtimet e shtresës së papërshkueshme ose pikat me shenja rrjedhjeje do të evidentohen dhe do të riparohen ose hetohen më tej para dorëzimit të lokacionit.

– **Kampionimi verifikues.** Toka dhe, sipas modelit konceptual të rrezikut, ujërat nëntokësore do të kampionohen nga laborator i akredituar. Pikat dhe parametrat e analizimit do të përcaktohen sipas llojeve të substancave të menaxhuara dhe historikut të lokacionit, me përqendrim të veçantë në hidrokarburet minerale, metalet e rënda dhe treguesit e tjerë relevantë. Rezultatet do të krahasohen me gjendjen bazë dhe me kriteret e zbatueshme në kohën e mbylljes.

– **Masat korrigjuese.** Nëse rezultatet tregojnë tejkalim të gjendjes referuese ose të kriterëve të zbatueshme, do të bëhet delimitimi horizontal dhe vertikal i zonës së prekur. Në varësi të natyrës dhe shkallës së ndotjes, do të realizohet largimi, trajtimi ose menaxhimi i kontrolluar i materialit të ndotur, riparimi i shtresës së papërshkueshme dhe rikampionimi. Procesi do të vazhdojë deri në arritjen e kriterit të pranimit ose deri në përcaktimin e një programi të miratuar të monitorimit pas mbylljes.

– **Rehabilitimi i sipërfaqeve të gjelbra.** Rreth 166 m² sipërfaqe të gjelbra do të ruhen gjatë operimit dhe, nëse janë dëmtuar, do të rikthehen. Rehabilitimi do të përfshijë largimin e materialeve të huaja, përmirësimin e shtresës sipërfaqësore të tokës, nivelimin, mbjelljen me bimësi të përshtatshme vendore dhe masat kundër erozionit. Sipërfaqja do të konsiderohet e rehabilituar kur vegjetacioni të jetë stabilizuar dhe të mos ketë shenja të ndotjes, erozionit ose degradimit.

Mbyllja do të konsiderohet e realizuar kur:

- nuk mbeten mbeturina, automjete jashtë përdorimit ose substanca të rrezikshme në lokacion;
- të gjitha rrjedhat janë dorëzuar te operatorë të licencuar dhe janë dokumentuar;
- nuk ka ndotje të dukshme, rrjedhje, lëngje të lira ose burime aktive të emetimeve;
- sipërfaqet e papërshkueshme, kanalet dhe sistemet e kullimit janë pastruar dhe siguruar;
- rezultatet laboratorike përmbushin kriteret e pranimit ose janë zbatuar masat korrigjuese të kërkuara;
- sipërfaqet e gjelbra janë ruajtur ose rikthyer; dhe
- lokacioni është i sigurt për përdorimin e ardhshëm të miratuar.

Pas përfundimit të punimeve, aplikuesi do të hartojë **Raportin e Gjendjes Përfundimtare dhe Rehabilitimit**, i cili do t'i dorëzohet MMPHI-së dhe Komunës së Lipjanit. Raporti do të përmbajë përshkrimin e masave të realizuara, inventarin përfundimtar, fotografi para dhe pas ndërhyrjeve, rezultatet laboratorike, dëshmitë e pastrimit dhe zbrazjes së sistemeve, dokumentet e dorëzimit të mbeturinave, masat korrigjuese të zbatuara dhe vlerësimin e çdo rreziku të mbetur.

Përgjegjësia organizative dhe financiare për mbylljen, pastrimin, rehabilitimin dhe monitorimin eventuale pas mbylljes i takon aplikuesit. Për këtë qëllim, aplikuesi do të krijojë dhe mirëmbajë rezervë financiare ose garanci të mjaftueshme, të përshtatur me inventarin, kapacitetin e veprimtarisë dhe koston e parashikuar të masave korrigjuese. Kjo rezervë do të rishikohet periodikisht, në mënyrë që mungesa e mjeteve financiare të mos pengojë zbatimin e detyrimeve mjedisore në rast të mbylljes së aktivitetit.

5.20. Plani për menaxhimin e mjedisit

Plani i Menaxhimit Mjedisor (PMM) është paraqitur në Kapitullin 9, duke përfshirë masat, përgjegjësitë, afatet, treguesit e performancës dhe mekanizmat e verifikimit. PMM-ja është dokument i gjallë, i rishikuar së paku një herë në vit dhe pas çdo incidenti mjedisor ose ndryshimi material të veprimtarisë.

5.21. Përshkrimi i alternativave pa veprim

Alternativa “pa veprim” (A0) nënkupton moszbatimin e projektit dhe mbylljen e kontrolluar: ndërprerjen e pranimit, inventarizimin dhe dorëzimin e të gjitha mbeturinave të operatorëve të licencuar, pastrimin, verifikimin mjedisor dhe rehabilitimin e lokacionit. Braktisja e mbeturinave nuk është alternativë e ligjshme. Analiza e pasojave:

Tabela 55. Analiza e pasojave të alternativës “pa veprim”

Faktori	Pasoja e alternativës “pa veprim”	Vlerësimi
Mbeturinat aktualisht të magazinuara	Inventarizohen dhe dorëzohen te operatorëve të licencuar para mbylljes	I ulët, nëse zbatohet plani i mbylljes
Ujërat nëntokësore	Rreziku ulet pas largimit të mbeturinave, pastrimit dhe verifikimit hidrogeologjik; ndotja e konstatuar rehabilitohet	I ulët / i kushtëzuar
Automjetet jashtë përdorimit	Nuk pranohen më; orientohen te qendra të tjera të autorizuara për depolitim dhe çmontim	Neutral nëse sigurohet dorëzimi i ligjshëm
Rrjedhat e mbeturinave të riciklueshme	Orientohen te operatorëve të tjerë të licencuar; distanca dhe rezultati i rikuperimit varen nga zinxhiri alternativ	Neutral / i kushtëzuar
Emetimet e gazeve serrë	Përfitimi klimatik i rikuperimit zhvendoset te operatorët pranues; nuk mund të atribuohet ose të humbet automatikisht	I papërcaktuar
Cilësia e ajrit dhe zhurma në zonë	Pa emetime operative dhe pa burime zhurme pas mbylljes	Pozitiv i vogël
Peizazhi	Objektet mbeten vetëm nëse janë të sigurta; zona pastrohet dhe rehabilitohet	Neutral / pozitiv
Aspekti socio-ekonomik	Humbje e gjashtë vendeve të punës dhe e kapacitetit lokal të menaxhimit të mbeturinave	Negativ socio-ekonomik
Faktorët e biodiversitetit dhe të trashëgimisë	Ndikim i ulët pas pastrimit dhe ruajtjes/rikthimit të sipërfaqeve të gjelbra; konkluzioni mbetet i kushtëzuar pa vërtetim sezonal	I ulët / i kushtëzuar

Përfundim: mbyllja dhe rehabilitimi i kontrolluar mund të ketë ndikim të ulët mjedisor, por nuk është zgjedhur për shkak të humbjes së kapacitetit lokal të menaxhimit dhe të vendeve të punës. Alternativa e projektit mbetet e pranueshme vetëm me zbatimin paraprak dhe verifikimin e masave të Kapitullit 7.

6. PËRSHKRIMI I NDIKIMIT TË PROJEKTIT NË MJEDIS

6.1. Përshkrimi i ndikimeve të projektit në mjedis

Vlerësimi i ndikimeve përfshin përshkrim cilësor dhe sasior të ndryshimeve të mundshme në mjedis gjatë punës së rregullt dhe në rast aksidentesh, si edhe vlerësimin se ndryshimet janë të natyrës së përkohshme apo të përhershme. Duke qenë se veprimtaria zhvillohet në objekte ekzistuese dhe nuk përfshin fazë ndërtimi, vlerësimi fokusohet në fazën e operimit, ndërsa faza përgatitore trajtohet vetëm ku është relevante.

6.1.1. Metodologjia e vlerësimit

Ndikimet janë vlerësuar sipas kritereve: natyra (negativ / pozitiv / neutral), shtrirja hapësinore (brenda lokacionit / lokale / rajonale / ndërkufitare), kohëzgjatja (e përkohshme / e përhershme), intensiteti (i papërfillshëm / i ulët / i moderuar / i lartë) dhe probabiliteti i paraqitjes (i sigurt / i mundshëm / i pamundshëm). Vlerësimi përfundimtar paraqitet pas zbatimit të masave zbutëse të Kapitullit 7 (ndikim rezidual).

6.1.2. Matrica përmbledhëse e ndikimeve

Ndikimet janë vlerësuar para dhe pas zbatimit të masave, duke marrë parasysh ndjeshmërinë e receptorit dhe nivelin e pasigurisë. Tabela në vijim jep pamjen e përmbledhur dhe nuk zëvendëson arsyetimin e detajuar në nënkapitujt përkatës.

Tabela 56. Matrica përmbledhëse e vlerësimit të ndikimeve në mjedis

Faktori mjedisor	Burimi i ndikimit	Natyra	Shtrirja	Kohëzgjatja	Ndikimi para masave	Ndikimi rezidual
Cilësia e ajrit	Pluhur difuz; djegie e karburantit	Negativ	Lokale	E përkohshme	I ulët	I papërfillshëm
Klima / GES	Konsum energjie dhe karburanti	Negativ / potencialisht pozitiv	Rajonale	E përhershme	I ulët	I ulët; potenciali pozitiv nuk kreditohet si bilanc neto pa verifikim
Ndotja ndërkufitare e ajrit	—	Neutral	—	—	Pa ndikim	Pa ndikim
Ujërat sipërfaqësore	Ujëra atmosferike të kontaminuara	Negativ	Lokale	E përkohshme	I moderuar	I ulët
Ujërat nëntokësore	Infiltrim i hidrokarbureve dhe metaleve	Negativ	Lokale	E përhershme (në rast dështimi)	I lartë	I ulët
Ndotja ndërkufitare e ujërave	—	Neutral	—	—	Pa ndikim	Pa ndikim
Ndryshimet hidromorfologjike	—	Neutral	—	—	Pa ndikim	Pa ndikim
Toka	Derdhje aksidentale	Negativ	Brenda lokacionit	E përhershme (në rast dështimi)	I moderuar	I ulët

Faktori mjedisor	Burimi i ndikimit	Natyra	Shtirirja	Kohëzgjatja	Ndikimi para masave	Ndikimi rezidual
Topografia, erozioni, rrëshqitjet	—	Neutral	—	—	Pa ndikim	Pa ndikim
Shfrytëzimi i tokës dhe burimeve natyrore	—	Neutral	—	—	Pa ndikim	Pa ndikim
Toka bujqësore	—	Neutral	—	—	Pa ndikim	Pa ndikim
Karakteristikat gjeologjike dhe gjeomorfologjike	—	Neutral	—	—	Pa ndikim	Pa ndikim
Popullsia – struktura dhe migrimi	Punësim	Pozitiv	Lokale	E përhershme	I ulët pozitiv	Pozitiv
Ndikimet vizuale	Stivim i fraksioneve	Negativ	Lokale	E përkohshme	I ulët	I papërfillshëm
Shëndeti i njeriut – zhurma, pluhuri, dridhjet	Operacionet mekanike	Negativ	Lokale	E përkohshme	I ulët	I papërfillshëm
Ndikimet socio-ekonomike	Punësim; zinxhir riciklimi	Pozitiv	Lokale/Rajonale	E përhershme	I moderuar pozitiv	Pozitiv
Ekosistemet – flora dhe fauna	Zhurmë, pluhur, ndriçim dhe shqetësim indirekt i kufizuar	Negativ	Lokale	E përkohshme / e ndërprerë	I ulët / i pasigurt pa vërtetim sezonal	I ulët, i kushtëzuar me masat dhe verifikimin sezonal
Veçoritë gjeologjike dhe paleontologjike	—	Neutral	—	—	Pa ndikim	Pa ndikim
Shfrytëzimi i sipërfaqeve	Veprimtari në objekte ekzistuese	Neutral	Brenda lokacionit	E përhershme	Pa ndikim	Pa ndikim
Infrastruktura komunale – trafiku	Transporti i mbeturinave	Negativ	Lokale	E përkohshme	I papërfillshëm	I papërfillshëm
Infrastruktura komunale – uji dhe kanalizimi	Konsum sanitar	Negativ	Lokale	E përhershme	I papërfillshëm	I papërfillshëm
Gjenerimi i mbeturinave	Procesi dhe funksionimi	Negativ / Pozitiv	Rajonale	E përhershme	I ulët	Pozitiv neto
Pasuritë e mbrojtura dhe peizazhi	—	Neutral	—	—	Pa ndikim	Pa ndikim
Ndikimet kumulative	Veprimtaritë industriale në zonë	Negativ	Lokale	E përhershme	I ulët	I ulët

6.2. Cilësinë e ajrit

Veprimtaria nuk përmban burim të drejtuar (të kanalizuar) të emetimeve në ajër. Nuk ekziston oxhak, nuk kryhet djegie industriale, shkrirje, pirolizë apo trajtim termik. Emetimet janë vetëm difuze (pluhur nga manipulimi dhe qarkullimi) dhe nga djegia e karburantit në një njësi të vetme makinerie. Llogaritjet sasiore janë paraqitur në nënkapitullin 2.6.

Tabela 57. Burimet e emetimeve në ajër dhe sasitë e vlerësuara

Burimi i emetimit	Tipi	Ndotësi kryesor	Sasia (kg/vit)	Karakteristika
Manipulimi i fraksioneve metalike dhe plastike	Difuz	TSP / PM ₁₀ / PM _{2.5}	8.4 / 3.96 / 0.60	I ndërprerë, vetëm gjatë orarit të punës
Qarkullimi i mjeteve mbi sipërfaqe të asfaltuara	Difuz	PM ₁₀	0.25	I ndërprerë; sipërfaqe të pastruara
Djegia e karburantit në manipulator	Difuz (jo i kanalizuar)	NO _x / CO / HC / PM	67.5 / 31.7 / 8.8 / 4.6	I ndërprerë; motor i mirëmbajtur
Kundërmimet	Difuz	Komponime organike volatile	I papërfillshëm	Nuk pranohen mbeturina të biodegradueshme; vajrat magazinohen në enë të mbyllura
Emetime të drejtuara (oxhak)	—	—	Nuk ekzistojnë	Nuk ka proces djegieje apo termik

Burimet e ajrit janë kryesisht difuze nga trafiku, manipulimi dhe pastrimi i sipërfaqeve, pa oxhak ose proces termik. Tabela në vijim paraqet rëndësinë e pritshme dhe masat, ndërsa pajtueshmëria verifikohet me matje lokale.

Tabela 58. Vlerësimi i ndikimit – cilësia e ajrit

Kriteri i vlerësimit	Vlerësimi
Natyra e ndikimit	Negativ
Shtrirja hapësinore	Lokale; shtrirja numerike nuk deklarohet pa matje ose modelim. Kontrolli kryhet në kufirin sipër/nën erë dhe, sipas rezultatit, te receptori më i ekspozuar.
Kohëzgjatja	E përkohshme, e ndërprerë (vetëm gjatë orarit të punës)
Intensiteti	I ulët sipas inventarit paraprak të burimeve; përqendrimi në ajër nuk është përcaktuar me model dispersioni
Probabiliteti i paraqitjes	I sigurt (emetimi difuz), me intensitet të ndryshueshëm
Ndikimi i vlerësuar (pas masave)	I pritshëm i ulët; verifikohet me matje bazë dhe operative

6.3. Nivelin dhe përqendrimin e substancave ndotëse në ajër dhe krahasimin me treguesit e përcaktuar me norma dhe standardet sipas legjislacionit në fuqi

Duke qenë se nuk ekziston burim i drejtuar emetimi, krahasimi me vlerat kufi të emetimit (emission limit values) nuk aplikohet. Krahasimi relevant është me vlerat kufi të imisionit (cilësisë së ajrit të ambientit), për të cilat kërkohet matje bazë sipas Kapitullit 4.

Tabela 59. Krahasimi i kontributit të projektit me vlerat kufi referuese të cilësisë së ajrit

Ndotësi	Kontributi i vlerësuar i projektit	Vlera kufi referuese e imisionit	Vlerësimi
PM ₁₀	Inventar paraprak: 3.96 kg/vit. Përqendrimi nuk është modeluar; kontributi përcaktohet me matje të njëkohshme sipër dhe nën erë para operimit të plotë.	40 µg/m ³ (mesatare vjetore) / 50 µg/m ³ (mesatare 24-orëshe)	Nuk deklarohet pajtueshmëri pa rezultatet bazë; zbatohen kriteret dhe veprimet korrigjuese të MN-04.
PM _{2.5}	Inventar paraprak: 0.60 kg/vit. Matet bashkë me PM ₁₀ në pikat sipër/nën erë gjatë fushatës bazë.	25 µg/m ³ (mesatare vjetore)	Nuk deklarohet pajtueshmëri pa rezultatet bazë dhe krahasimin me kriterin ligjor në fuqi.
NO ₂	Emetim i mundshëm nga mjetet; përqendrimi nuk është modeluar	40 µg/m ³ (mesatare vjetore)	Verifikohet sipas nevojës dhe rezultateve bazë
SO ₂	Emetim i mundshëm nga karburanti; përqendrimi nuk është modeluar	125 µg/m ³ (mesatare 24-orëshe)	Nuk deklarohet pajtueshmëri pa të dhëna matëse
CO	Emetim difuz i mundshëm; përqendrimi nuk është modeluar	10 mg/m ³ (maksimum 8-orësh)	Verifikohet sipas nevojës dhe rezultateve bazë
Metale të rënda në pluhur (Pb, Cd, Ni)	Potencialisht të pranishme në pluhurin nga manipulimi i skrapit; sasia e vlerësuar e papërfillshme	Pb: 0.5 µg/m ³ ; Cd: 5 ng/m ³ ; Ni: 20 ng/m ³ (mesatare vjetore)	Analiza e Pb, Cd dhe Ni në PM₁₀ kryhet në fushatën bazë kur masa e mostrës lejon analizë të vlefshme dhe përsëritet pas rezultateve atipike ose incidentit.

Rregulli i vendimmarrjes për ajrin: kërkesa e nenit 10, paragrafi 2.1.1 të UA nr. 04/2025 konsiderohet e verifikuar vetëm pasi rezultatet sipër/nën erë të krahasohen me vlerat kufi të legjislacionit në fuqi. Nëse pika nën erë tregon rritje përtej pasigurisë së metodës ose tejkalim të vlerës kufi, zbatohen menjëherë masat shtesë, matja përsëritet brenda 30 ditësh dhe, nëse devijimi vazhdon, kryhet modelim dispersioni para vazhdimit të operimit me kapacitet të plotë.

Vlerat kufi referuese të paraqitura korrespondojnë me nivelet e pranuar në kornizën evropiane të cilësisë së ajrit dhe përdoren si kriter konservativ vlerësimi. Për kontrollin e pajtueshmërisë zbatohet akti kombëtar në fuqi në datën e matjes; çdo ndryshim i mëvonshëm ligjor zbatohet automatikisht në monitorimin operativ.

6.4. Ndikimin e projektit në klimë, lloji dhe vëllimi i emetimeve të gazeve serrë dhe ndjeshmëria e projektit ndaj ndryshimeve klimatike

Bilanci i gazeve serrë është llogaritje orientuese dhe jo inventar i certifikuar ose kredit karboni. Tabela në vijim paraqet emetimet e drejtpërdrejta dhe përfitimet e mundshme të rikuperimit me supozimet e deklaruara.

Tabela 60. Bilanci indikativ i emetimeve të gazeve serrë

Kategoria	Burimi	Sasia (t CO ₂ e/vit)	Metodologjia
Emetime direkte (Shkalla 1)	Djegia e karburantit dizel (2400 l/vit)	6.4	Faktor 3.17 kg CO ₂ /kg karburant
Emetime indirekte (Shkalla 2)	Konsumi i energjisë elektrike (33.4 MWh/vit)	31.7	Faktor i rrjetit të Kosovës 0.95 t CO ₂ e/MWh
TOTAL EMETUAR		38.1	

Kategoria	Burimi	Sasia (t CO ₂ e/vit)	Metodologjia
Përfitime potenciale jashtë kufijve të projektit	Rikuperimi pasues i materialeve tek operatorët pranues	Nuk kuantifikohen / nuk kreditohen	Mund të raportohen veçmas vetëm pas verifikimit të sasive, destinacioneve, operacionit final, faktorëve, adicjonalitetit dhe shmangies së numërimit të dyfishtë.
BILANCI NETO I PROJEKTIT		NUK DEKLAROHET	Inventari i verifikueshëm përmban 38.1 t CO ₂ e/vit emetime direkte dhe indirekte; nuk zbriten kredi të pakonfirmuara.




Figura 33. Inventari i verifikueshëm i gazeve serrë gjatë fazës së operimit

Inventari i projektit paraqet vetëm emetimet direkte dhe indirekte që mund të verifikohen me faturat e karburantit, konsumin e energjisë dhe faktorët zyrtarë të vitit raportues. Përfitimet e mundshme nga rikuperimi i materialeve realizohen jashtë kufijve operativë të projektit dhe nuk kuantifikohen, nuk zbriten dhe nuk paraqiten si bilanc neto pa prova për destinacionin, operacionin final, adicjonalitetin dhe shmangien e numërimit të dyfishtë.

6.4.1. Ndjeshmëria e projektit ndaj ndryshimeve klimatike

Ndryshimet klimatike mund të shtojnë valët e të nxehtit, reshjet intensive dhe rrezikun nga zjarri. Tabela në vijim lidh këto rreziqe me masat e përshtatjes dhe kontrollin periodik të kapacitetit të drenazhimit.

Tabela 61. Ndjeshmëria e projektit ndaj ndryshimeve klimatike dhe masat e përshtatjes

Rreziku klimatik	Ndikimi i mundshëm në projekt	Masa e përshtatjes
Reshje intensive dhe përmytje sipërfaqësore	Tejmbushje e drenazhimit; bartje e ndotësve; tejmbushje e separatorit	Dimensionim i separatorit sipas EN 858-2 ($Q_r = 13.5$ l/s); pastrim i rregullt i kanaleve; kontroll i pjerrësive
Valë të nxehtësisë (> 35 °C)	Rritje e avullimit të hidrokarbureve; rrezik i shtuar i vetëndezjes së gomave dhe fraksioneve	Magazinim i vajrave brenda objektit, i mbrojtur nga rrezatimi; ventilim; ndalim i stivimit të lartë të gomave; kontroll i temperaturës

Rreziku klimatik	Ndikimi i mundshëm në projekt	Masa e përshtatjes
Thatësi e zgjatur	Rritje e emetimit të pluhurit difuz	Lagja e sipërfaqeve; mbulim i boksesh; reduktim i shpejtësisë së qarkullimit
Erë e fortë / stuhi	Shpërndarje e fraksioneve të lehta (plastikë, letër)	Magazinin i fraksioneve të lehta brenda objektit ose në bokse të mbuluara; ngjeshje e shpejtë
Ngrirje e zgjatur	Ngrirje e lëngjeve; çarje e enëve dhe e shtresës së asfaltit	Magazinin brenda objektit; kontroll i integritetit të enëve; riparim i çarjeve
Ulje e disponueshmërisë së ujit	Ndikim i papërfillshëm – konsum vetëm sanitar	Kursim i ujit; rezervuar ndihmës

6.5. Mundësinë e ndikimit në ndotjen ndërkufitare të ajrit

Nuk pritet ndikim ndërkufitar në ajër, sepse projekti nuk ka burim të drejtuar, proces termik ose emetim të vazhdueshëm/persistent. Kjo përfundon nga natyra dhe shkalla lokale e veprimtarisë, jo nga një përqendrim i modeluar; monitorimi bazë dhe operativ përdoret për verifikimin e ndikimit lokal.

6.6. Cilësia e ujit

Veprimtaria nuk gjeneron ujëra teknologjike. Rrjedhat e identifikuara dhe menaxhimi i tyre janë paraqitur në nënkapitullin 2.6. Në këtë nënkapitull vlerësohen ndikimet në cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore.

Tabela 62. Vlerësimi i ndikimit – cilësia e ujit

Kriteri i vlerësimit	Vlerësimi
Natyra e ndikimit	Negativ (i mundshëm)
Shtrirja hapësinore	Lokale – akuiferi nën lokacionin; potencialisht Lumi Sitnica (≈ 450 m)
Kohëzgjatja	E përkohshme gjatë operimit të rregullt; e përhershme në rast të infiltrimit të pakontrolluar
Intensiteti	I moderuar para masave; i ulët pas zbatimit të masave të detyrueshme
Probabiliteti i paraqitjes	I mundshëm në rast dështimi të masave; i pamundshëm në operim të rregullt
Ndikimi i vlerësuar (pas masave)	I ulët

6.7. Ndikimi i ndotësve në cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore

Rreziku për ujin lidhet me vajrat, karburantet, acidet dhe ujërat atmosferike që mund të kontaktojnë zonat operative. Tabela në vijim paraqet rrugët e ekspozimit, masat e mbajtjes dhe parametrat që duhet të monitorohen.

Tabela 63. Ndikimi i ndotësve potencialë në cilësinë e ujërave dhe masat e kontrollit

Ndotësi potencial	Burimi	Shtegu i transmetimit	Receptori	Masa e kontrollit	Vlerësimi rezidual
Hidrokarbure (C ₁₀ –C ₄₀ , TPH)	Vajra motorikë dhe hidraulikë; karburant; rrjedhje nga automjetet në pritje	Rrjedhje sipërfaqësore → drenazhim; infiltrim përmes çarjeve të shtresës	Akuiferi aluvial; Lumi Sitnica	Sipërfaqe të papërshkueshme; platformë depolutimi me pellg mbajtës; separator koalescent klasi I (≤ 5 mg/l); absorbues	I ulët
Plumb (Pb) dhe elektrolit acidik	Akumulatorë të përdorur	Derdhje → sipërfaqe → infiltrim	Akuiferi aluvial	Kontejner acid-rezistent i mbuluar; pellg mbajtës; ndalim i zbrazjes së elektrolitit; neutralizim në rast derdhjeje	I ulët
Metale të rënda (Zn, Cu, Cd, Cr, Ni)	Korrozion i fraksioneve metalike; pluhur metalik	Shpëlarje nga reshjet → drenazhim	Akuiferi; Lumi Sitnica	Magazinin i fraksioneve metalike kryesisht brenda objektit; separator me rezervuar rërë-baltë; monitorim i daljes	I ulët
Glikol (antifrizë)	Lëng ftohës i automjeteve	Derdhje → infiltrim	Akuiferi aluvial	Heqje e detyrueshme në fazën e depolutimit; enë të mbyllura mbi pellg mbajtës	I ulët
Lëndë të ngurta të pezulluara (TSS)	Pluhur, thërmija metalike, baltë	Rrjedhje sipërfaqësore	Rrjeti publik; Lumi Sitnica	Rezervuar rërë-baltë $\geq 1\,500$ l; pastrim i rregullt i sipërfaqeve	I ulët
Ngarkesë organike sanitare (BOD _s , COD, N, P)	Ujëra sanitare të personelit	Rrjedhje nga gropë septike e padepërtueshme	Akuiferi aluvial	Gropë septike e papërshkueshme e verifikuar; zbrazje periodike; zgjidhje e preferuar – lidhje me rrjetin publik	I ulët

Krahasimi me vlerat kufi të shkarkimit bëhet në pikën e daljes së separatorit, në përputhje me UA (MMPHI) nr. 02/2022 për kushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin ujqor. Parametrat e detyrueshëm të monitorimit dhe frekuenca janë përcaktuar në Kapitullin 8.

6.8. Mundësinë e ndikimit në ndotjen ndërkufitare të ujërave

Lumi Sitnica bën pjesë në pellgun e Ibirit dhe rrjedh drejt Danubit, prandaj ka lidhje teorike ndërkufitare. Megjithatë, ndikimi ndërkufitar vlerësohet shumë pak i mundshëm, sepse projekti nuk ka shkarkim të drejtpërdrejtë në trupin ujqor, ujërat atmosferike menaxhohen përmes sistemit të kontrolluar me separator koalescent, ndërsa sasitë e mundshme të ndotësve kufizohen me magazinim të mbyllur dhe mbajtje sekondare. Ky përfundim kushtëzohet me instalimin, mirëmbajtjen dhe monitorimin e sistemit; çdo incident me mundësi hyrjeje në rrjedhë raportohet dhe rivlerësohet menjëherë.

6.9. Ndryshimet hidromorfologjike, sasia dhe cilësia me referencë të veçantë për shkarkimet e ujërave të zeza

Projekti nuk shkakton ndryshime hidromorfologjike. Nuk kryhen ndërhyrje në shtratin apo në brigjet e trupave ujqore, nuk kryhet devijim, kanalizim, digë apo marrje e ujqit nga trupi ujqor. Sipërfaqja e

papërshkueshme është ekzistuese dhe nuk shtohet, pra koeficienti i rrjedhjes së parcelës nuk ndryshon për shkak të projektit.

Tabela 64. Sasitë dhe pikat e shkarkimit të ujërave

Rrjedha	Sasia (m³/vit)	Pika e shkarkimit	Trajtimi para shkarkimit
Ujëra sanitare	45	Gropë septike (pa shkarkim në mjedis)	Zbrazje periodike nga operator i licencuar
Ujëra atmosferike nga sipërfaqja me rrezik ndotjeje	≈ 552	Rrjeti publik i ujërave atmosferike	Separator koalescent klasa I, NS 15 (EN 858)
Ujëra atmosferike nga sipërfaqet e tjera	≈ 1059	Rrjeti publik i ujërave atmosferike	Pa trajtim (të pakontaminuara)
Ujëra nga pastrimi i sipërfaqeve	≈ 40	Drejtuar në separator	Separator koalescent
Ujëra teknologjike	0	—	Nuk gjenerohen

6.10. Toka

Rreth 2.750 m² të parcelës mbulohen nga objekte ose sipërfaqe operative të papërshkueshme, ndërsa rreth 166 m² janë sipërfaqe të gjelbra. Projekti nuk duhet ta zgjerojë zonën operative mbi këto sipërfaqe; rreziku kryesor për tokën lidhet me derdhjet aksidentale dhe kontrollohet me platforma të papërshkueshme, pellgje mbajtëse dhe monitorim.

Tabela 65. Vlerësimi i ndikimit – toka

Kriteri i vlerësimit	Vlerësimi
Natyra e ndikimit	Negativ (i mundshëm)
Shtrirja hapësinore	Brenda lokacionit, pikësor
Kohëzgjatja	E përhershme në rast të kontaminimit të pariparuar
Intensiteti	I moderuar para masave; i ulët pas zbatimit të masave
Probabiliteti i paraqitjes	I pamundshëm në operim të rregullt; i mundshëm në rast dështimi të pellgjeve mbajtëse
Ndikimi i vlerësuar (pas masave)	I ulët

6.11. Ndikimi fizik, ndryshimi në topografinë lokale, erozioni i tokës, rrëshqitjet e tokës, etj.

Projekti nuk parashikon gërmime, mbushje, prishje të profilit tokësor ose ndryshim të kuotave. Terreni është i rrafshët dhe pjesa operative është e mbuluar me shtresë të papërshkueshme, ndaj rreziku i erozionit sipërfaqësor brenda parcelës është i ulët; gjendja e sipërfaqeve dhe shenjat e mundshme të paqëndrueshmërisë kontrollohen gjatë inspektimeve periodike.

6.12. Ndikimi i emetimeve të ndotësve në vendndodhjen e projektit të planifikuar dhe në tokën përreth dhe krahasimi me treguesit e përcaktuar me norma dhe standarde sipas legjislacionit përkatës

Toka mund të ndikohet vetëm përmes humbjes së kontrollit mbi derdhjet ose përmes sipërfaqeve të dëmtuara. Tabela në vijim lidh ndotësit e mundshëm me pikat e kontrollit dhe me verifikimin ndaj gjendjes bazë referuese.

Tabela 66. Ndikimi i mundshëm i ndotësve në tokë dhe parametrat e monitorimit

Ndotësi	Burimi	Zona e rrezikut	Parametri i monitorimit	Vlerësimi
Hidrokarbure (TPH)	Derdhje e vajrave dhe karburantit	Platforma e depolutimit; depoja e vajrave; zona e pritjes e automjeteve	TPH në tokë, 0–30 cm nën shtresën e papërshkueshme	Kërkohet vlerë bazë; monitorim çdo 3 vjet
Plumb (Pb)	Akumulatorë; fraksione metalike	Depoja e akumulatorëve	Pb total në tokë	Kërkohet vlerë bazë
Zn, Cu, Cd, Cr, Ni	Korrozion i fraksioneve metalike; pluhur	Bokset e fraksioneve metalike; sipërfaqja e jashtme	Metale të rënda në tokë	Kërkohet vlerë bazë
Ndotje difuze nga pluhuri i sedimentuar	Manipulimi i fraksioneve	Tokë përreth, brenda rrezes < 50 m nga kufiri	Metale të rënda në shtresën sipërfaqësore (0–10 cm)	Kërkohet vlerë bazë dhe monitorim; inventari paraprak i pluhurit nuk zëvendëson analizën e tokës

Republika e Kosovës nuk disponon vlera kufi kombëtare të konsoliduara dhe të publikuara për përqendrimin e ndotësve në tokë për të gjitha parametrat e listuara. Për këtë arsye, krahasimi kryhet ndaj vlerave bazë të matura në lokacion (parimi i mos-përkeqësimit): çdo rritje statistikisht e rëndësishme e përqendrimin ndaj vlerës bazë interpretohet si tregues i dështimit të masave dhe kërkon veprim korrigjues. Nëse gjatë kohëzgjatjes së pëlqimit mjedisor hyjnë në fuqi vlera kufi kombëtare, krahasimi duhet të përditësohet ndaj tyre.

6.13. Ndikimi në shfrytëzimin e tokës dhe burimeve natyrore

Nuk ka ndryshim të shfrytëzimit të tokës. Parcela është e destinuar për veprimtari komerciale/ekonomike sipas HZK Lipjan dhe shfrytëzohet për këtë qëllim. Nuk shfrytëzohen burime natyrore: nuk nxirren materiale, nuk pritet vegjetacion, nuk shfrytëzohet ujë nga trupi ujqor apo nga akuiferi. Ndikimi vlerësohet **pa ndikim**.

6.14. Sasia dhe cilësia e tokës bujqësore të humbur

Nuk zaptohet tokë bujqësore. Parcela prej 2.916 m² ka destinim komercial/ekonomik; rreth 166 m² sipërfaqe të gjelbra brenda saj ruhen dhe nuk përdoren për operacione. Sipërfaqet bujqësore në përfundim janë jashtë parcelës dhe nuk preken. Sasia e tokës bujqësore të humbur nga projekti: 0 m².

6.15. Ndikimi në karakteristikat gjeologjike dhe gjeomorfologjike

Projekti nuk ndikon në karakteristikat gjeologjike dhe gjeomorfologjike. Nuk kryhen gërmime apo ndërhyrje në formacionet gjeologjike, nuk ndryshohet reliev dhe nuk preken struktura tektonike. Nuk janë identifikuar veçori gjeologjike, paleontologjike apo gjeomorfologjike me vlerë të veçantë në zonën e ndikimit. Ndikimi vlerësohet **pa ndikim**.

6.16. Popullsinë lokale

Vlerësimi i ndikimeve në popullsinë lokale mbështetet në të dhënat demografike të nënkapitullit 3.10 dhe në distancat e nënkapitullit 3.3.

6.17. Ndryshimet në numrin dhe strukturën e popullsisë dhe ndikimet të lidhura me mjedisin, popullsia, përqendrimi dhe migrimi

Projekti nuk shkakton ndryshim të numrit apo të strukturës së popullsisë. Punësimi i drejtpërdrejtë prej 6 vendeve të punës mbulohet nga fuqia punëtore vendore dhe nuk gjeneron migrim. Nuk kërkohet shpronësim, nuk kërkohet zhvendosje e banorëve dhe nuk kufizohet qasja e komunitetit në burime apo në infrastrukturë. Ndikimi vlerësohet **neutral**, me element pozitiv nga ruajtja e vendeve të punës në nivel lokal.

6.18. Ndikimet vizuale të vendbanimeve

Objektet ekzistuese nuk shtojnë vëllim ndërtimor dhe përshtaten me karakterin industrial të zonës. Distanca deri në vendbanimin më të afërt (901 m) dhe deri në qendrën urbane (508 m) kufizon dukshmërinë e detajeve operative. Rreziku vizual i identifikuar lidhet me stivimin e pakontrolluar të fraksioneve metalike në hapësirën e jashtme, i cili adresohet përmes kufizimit të lartësisë së stivimit në 1.8 m, magazinimit kryesor brenda hangarëve dhe mirëmbajtjes së rregullit të lokacionit. Ndikimi rezidual vlerësohet **i papërfillshëm**.

6.19. Ndikimet e emetimit të ndotësve, zhurmës, vibrimet, nxehtësisë dhe të gjitha llojet e rrezatimit për shëndetin e njeriut

Shëndeti i punëtorëve dhe i popullatës vlerësohet ndaj zhurmës, pluhurit, substancave të rrezikshme dhe incidenteve. Tabela në vijim dallon ekspozimin profesional nga ai jashtë parcelës dhe përcakton masat për secilin grup.

Tabela 67. Vlerësimi i ndikimeve në shëndetin e popullatës dhe të punëtorëve

Agjenti	Ekspozimi i popullatës	Ekspozimi i punëtorëve	Vlerësimi
Pluhur (PM ₁₀ , PM _{2.5})	Ndikimi te receptorët nuk është kuantifikuar me model dispersioni; verifikohet me matje bazë dhe operative	Ekspozim i drejtpërdrejtë gjatë manipulimit dhe çmontimit	Popullata: pritët ndikim i ulët, për t'u verifikuar. Punëtorët: FFP2 dhe ventilim sipas vlerësimit të rrezikut
Zhurma	Vlerësim orientues i ulët; pajtueshmëria verifikohet me matje në kufi dhe te receptorët	Deri 92 dB(A) në pikën e punës gjatë çmontimit – tejkalon vlerën e veprimit prej 85 dB(A)	Popullata: për t'u verifikuar. Punëtorët: mbrojtje e dëgjimit dhe matje e ekspozimit personal
Dridhjet	Të zbutura brenda kufijve të parcelës; pa transmetim strukturor	Ekspozim dorë-krah nga veglat pneumatike	Popullata: pa ndikim. Punëtorët: rotacion i detyrave; vegla me zbutje dridhjeje
Nxehtësia	Pa shkarkim të nxehtësisë teknologjike	Ekspozim ndaj temperaturave të lartë brenda hangarëve në verë	Popullata: pa ndikim. Punëtorët: ventilim; pushime; furnizim me ujë të pijshëm
Rrezatim jonizues	Nuk ekziston burim	Nuk ekziston burim	Pa ndikim
Rrezatim jojonizues (elektromagnetik)	Nivele tipike të instalimeve me tension të ulët (0.4 kV); i papërfillshëm	I papërfillshëm	Pa ndikim
Rreziqe kimike	Pa ekspozim – lëngjet magazinohen brenda objektit	Kontakt i mundshëm me vajra, karburant, elektrolit acidik	Popullata: pa ndikim. Punëtorët: PMP; procedura; fletë të dhënash të sigurisë
Rreziqe biologjike	Ujë i stagnuar në gomat e magazinuara – rrezik i vektorëve (mushkonja)	I ulët	Masë e detyrueshme: magazinim i gomave në mënyrë që parandalon grumbullimin e ujit

Agjenti	Ekspozimi i popullatës	Ekspozimi i punëtorëve	Vlerësimi
Rreziqe mekanike	Pa ekspozim	Prerje, goditje, rrëzim i stivave, aktivizim i qeseve të ajrit	Punëtorët: PMP i plotë; SOP; trajnim; kufizim i lartësisë së stivimit

6.20. Ndikimet socio-ekonomike

Ndikimet socio-ekonomike të projektit vlerësohen pozitive dhe të rëndësishme në nivel lokal.

6.21. Ndikimi i projektit në strukturën e ekonomisë lokale, sipas sektorit prodhues dhe degës kryesor të zonës

Zona ku ndodhet lokacioni ka karakter komercial dhe industrial, me dominim të veprimtarive të grumbullimit dhe përpunimit të materialeve, magazinimit dhe logjistikës. Projekti përforcon këtë strukturë ekonomike duke:

- krijuar kanal të kontrolluar dhe të licencuar për grumbullimin e mbeturinave metalike, plastike, MPEE dhe akumulatorëve në nivel lokal;
- furnizuar industrinë metalurgjike dhe të riciklimit me lëndë të parë sekondare ($\approx 1\,700$ t/vit metale dhe plastikë);
- ofruar shërbim të depolimit dhe të çmontimit të automjeteve jashtë përdorimit, i cili aktualisht ka kapacitet të kufizuar në nivel komunal;
- gjeneruar kërkesë për shërbime transporti, mirëmbajtjeje dhe shërbime profesionale lokale.

6.22. Numri i vendeve të punës të krijuara gjatë fazave të ndërtimit dhe funksionimit të projektit, si dhe humbjet e mundshme të vendeve të punës në sektorët apo zonat e prekura

Projekti ekzistues mban vende pune operative dhe nuk ka fazë të re ndërtimi me punësim të përkohshëm. Tabela në vijim paraqet numrin e deklaruar të punonjësve dhe humbjen e mundshme në rast mbylljeje.

Tabela 68. Vendet e punës të krijuara dhe humbjet e mundshme

Faza	Vende pune të drejtpërdrejta	Vende pune indirekte (të vlerësuara)	Humbje të mundshme
Faza përgatitore (zbatimi i masave mjedisore)	2–4 (të përkohshme, kontraktorë të jashtëm për instalimin e separatorit dhe të platformës)	1–2	Nuk parashihen
Faza e operimit	6 (të përhershme): 1 menaxher, 1 përgjegjës për mjedis dhe SHSP, 4 punonjës operativë	3–5 (transport, mirëmbajtje, shërbime profesionale, laborator)	Nuk parashihen humbje në sektorë të tjerë
Faza e mbylljes	2–3 (të përkohshme, për largimin e mbeturinave dhe pastrimin)	1–2	Humbje e 6 vendeve të punës të përhershme

Projekti nuk shkakton humbje të vendeve të punës në sektorë apo zona të prekura. Veprimtaria nuk konkurron me bujqësinë, turizmin apo veprimtari të tjera, pasi zhvillohet në zonë të dedikuara komerciale dhe industriale.

6.23. Kontributi i projektit në ekonominë rajonale dhe kombëtare

Kontributi ekonomik lidhet me punësimin, shërbimet lokale dhe kthimin e materialeve në zinxhirin e rikuperimit. Tabela në vijim paraqet përfitimet e pritshme pa i trajtuar ato si kompensim për moszbatimin e masave mjedisore.

Tabela 69. Kontributi i projektit në ekonominë rajonale dhe kombëtare

Aspekti	Kontributi
Furnizimi i industrisë me lëndë të parë sekondare	≈ 1 484 t/vit metale ferroke, ≈ 212 t/vit metale joferroke, ≈ 106 t/vit plastikë
Reduktimi i importit të lëndës së parë primare	Zëvendësim i pjesshëm i importit të skrapit dhe të granulatit plastik
Reduktimi i ngarkesës në deponi	Potencial për devijim nga deponimi; rezultati verifikohet nga fletë-përcjellëset dhe operacionet finale të operatorëve pranues
Kontributi në objektivat kombëtare të riciklimit	Mbështetje e drejtpërdrejtë e zbatimit të hierarkisë së menaxhimit të mbeturinave dhe e tranzicionit drejt ekonomisë qarkore, si objektivi i Ligjit nr. 08/L-071
Kontributi në zbutjen e ndryshimeve klimatike	Bilanc klimatik vetëm indikativ; nuk deklarohet rezultat neto pa verifikimin e sasive, destinacioneve dhe faktorëve
Kontributi fiskal	Tatime, kontribute pensionale dhe taksa komunale
Kontributi në kapacitetin institucional	Krijimi i një pike të licencuar dhe të gjurmueshme për automjetet jashtë përdorimit, duke reduktuar çmontimin e paautorizuar

6.24. Ekosistemet dhe gjeologjia

Lokacioni është hapësirë e urbanizuar dhe industriale: rreth 2.750 m² mbulohen nga objekte ose sipërfaqe operative të papërshkueshme, ndërsa rreth 166 m² janë sipërfaqe të gjelbra. Nuk është kryer inventar sezonal i habitatit; prandaj ndikimi vlerësohet i ulët, me kusht që sipërfaqet e gjelbra të ruhen dhe të mos përdoren për mbeturina.

6.25. Humbja dhe dëmtimi i specieve bimore dhe shtazore dhe habitateve të tyre

Nuk parashihet humbje e drejtpërdrejtë e habitatit, sepse nuk kryhen gërmime, prerje drurësh ose zgjerim jashtë parcelës së transformuar. Megjithatë, nuk është kryer inventar sezonal i florës dhe faunës; prandaj mungesa e specieve të rralla nuk deklarohet në mënyrë kategorike. Duke marrë parasysh Librat e Kuq dhe ndjeshmërinë e korridorit të Sitnicës, ndikimi vlerësohet i ulët dhe i kushtëzuar me parandalimin e shkarkimeve dhe ruajtjen e sipërfaqeve të gjelbra.

Rreziku indirekt i identifikuar është ndotja e mundshme e Lumit Sitnica nga ujërat atmosferike të kontaminuara, i cili adresohet përmes separatorit koalescent dhe monitorimit të parametrave të daljes. Rrezik i dytë i identifikuar është krijimi i habitatit artificial për vektorë (mushkonja) në ujin e stagnuar brenda gomave të magazinuara; kjo adresohet përmes masës së detyrueshme të magazinimit të gomave në mënyrë që parandalon grumbullimin e ujit.

6.26. Humbja dhe dëmtimi i veçorive gjeologjike, paleontologjike dhe gjeomorfologjike biodiversiteti, florës dhe fauna, pasurive natyrore të mbrojtura, specieve të rralla dhe të rrezikuara të bimëve dhe kafshëve të egra dhe habitateve të tyre

Nuk parashihet dëmtim i veçorive gjeologjike, paleontologjike ose gjeomorfologjike, sepse nuk kryhen gërmime. Nuk ka të dhëna të verifikuara për pasuri natyrore të mbrojtura brenda parcelës; prania e specieve të rralla në zonën më të gjerë nuk përjashtohet pa vërtetim sezonal. Ndikimi i drejtpërdrejtë vlerësohet i ulët, me kusht që të mos ketë shkarkime në tokë, ujëra nëntokësore ose drejt Sitnicës.

6.27. Qëllimi dhe shfrytëzimi i sipërfaqeve

Qëllimi i shfrytëzimit të sipërfaqes është në përputhje me destinimin komercial/ekonomik të zonës sipas Hartës Zonale Komunale të Lipjanit. Nuk kërkohet ndryshim i destinimit.

6.28. Sipërfaqet e ndërtuara dhe të pa ndërtuara

Sipërfaqet e parcelës ndahen në objekte, zona operative të papërshkueshme dhe zonë të gjelbër që nuk përdoret për magazinim. Tabela në vijim paraqet bilancin hapësinor dhe kufirin që duhet të respektohet gjatë operimit.

Tabela 70. Bilanci i sipërfaqeve të ndërtuara dhe të pa ndërtuara

Kategoria	Sipërfaqja (m ²)	Pjesa (%)	Vërejtje
Sipërfaqe e ndërtuar (2 hangarë)	1690	58.0	Ekzistuese; e pandryshuar
Sipërfaqe e asfaltuar / betonuar operative	≈ 1 060	≈ 36.4	Ekzistuese; e papërshkueshme
Sipërfaqe të gjelbra dhe kufij	≈ 166	≈ 5.7	Ekzistuese; e pandryshuar
TOTAL	2916	100.0	
Sipërfaqe e re e zaptuar nga projekti	0	0.0	Nuk parashihet zaptim i sipërfaqes së re

6.29. Shfrytëzimi i tokës

Shfrytëzimi i tokës brenda parcelës është industrial/komercial dhe mbetet i pandryshuar. Nuk ndryshohet kategoria e shfrytëzimit, nuk zaptohet tokë bujqësore, pyjore apo tokë me destinim tjetër, dhe nuk kërkohet konvertim i destinimit. Koeficienti i ndërtimit (0.58) dhe koeficienti i sipërfaqes së papërshkueshme mbeten të pandryshuara.

6.30. Infrastrukturën komunale

Projekti shfrytëzon infrastrukturën komunale ekzistuese. Ngarkesa shitesë e gjeneruar është e vogël dhe nuk kërkon zgjerim të kapaciteteve publike.

6.31. Trafiku

Ngarkesa e projektuar është rreth 455 ngarkesa hyrje/vit, përkatësisht rreth 910 lëvizje hyrje-dalje ose 3,6 lëvizje të mjeteve të rënda në ditë pune, plus rreth 12 lëvizje të veturave të personelit. Përqindja ndaj M-25 nuk deklarohet pa numërim trafiku. Ndikimi pritët i ulët me organizim njëkahor brenda parcelës dhe pa shkarkim ose qëndrim në rrugën publike; verifikohet me regjistrat e qarkullimit.

6.32. Furnizimi me ujë

Konsumi i ujit është ≈ 90 m³/vit (≈ 0.36 m³/ditë pune), i cili përfaqëson ngarkesë të papërfillshme ndaj kapacitetit të rrjetit publik të ujësjellësit. Nuk kërkohet zgjerim i rrjetit dhe nuk kërkohet lidhje e re. Ndikimi vlerësohet **i papërfillshëm**.

6.33. Energjia

Konsumi i energjisë elektrike është ≈ 33.4 MWh/vit, me fuqi maksimale të njëkohshme të vlerësuar nën 30 kW. Ky konsum përfaqëson ngarkesë të papërfillshme ndaj kapacitetit të rrjetit të distribuimit. Nuk kërkohet stacion transformator i ri. Ndikimi vlerësohet **i papërfillshëm**. Rekomandohet zëvendësimi i ndriçimit ekzistues me ndriçim LED, i cili mund të reduktojë konsumin e ndriçimit deri në 50 %.

6.34. Ujërat e zeza

Ngarkesa e ujërave të zeza sanitare është ≈ 45 m³/vit, e menaxhuar përmes gropës septike të papërshkueshme, me zbrastje periodike nga operator i licencuar. Nuk gjenerohen ujëra teknologjike. Ujërat atmosferike nga sipërfaqja me rrezik ndotjeje trajtohen në separator koalescent para shkarkimit. Ngarkesa ndaj infrastrukturës publike vlerësohet **e papërfillshme**.

Rekomandim me prioritet: duke marrë parasysh ndjeshmërinë e lartë të akuiferit aluvial, lidhja e ujërave sanitare me rrjetin publik të kanalizimit përbën zgjidhjen e preferuar mjedisore dhe duhet të realizohet sapo të jetë teknikisht e mundur. Deri në realizimin e lidhjes, papërshkueshmëria e gropës septike duhet të verifikohet dhe të dokumentohet.

6.35. Gjenerimi i mbeturinave

Gjenerimi i mbeturinave është analizuar në detaje në nënkapitullin 2.6, ku paraqiten regjistri i plotë i kodeve sipas Katalogut Shtetëror të Mbeturinave, bilanci material i çmontimit dhe mbeturinat e gjeneruara nga funksionimi i objektit. Përmbledhja e ndikimit:

Tabela 71. Përmbledhja e ndikimit në gjenerimin dhe menaxhimin e mbeturinave

Treguesi	Vlera	Vlerësimi
Mbeturina të pranuar nga jashtë	2000 t/vit	Input i veprimtarisë – nuk përbën gjenerim
Mbeturina të gjeneruara nga funksionimi	48.5 t/vit	Përfshin ≈ 45.0 t/vit ujëra/llumra sanitare dhe 3.5 t/vit rrjedha të tjera; të menaxhueshme me transferim të dokumentuar
nga të cilat të rrezikshme	2.0 t/vit	Dorëzohen tek operatorë të licencuar
Rrjedha potencialisht të drejtura për rikuperim	≤ 2002.3 t/vit	Maksimum teorik; verifikohet me dokumentet e transferimit
Rrjedha të drejtura për asgjësim jashtë lokacionit	≥ 46.2 t/vit	Minimumi përfshin mbeturinat komunale dhe ujërat/llumrat septike; shtohet çdo rrjedhë tjetër e kontraktuar për operacion D
Ndikimi neto në rrjedhat e mbeturinave	Pozitiv, për t'u verifikuar	Kontributi llogaritet nga të dhënat vjetore të transferimit

Kontejner 1,1 m³




Figura 34. Kontejner për mbeturina komunale, kapacitet 1.1 m³, i shfrytëzuar sipas kontratës me KRM "Pastrimi"

6.36. Pasuritë e mbrojtura natyrore, kulturore dhe rrethina e tyre, veçoritë e peizazhit

Bazuar në vlerësimet e nënkapitujve 3.7, 3.9 dhe 3.12, në zonën e ndikimit të projektit nuk janë identifikuar pasuri natyrore me status të veçantë mbrojtjeje, monumente të mbrojtura kulturore, historike apo arkeologjike. Peizazhi është urban-industrial, i transformuar, pa vlera estetike të mbrojtura. Veprimtaria zhvillohet në objekte ekzistuese dhe nuk ndryshon karakterin vizual të zonës. Ndikimi vlerësohet **pa ndikim**.

6.37. Përshkrimi i ndikimeve të projektit në mjedis përmban gjithashtu informacione që rezultojnë nga zbatimi i projektit, ndikimet kumulative dhe shtrirja hapësinore

Nënkapitujt në vijim paraqitin informacionet shtesë të kërkuara nga neni 10, paragrafi 3 i UA (MMPHI) nr. 04/2025.

6.38. Zbatimi i projektit, duke përfshirë punimet e largimit, sipas rastit

Zbatimi realizohet brenda lokacionit ekzistues. Punimet e largimit aplikohen vetëm në rast të ndërprerjes përfundimtare të veprimtarisë dhe përfshijnë largimin e plotë të mbeturinave, të pajisjeve dhe të substancave potencialisht ndotëse, pastrimin e sipërfaqeve, kampionimin verifikues të tokës dhe – nëse konstatohet ndotje – rehabilitimin. Fazat, afatet dhe kërkesat janë përcaktuar në nënkapitullin 2.8 dhe 5.19.

Tabela 72. Ndikimet nga punimet e largimit dhe masat përkatëse

Aspekti i punimeve të largimit	Ndikimi i pritshëm	Masa
Largimi i mbeturinave të magazinuara	Rritje e përkohshme e trafikut dhe e pluhurit	Planifikim i fazuar; lagje e sipërfaqeve; dorëzim vetëm tek operatorë të licencuar
Zbrazja e depozitave dhe e enëve	Rrezik i derdhjes gjatë manipulimit	Kryerja nga operator i licencuar; pellgje mbajtëse; complete absorbuese
Zbrazja e separatorit dhe e gropës septike	Rrezik i derdhjes	Autocisternë; operator i licencuar
Pastrimi i sipërfaqeve	Gjenerim i ujërave të pastrimit të kontaminuara	Drejtim i ujërave në separator para zbrazjes së tij
Kampionimi verifikues	Nuk ka ndikim negativ	Kampionim nga laborator i akredituar; raport drejtuar MMPHI-së

6.39. Ndikimet kumulative të projekteve të tjera ekzistuese

Zona përmban veprimtari të tjera të ngjashme (qendra për grumbullimin dhe përpunimin e materialeve metalike, depo materialeve ndërtimore, betonjerë, shërbime logjistike), të cilat krijojnë ngarkesë ekzistuese në ajër, zhurmë dhe trafik. Vlerësimi kumulativ:

Tabela 73. Vlerësimi i ndikimeve kumulative me veprimtaritë ekzistuese në zonë

Faktori	Ngarkesa ekzistuese në zonë	Kontributi i projektit	Ndikimi kumulativ	Vlerësimi
Pluhur (PM ₁₀)	E moderuar – veprimtari metalpunuese, betonjerë, trafik i rëndë	Inventar paraprak; përqendrimi dhe ndikimi verifikohen me matje	Nuk kuantifikohet paraprakisht; përcaktohet nga krahasimi sipër/nën erë dhe rezultatet operative	I ulët, i kushtëzuar me MN-04 dhe me veprim korrigjues sipas rezultateve
Zhurma	E ngritur gjatë orarit të punës	Vlerësim orientues; matjet në kufi dhe te receptorët përcaktojnë kontributin real	Rritje logaritmike e papërfillshme (< 0.5 dB)	I ulët
Trafiku i rëndë	E moderuar në M-25 dhe në rrugët e brendshme	≈ 3.6 lëvizje/ditë pune	Përqindja ndaj M-25 nuk përcaktohet pa numërim trafiku	I papërfillshëm

Faktori	Ngarkesa ekzistuese në zonë	Kontributi i projektit	Ndikimi kumulativ	Vlerësimi
Ujërat nëntokësore	Ngarkesë e mundshme kumulative nga veprimtaritë ekzistuese metalpunuese mbi akuifer të ndjeshëm	I kontrolluar përmes separatorit dhe sipërfaqeve të papërshkueshme	Rrezik kumulativ i identifikuar – kërkon monitorim	I ulët, i kushtëzuar me monitorimin
Toka	Ndotje e mundshme historike e padokumentuar	Kontakt i eliminuar me tokën	I pandryshuar	I ulët
Peizazhi	Karakter industrial i konsoliduar	Pa ndryshim vizual	I pandryshuar	Pa ndikim
Rrjedhat e mbeturinave	Kapacitet i kufizuar i riciklimit në nivel lokal	Potencial pozitiv; sasia reale e rikuperuar verifikohet çdo vit	Përmirësim kumulativ	Pozitiv

Rreziku kumulativ kryesor i identifikuar është ngarkesa e kombinuar ndaj akuiferit aluvial me përshkueshmëri të lartë, e krijuar nga prania e disa veprimtarive metalpunuese në zonën e njëjtë. Për këtë arsye, monitorimi i ujërave nëntokësore në pusin ekzistues është klasifikuar si masë e detyrueshme dhe jo fakultative, dhe rezultatet duhet të raportohen në MMPHI për të mundësuar vlerësim kumulativ në nivel zone.

6.40. Të dhëna për shtrirjen e mundshme hapësinore të ndikimit negativ në mjedis

Shtrirja e ndikimit përcaktohet nga burimi, rruga e transmetimit dhe receptori përkatës. Tabela në vijim dallon ndikimet brenda parcelës, në afërsi dhe ato teorikisht më të gjera.

Tabela 74. Shtrirja hapësinore e ndikimeve negative të mundshme

Faktori i ndikimit	Shtrirja e vlerësuar	Vlerat e ndikuara brenda shtrirjes
Pluhur difuz (PM ₁₀)	Nuk kuantifikohet pa matje ose modelim; zona e kontrollit përfshin kufirin sipër/nën erë dhe receptorin më të ekspozuar sipas rezultateve	Sipërfaqe industriale/komerciale fqinje dhe receptorët e përcaktuar në MN-04
Zhurma (> 45 dB(A))	< 250 m nga kufiri i parcelës	Sipërfaqe industriale; pa objekte banimi apo objekte sociale
Dridhjet	< 30 m nga burimi	Brenda kufijve të parcelës
Ndotje e tokës (në rast derdhjeje)	Pikësore, brenda kufijve të parcelës	Tokë e mbuluar me shtresë të papërshkueshme; pa funksion natyror
Ndotje e ujërave nëntokësore (në rast dështimi të masave)	Deri 200–300 m në drejtimin e rrjedhës nëntokësore (jugperëndim)	Akuiferi aluvial; potencialisht Lumi Sitnica në 450 m
Ndotje e ujërave sipërfaqësore (në rast dështimi të separatorit)	Deri në Lumin Sitnica, ≈ 450 m	Trupi ujqor sipërfaqësor
Ndikim vizual	< 500 m	Sipërfaqe industriale dhe rrugë
Ndikim ndërkuftar	Nuk ekziston	—

6.41. Shkarkimi i ujërave të ndotura gjatë fazës së ndërtimit

Faza e ndërtimit nuk aplikohet, pasi objektet janë ekzistuese. Gjatë fazës përgatitore (instalimi i separatorit, ndërtimi i platformës së depolutimit, riparimi i sipërfaqeve) mund të gjenerohen sasi shumë të vogla ujërash

nga larja e pajisjeve dhe nga betonimi. Këto menaxhohen përmes: ndalimit të shpëlarjes së mikserëve dhe pajisjeve në lokacion; grumbullimit të ujërave të betonimit në enë dhe largimit të tyre nga kontraktori; dhe drejtimit të rrjedhjeve në separator pas vënies në funksion të tij. Sasia e vlerësuar është nën 5 m³ për tërë fazën përgatitore. Ndikimi vlerësohet **i papërfillshëm**.

6.42. Emetimet e rrezatimit elektromagnetik gjatë ndërtimit

Nuk ekzistojnë emetime të rrezatimit elektromagnetik gjatë fazës përgatitore. Nuk instalohen transformatorë të tensionit të lartë, antena, apo pajisje me emetim elektromagnetik të rëndësishëm. Instalimet elektrike janë me tension të ulët (0.4 kV) dhe emetimi elektromagnetik i tyre është në nivele tipike të instalimeve komerciale, dukshëm nën vlerat referuese të ekspozimit të popullatës. Ndikimi vlerësohet **pa ndikim**.

6.43. Emetimet në ajër të gazrave serrë gjatë operimit

Tabela e gazeve serrë paraqet një skenar indikativ, jo bilanc të verifikuar. Emetimet nga karburanti dhe energjia përditësohen me faturat reale; emetimet e shmangura mund t'i atribuohen projektit vetëm pasi të verifikohen sasitë e dërguara për rikuperim, operacioni final dhe faktorët e dokumentuar. Projekti nuk ka burim termik të drejtuar. Masat për reduktimin e mëtejshëm të emetimeve: zëvendësimi i ndriçimit me LED; optimizimi i rrugëve të brendshme për reduktimin e konsumit të karburantit; ndalimi i xhirimit të pandërprerë të motorëve në pritje; optimizimi i ngarkesave për reduktimin e numrit të transporteve; dhe – si opsion afatmesëm – instalimi i sistemit fotovoltaik në kulmet e hangarëve (sipërfaqe e disponueshme ≈ 1690 m²).

6.44. Ndikimet në ndryshimet klimatike

Projekti krijon potencial për përfitim klimatik përmes rikuperimit, por bilanci neto nuk deklarohet si rezultat i verifikuar pa sasitë reale, operacionet finale dhe faktorët e dokumentuar. Rreziqet kryesore për projektin janë reshjet intensive, që mund të mbingarkojnë drenazhimin dhe separatorin, dhe valët e nxehtësisë, që rrisin rrezikun e zjarrit dhe avullimit të hidrokarbureve; masat e përshtatjes janë paraqitur në nënkapitullin 6.4.

7. PËRSHKRIMI I MASAVE PËR TË PARANDALUAR, REDUKTUAR OSE ELIMINUAR NDIKIMIN NË MJEDIS

Masat janë ndarë në dy kategori: **masa të detyrueshme**, zbatimi i të cilave përbën kusht për operimin e ligjshëm dhe verifikohet nga organi mbikëqyrës; dhe **masa rekomanduese**, të cilat përmirësojnë performancën mjedisore pa përbërë kusht ligjor. Për secilën masë është përcaktuar afati i zbatimit dhe përgjegjësi.

7.1. Masat e parashikuara me legjislacion, norma e standarde dhe afate për zbatimin e tyre

Masat ligjore dhe teknike janë kthyer në detyrime me afat, përgjegjës dhe provë verifikimi. Tabela në vijim shërben si listë zbatimi dhe kontrollonhet para operimit të plotë dhe gjatë inspektimeve.

Tabela 75. Masat e parashikuara me legjislacion, afatet dhe përgjegjësitë

Nr.	Masa	Baza ligjore / normativa	Afati i zbatimit	Përgjegjësi
M-01	Kodifikimi i të gjitha mbeturinave sipas Katalogut Shtetëror të Mbeturinave, me kod gjashtë-shifror dhe shënjim (*) për mbeturinat e rrezikshme	UA (MMPH) nr. 13/2013, nenet 2–6	Para pranimit të mbeturinave	Përgjegjësi për mjedis
M-02	Mbajtja e ditarit të mbeturinave me të dhëna për sasinë, kodin, prejardhjen dhe destinacionin; ruajtja e fletë-përcjellëseve	Ligji nr. 04/L-060, i ndryshuar	Nga dita e parë e operimit	Përgjegjësi për mjedis
M-03	Ndarja e mbeturinave në burim dhe ndalimi i përzierjes së fraksioneve me kod të ndryshëm; ndalimi i përzierjes së mbeturinave të rrezikshme me jo të rrezikshme	Ligji nr. 04/L-060, neni 4 dhe nenet 30–32	Të vazhdueshme	Operatorët e magazinës
M-04	Magazinimi i mbeturinave vetëm në vende teknikisht të përgatitura, në kushte që parandalojnë ndotjen e tokës, ujërave dhe ajrit	Ligji nr. 04/L-060, neni 32	Të vazhdueshme	Operatorët e magazinës
M-05	Dorëzimi i mbeturinave vetëm tek operatorë me licencë valide për kodin përkatës; ruajtja e kopjeve të licencave	Ligji nr. 04/L-060	Para dorëzimit të parë	Menaxheri i objektit
M-06	Instalimi i separatorit koalescent vaj/ujë klasa I, NS 15 (EN 858), për sipërfaqen me rrezik ndotjeje prej 1000 m ²	Ligji nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës; UA (MMPHI) nr. 02/2022; EN 858	Para operimit të plotë; para pranimit/depolutimit të mbeturinave të rrezikshme, sipas relevancës	Menaxheri i objektit
M-07	Monitorimi i parametrave të shkarkimit në daljen e separatorit dhe pajtueshmëria me vlerat kufizuese	UA (MMPHI) nr. 02/2022	2 herë në vit, nga instalimi	Përgjegjësi për mjedis

Nr.	Masa	Baza ligjore / normativa	Afati i zbatimit	Përgjegjësi
M-08	Verifikimi i papërshkueshmërisë së gropës septike dhe zbrazja periodike nga operator i licencuar	Ligji nr. 04/L-147; Ligji nr. 04/L-060	Para operimit të plotë; para pranimit/depolutimit të mbeturinave të rrezikshme, sipas relevancës	Menaxheri i objektit
M-09	Kufizimi i nivelit të zhurmës në kufirin e parcelës brenda vlerave të lejuara; operim vetëm gjatë orarit ditor	Ligji nr. 02/L-102 për Mbrojtjen nga Zhurma dhe aktet nënligjore përkatëse	Të vazhdueshme	Menaxheri i objektit
M-10	Kontrolli i emetimeve difuze të pluhurit përmes lagjes së sipërfaqeve, mbulimit të boksesh dhe pastrimit të rregullt	Ligji nr. 08/L-025 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja	Të vazhdueshme	Operatorët operativë
M-11	Vlerësimi i rreziqeve në punë, pajisja e punonjësve me PMP dhe trajnimi i detyrueshëm	Ligji nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë	Para operimit të plotë; para pranimit/depolutimit të mbeturinave të rrezikshme, sipas relevancës	Përgjegjësi për SHSP
M-12	Pajisja me mjete të fikjes së zjarrit, sinjalistikë dhe plan evakuimi	Ligji nr. 08/L-261 për Mbrojtje nga Zjarri	Para operimit të plotë; para pranimit/depolutimit të mbeturinave të rrezikshme, sipas relevancës	Menaxheri i objektit
M-13	Transporti i mbeturinave të rrezikshme me mjete të autorizuar dhe me fletë-përcjellëse	Ligji nr. 04/L-060; kërkesat e ADR-së	Para dorëzimit të parë të mbeturinave të rrezikshme	Menaxheri i objektit
M-14	Lëshimi i certifikatës së shkatërrimit për automjetet jashtë përdorimit dhe verifikimi i dokumentacionit të pronësisë	Legjislacioni për automjete dhe për mbeturina	Nga pranimi i parë i ELV	Personeli i pranimit
M-15	Njoftimi i MMPHI-së për çdo ndryshim material të veprimtarisë, të kapacitetit ose të llojeve të mbeturinave	Ligji nr. 08/L-181 për VNM	Brenda afatit ligjor	Menaxheri i objektit

7.2. Masat që duhen marrë në rast aksidentesh dhe fatkeqësive të mëdha

Skenarët emergjentë dhe veprimet e menjëhershme janë përcaktuar në nënkapitullin 5.18. Në përputhje me nenin 11, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.5 të UA (MMPHI) nr. 04/2025, në vijim paraqiten substancat e rrezikshme të pranishme në lokacion, sasitë dhe karakteristikat e tyre.

Tabela 76. Substancat e rrezikshme në lokacion, sasitë, karakteristikat dhe masat e kontrollit

Substanca e rrezikshme	Kodi i mbeturinës	Sasia maksimale e njëkohshme	Karakteristikat e rrezikshmërisë	Masa e kontrollit
Vajra motorikë, të ingranazheve dhe lubrifikues të përdorur	13 02 05*	≈ 1 000 l (2 depozita × 500 l)	Toksik për organizmat akuatikë; kancerogjen i mundshëm; i ndezshëm në temperatura të lartë; HP 14 (ekotoksik)	Depozitë me mure të dyfishta ose pëllg mbajtës ≥ 110 %; brenda objektit; ventilim; absorbues pranë

Substanca e rrezikshme	Kodi i mbeturinës	Sasia maksimale e njëkohshme	Karakteristikat e rrezikshmërisë	Masa e kontrollit
Vaj hidraulik i përdorur	13 01 10*	≈ 200 l	Ekotoksik; irritues për lëkurën	Enë e mbyllur mbi pellg mbajtës; etiketim
Karburant i mbetur (benzinë, naftë)	13 07 02*	≈ 100 l	Shumë i ndezshëm (HP 3); avullues; toksik për thithje	Enë metalike hermetike antistatike; larg burimeve të nxehtësisë; ndalim i punës me flakë të hapur në rreze 10 m
Elektrolit acidik në akumulatorë	16 06 01*	≈ 400 kg akumulatorë (≈ 120 l acid)	Korroziv (HP 8); reagon me metale duke lëshuar hidrogjen; përmban plumb (toksik, HP 6, HP 11)	Kontejner acid-rezistent i mbuluar; pellg mbajtës; polet e izoluar; ndalim i përmbysjes; agjent neutralizues (gëlqere/sodë) në gatishmëri
Lëng antifrizë (glikol etilenik)	16 01 14*	≈ 200 l	Toksik për thithje (HP 6); ekotoksik	Enë polietileni e mbyllur mbi pellg mbajtës; etiketim
Lëng frenash	16 01 13*	≈ 50 l	Toksik; higroskopik; irritues	Enë e veçantë e mbyllur; etiketim
Filtra vaji të përdorur	16 01 07*	≈ 200 kg	Përmbajnë hidrokarbure; ekotoksik	Enë hermetike me kapak mbi tabaka kullimi; brenda objektit
Qese ajri dhe komponentë piroteknikë	16 01 10*	≈ 50 njësi	Shpërthyes (HP 1); rrezik i aktivizimit mekanik	Kuti metalike e izoluar; mbrojtje nga goditje dhe nxehtësi; ndalim i aktivizimit; personel i trajnuar
Absorbues dhe lecka të kontaminuara	15 02 02*	≈ 100 kg	Përmbajnë hidrokarbure; rrezik i vetëndezjes në sasi të mëdha	Enë metalike me kapak; largim i rregullt; ndalim i akumulimit
MPEE me komponentë të rrezikshëm	16 02 13*, 20 01 35*	≈ 2 t	Përmbajnë metale të rënda, retardantë të flakës të bromuar, kondensatorë	Depo e veçantë e mbuluar; ndalim i çmontimit; magazinim i pandryshuar

Sasitë e paraqitura janë kufij maksimalë të njëkohshëm operativë, të derivuar nga bilanci vjetor dhe nga frekuenca e dorëzimit tek operatorët e licencuar. Tejkallimi i këtyre kufijve nuk lejohet dhe kontrollohet përmes ditarit të mbeturinave. Sasia totale e njëkohshme e mbeturinave të rrezikshme mbahet nën ≈ 12 t, dukshëm nën pragjet që do të aktivizonin kërkesa shtesë për parandalimin e aksidenteve të mëdha.

Tabela 77. Masat specifike për rast aksidentesh dhe fatkeqësive të mëdha

Nr.	Masa për rast aksidentesh dhe fatkeqësive të mëdha	Afati	Përgjegjësi
M-16	Hartimi dhe miratimi i Planit të Reagimit Emergjent, me skenarët e nënkaptullit 5.18, listën e kontakteve emergjente dhe skemën e evakuimit	Para operimit të plotë dhe para pranimi të mbeturinave të rrezikshme	Përgjegjësi për mjedis dhe SHSP
M-17	Vendosja e completeve të reagimit ndaj derdhjeve pranë secilës zonë të mbeturinave të rrezikshme (absorbues ≥ 50 kg, lopatë antishkëndijë, enë e zbrazët, PMP)	Para operimit të plotë dhe para pranimi të mbeturinave të rrezikshme	Përgjegjësi për mjedis

Nr.	Masa për rast aksidentesh dhe fatkeqësive të mëdha	Afati	Përgjegjësi
M-18	Sigurimi i agentit neutralizues (gëlqere hidratuar ose sodë) pranë depos së akumulatorëve	Para operimit të plotë dhe para pranimi të mbeturinave të rrezikshme	Përgjegjësi për mjedis
M-19	Ushtrim praktik i reagimit ndaj derdhjeve dhe ndaj zjarrit, me dokumentim	2 herë në vit (derdhje), 1 herë në vit (zjarr)	Përgjegjësi për SHSP
M-20	Mbajtja e regjistrit të incidenteve mjedisore dhe raportimi në MMPHI brenda afatit ligjor	Të vazhdueshme	Përgjegjësi për mjedis
M-21	Ankorimi i depozitave, rafteve dhe enëve të mbeturinave të rrezikshme, duke marrë parasysh zonën sizmike VIII	Para operimit të plotë dhe para pranimi të mbeturinave të rrezikshme	Menaxheri i objektit
M-22	Sigurimi i mundësisë së izolimit të ujit të fikjes së zjarrit (valvulë ndërprerëse në daljen e separatorit) për të parandaluar shkarkimin e ujit të kontaminuar	Para operimit të plotë dhe para pranimi të mbeturinave të rrezikshme	Menaxheri i objektit
M-23	Ndalimi i punës me flakë të hapur, saldimit dhe prerjes termike në zonat e magazinimit të lëngjeve të ndezshme; sistem lejeve për punë të nxehta	Të vazhdueshme	Përgjegjësi për SHSP

7.3. Planet dhe zgjidhjet teknike për mbrojtjen e mjedisit: trajtimi, riciklimi, dhe magazinimi i mbeturinave, rikultivimi, rehabilitimi i vendndodhjes pas përfundimit të aktivitetit

Zgjidhjet teknike mbulojnë pranimin, magazinimin, ujërat, mbeturinat e rrezikshme, mbylljen dhe rehabilitimin. Tabela në vijim lidh secilën zgjidhje me kriterin e performancës dhe me fazën e zbatimit.

Tabela 78. Planet dhe zgjidhjet teknike për mbrojtjen e mjedisit

Nr.	Zgjidhja teknike	Specifikimi	Funksioni mjedisor	Statusi
T-01	Shtresë e papërshkueshme e sipërfaqeve operative	Asfalt-beton ose beton $\geq$ C25/30; pjerrësi 1–2 % drejt kanaleve; riparim i çarjeve	Barrierë kundër infiltrimit drejt akuiferit aluvial	Ekzistuese – kërkon verifikim dhe riparim
T-02	Platformë e dedikuar e depolutimit	60 m ² ; sipërfaqe rezistente ndaj hidrokarbureve; pellg mbajtës periferik; kanal grumbullimi	Parandalim i derdhjes gjatë heqjes së lëngjeve	Për realizim – e detyrueshme
T-03	Separator koalescent vaj/ujë	Klasa I (EN 858); NS 15; rezervuar rërë-baltë $\geq$ 1 500 l; kapacitet vaji $\geq$ 200 l; alarm i nivelit; bypass sipas nevojës	Mbrojtje e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore; përmbajtje hidrokarburesh $\leq$ 5 mg/l	Për realizim – e detyrueshme
T-04	Pellgje mbajtëse për depozita dhe enë	Vëllim $\geq$ 110 % i enës më të madhe; material i përputhshëm kimikisht	Mbajtja e derdhjeve aksidentale	Për realizim – e detyrueshme
T-05	Depo e mbyllur për mbeturina të rrezikshme	Brenda objektit; ventilim natyror; sipërfaqe e papërshkueshme; kufizim i qasjes; etiketim sipas kodit	Izolim i mbeturinave të rrezikshme nga reshjet dhe nga qasja e paautorizuar	Për realizim – e detyrueshme

Nr.	Zgjidhja teknike	Specifikimi	Funksioni mjedisor	Statusi
T-06	Kontejner acid-rezistent për akumulatorë	Polietilen; i mbuluar; me pellg mbajtës; kapacitet ≥ 500 kg	Parandalim i derdhjes së elektrolitit	Për realizim – e detyrueshme
T-07	Sistem i ndarë i ujërave atmosferike dhe sanitare	Ndarje e plotë e rrjeteve; puseta kontrolli	Parandalim i përzierjes dhe i mbingarkesës	Për verifikim
T-08	Gropë septike e papërshkueshme ose lidhje me rrjetin publik	Test i papërshkueshmërisë; vëllim i dobishëm i përcaktuar; frekuencë zbrazjeje sipas vëllimit ($45 \text{ m}^3/\text{vit}$)	Parandalim i infiltrimit të ngarkesës organike	Për verifikim – e detyrueshme
T-09	Presë hidraulike për ngjeshje	15 kW; ngjeshje e ftohtë; pa përdorim uji apo aditivësh	Reduktim i vëllimit dhe i numrit të transporteve	Ekzistuese
T-10	Bokse të mbuluara për fraksione të lehta	Mbulesë e fiksuar ose rrjetë kundër erës për plastikë, letër dhe karton	Parandalim i shpërndarjes nga era	Për realizim
T-11	Peshojë ose marrëveshje për peshim të certifikuar	Saktësi e mjaftueshme për regjistrimin e sasive në ton	Saktësi e ditarit të mbeturinave dhe e raportimit	Për realizim – e detyrueshme
T-12	Sistem i etiketimit të boksesh dhe enëve	Tabelë me kod gjashtë-shifror, emërtim sipas Katalogut, klasë rrezikshmërie, datë e fillimit të magazinimit	Gjurmueshmëri dhe parandalim i përzierjes	Për realizim – e detyrueshme
T-13	Pajisje të fikjes së zjarrit	Fikëse ABC 6 kg ($1/150 \text{ m}^2$); CO_2 5 kg për panelin elektrik; sinjalistikë; rezervë ujore sipas kushteve të autoritetit kompetent	Mbrojtje kundër zjarrit dhe parandalim i emetimeve toksike	Për plotësim
T-14	Rikultivimi dhe rehabilitimi pas mbylljes	Largim i plotë i mbeturinave; pastrim; kampionim verifikues (metale të rënda, TPH); riparim i shtresës; rehabilitim vetëm nëse konstatohet tejkalim	Dorëzim i lokacionit në gjendje të sigurt	Faza 2–3 e programit kohor

Kusht ndalues operacional: deri në verifikimin teknik dhe dokumentar të T-01 deri T-08, T-11 deri T-13, si dhe të matjeve bazë, nuk lejohet pranimi i mbeturinave të rrezikshme, depolutimi ose çmontimi i automjeteve jashtë përdorimit. Lejohen vetëm aktivitetet përgatitore, administrative dhe menaxhimi i fraksioneve jo të rrezikshme që nuk krijojnë rrezik për tokën, ujërat ose ajrin. Verifikimi dokumentohet me procesverbal, certifikata, fotografi dhe deklaratë të përputhshmërisë.

7.4. Masa të tjera që mund të ndikojnë në parandalimin, zvogëlimin ose neutralizimin e efekteve të dëmshme në mjedis

Përveç masave minimale, janë identifikuar veprime që rrisin parandalimin dhe gatishmërinë operative. Tabela në vijim i rendit ato sipas përparësisë dhe përfitimit të pritshëm.

Tabela 79. Masat rekomanduese shitesë për mbrojtjen e mjedisit

Nr.	Masa rekomanduese	Efekti i pritshëm	Prioriteti
R-01	Lidhja e ujërave sanitare me rrjetin publik të kanalizimit	Eliminim i plotë i rrezikut të infiltrimit të ngarkesës organike drejt akuiferit	I lartë
R-02	Zëvendësimi i ndriçimit ekzistues me ndriçim LED	Reduktim deri 50 % i konsumit të ndriçimit (≈ 9 MWh/vit; ≈ 8 t CO ₂ e/vit)	I mesëm
R-03	Instalimi i sistemit fotovoltaiik në kulmet e hangarëve (sipërfaqe e disponueshme ≈ 1690 m ²)	Reduktim i emetimeve indirekte; pavarësi energjetike e pjesshme	I mesëm
R-04	Zbatimi i sistemit të menaxhimit mjedisor sipas ISO 14001	Sistematizim i kontrollit mjedisor; përmirësim i vazhdueshëm; përmbushje e nenit 13 të UA nr. 04/2025	I mesëm
R-05	Mbulimi i pjesshëm i zonës së pritjes së automjeteve jashtë përdorimit	Reduktim i vëllimit të ujërave atmosferike të kontaminuara që kalojnë në separator	I mesëm
R-06	Instalimi i pikës së lagjes së sipërfaqeve (sistem i thjeshtë me spërkatës)	Reduktim 50–70 % i emimit difuz të pluhurit në periudha të thata	I mesëm
R-07	Zëvendësimi i manipulatorit dizel me njësi elektrike	Eliminim i emetimeve direkte (6.4 t CO ₂ e/vit) dhe reduktim i zhurmës	I ulët (afatgjatë)
R-08	Krijimi i një rezerve financiare ose garancie për rehabilitimin e lokacionit	Garanci që rehabilitimi realizohet edhe në rast të pamundësisë financiare	I lartë
R-09	Instalimi i një piezometri të tretë, shitesë ndaj dy pikave të detyrueshme të MN-01, në drejtimin poshtë rrjedhjes	Rritje e mbulimit hapësinor dhe zbulim më i hershëm; nuk zëvendëson pikën referuese sipër rrjedhjes dhe piezometrin e detyrueshëm poshtë rrjedhjes	I mesëm
R-10	Vendosja e brezit të gjelbër përgjatë kufirit lindor të parcelës	Zbutje e pluhurit dhe përmirësim i pamjes vizuale	I ulët
R-11	Digjitalizimi i ditarit të mbeturinave	Reduktim i gabimeve; raportim më i shpejtë; gjurmueshmëri e përmirësuar	I mesëm
R-12	Auditim i brendshëm mjedisor një herë në vit nga ekspert i pavarur	Verifikim i pavarur i pajtueshmërisë; identifikim i hershëm i mangësive	I mesëm

8. PROGRAMI I MONITORIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS

8.1. Programi i monitorimit të ndikimit në mjedis

Programi i monitorimit është ndërtuar në tri nivele: monitorim bazë referues, monitorim operativ i vazhdueshëm dhe monitorim analitik periodik. Ai mbulon të gjithë faktorët mjedisorë për të cilët është identifikuar ndikim i mundshëm, dhe është dimensionuar në proporcion me shkallën e rrezikut të identifikuar – me përqendrim të veçantë në ujërat nëntokësore, të cilat përbëjnë receptorin më të ndjeshëm të lokacionit.

Tabela 80. Struktura e programit të monitorimit mjedisor

Niveli	Qëllimi	Instrumenti	Frekuenca
Niveli 1 – Monitorim bazë referues	Përcaktimi i gjendjes referuese përpara operimit të plotë	Kampionim dhe analizë laboratorike; matje akustike	Një herë, para operimit të plotë
Niveli 2 – Monitorim operativ i vazhdueshëm	Kontroll i zbatimit të masave dhe i pajtueshmërisë ditore	Ditar i mbeturinave; inspektime vizuale; lista kontrolli	Ditore / javore / mujore
Niveli 3 – Monitorim analitik periodik	Verifikimi i efikasitetit të masave dhe i mos-përkeqësimit	Kampionim dhe analizë në laborator të akredituar; matje akustike dhe të ajrit	Gjysmëvjetore / vjetore / trevjeçare

8.2. Prezantimin e gjendjes mjedisore përpara se projekti të vihet në punë ose fillimi i aktiviteteve në vendet ku ndikimi mjedisor pritët

Gjendja mjedisore aktuale është përshkruar në Kapitullin 4. Vlerësimi ka identifikuar boshllëqe të të dhënave për cilësinë lokale të ujërave nëntokësore, tokës, ajrit dhe zhurmës. Programi i monitorimit bazë referues është i detyrueshëm dhe realizohet para operimit të plotë dhe para pranimit ose depolutimit të mbeturinave të rrezikshme; rezultatet dokumentohen nga laboratorë ose subjekte kompetente dhe përdoren si gjendje referuese nga data e kampionimit.

Rëndësia e matjes bazë referuese: për një veprimtari ekzistuese mbi akuifer me përshkueshmëri të lartë dhe në zonë me veprimtari të tjera ekonomike, matja nga data e kampionimit ndihmon në dallimin ndërmjet ndotjes së mundshme historike dhe ndryshimeve të mëvonshme. Ajo nuk emërtohet “matje zero”; mungesa e saj kufizon mbrojtjen teknike dhe juridike të aplikuesit dhe aftësinë e autoritetit për të zbatuar parimin e mos-përkeqësimit.

8.3. Parametrat në bazë të të cilave mund të përcaktohen efektet e dëmshme në mjedis

Efektet e dëmshme përcaktohen me parametra të matshëm dhe me kritere të krahasueshme në kohë. Tabela në vijim paraqet parametrin, njësinë, kriterin e vlerësimit dhe veprimin kur konstatohet devijim.

Tabela 81. Parametrat e monitorimit, kriteret e vlerësimit dhe referencat

Faktori	Parametrat e monitorimit	Kriteri i vlerësimit	Referenca
Ujërat nëntokësore	pH; përcjellshmëri elektrike; hidrokarbure totale (C ₁₀ –C ₄₀); Pb; Zn; Cu; Cd; Cr; Ni	Mos-përkeqësim ndaj vlerës bazë; pa rritje statistikisht të rëndësishme	Ligji nr. 04/L-147; vlerat bazë të matura
Ujërat atmosferike në daljen e separatorit	pH; TSS; hidrokarbure totale (C ₁₀ –C ₄₀); Pb; Zn; Cu; Cd; Cr; Ni	Pajtueshmëri me vlerat kufizuese të shkarkimit; hidrokarbure ≤ 5 mg/l (klasa I)	UA (MMPHI) nr. 02/2022; EN 858
Toka	Metale të rënda (Pb, Zn, Cu, Cd, Cr, Ni); TPH	Mos-përkeqësim ndaj vlerës bazë	Vlerat bazë të matura

Faktori	Parametrat e monitorimit	Kriteri i vlerësimit	Referenca
Cilësia e ajrit (imision)	PM ₁₀ dhe PM _{2.5} (mesatare 24-orëshe); Pb, Cd dhe Ni në PM ₁₀ sipas vlefshmërisë së mostrës	Pajtueshmëri me vlerat kufi në fuqi dhe pa rritje të dallueshme në pikën nën erë krahasuar me pikën sipër erës	Ligji nr. 08/L-025; EN 12341
Zhurma	LAeq ditor; LAmax; niveli i sfondit	Nën vlerat e lejuara për zonën përkatëse; operim vetëm ditën	Ligji nr. 02/L-102 dhe aktet nënligjore; ISO 1996-2
Ekspozimi i punëtorëve ndaj zhurmës	LEX,8h; LCpeak	Vlera e veprimit 85 dB(A); vlera kufi 87 dB(A)	Ligji nr. 04/L-161 dhe aktet nënligjore
Mbeturinat	Sasia sipas kodit; koha e magazinimit; bilanci hyrje–dalje	Pajtueshmëri me kapacitetin e lejuar (2000 t/vit); afatet maksimale të magazinimit	Ligji nr. 04/L-060; UA nr. 13/2013
Integriteti i barrierave	Gjendja e shtresës së papërshkueshme; gjendja e pellgjeve mbajtëse; nivelet në separator; papërshkueshmëria e gropës septike	Pa çarje; pa rrjedhje; nivele nën alarmin e vajit	EN 858; specifikimet e prodhuesit
Incidentet mjedisore	Numri, tipi, sasia e derdhur, veprimi korrigjues	Zero incidente me pasoja jashtë kufijve të parcelës	Regjistri i incidenteve

8.4. Vendet, mënyra dhe shpeshtësia e matjes së parametrave të përcaktuar

Monitorimi duhet të kryhet në pika përfaqësuese dhe me metoda të dokumentuara nga subjekte kompetente. Tabela në vijim përcakton vendin, mënyrën, frekuencën dhe kryerësin për secilin faktor.

Tabela 82. Programi i detajuar i monitorimit: vendet, metodat, frekuenca dhe kryerësi

Nr.	Objekti i monitorimit	Vendi i matjes	Metoda / standardi	Frekuenca	Kryerësi
MN-01	Ujërat nëntokësore	Së paku dy pika të përcaktuara hidrogeologjike: pikë referuese sipër rrjedhjes dhe piezometër poshtë rrjedhjes; pusi ekzistues përdoret vetëm nëse plotëson kriteret teknike të kampionimit	Kampionim sipas EN ISO 5667; analizë në laborator të akredituar	Matje bazë referuese para operimit të plotë; pastaj 1 herë në vit	Laborator i akredituar
MN-02	Ujërat në daljen e separatorit	Puseta e kontrollit në daljen e separatorit	Kampionim i rastësishëm (grab sample) gjatë reshjeve; analizë në laborator të akredituar	2 herë në vit	Laborator i akredituar
MN-03	Toka	2 pika: zona e depolutimit; depoja e vajrave dhe e akumulatorëve	Kampionim 0–30 cm; analizë në laborator të akredituar	Bazë; pastaj 1 herë në 3 vjet; jashtë radhës pas derdhjeve të rëndësishme	Laborator i akredituar

Nr.	Objekti i monitorimit	Vendi i matjes	Metoda / standardi	Frekuenca	Kryerësi
MN-04	Cilësia e ajrit (PM ₁₀ /PM _{2.5})	Së paku dy pika: një sipër erës dhe një nën erë. Për erëra nga VP/VL, pika nën erë vendoset në sektorin JL/JP; pozita përfundimtare dokumentohet sipas drejtimit real gjatë matjes. Receptori më i ekspozuar shtohet nëse rezultatet e kufirit e kërkojnë.	EN 12341; kampionim 7 ditë të njëpasnjëshme; regjistrim i drejtimit/shpejtësisë së erës; analizë e metaleve në PM ₁₀ sipas vlefshmërisë së mostrës	Bazë; pastaj 1 herë në vit	Laborator i akredituar
MN-05	Zhurma në kufirin e parcelës	3 pika: drejt qendrës urbane; drejt objektit fetar; drejt vendbanimit Hallaq i Vogël	ISO 1996-2; matje LAeq gjatë orarit të punës dhe e sfondit	Bazë; pastaj 1 herë në vit; jashtë radhës pas ankesave	Laborator i akredituar
MN-06	Ekspozimi personal i punëtorëve ndaj zhurmës	Pozicionet e punës të çmontimit dhe të presimit	Dozimetri personale sipas EN ISO 9612	1 herë në vit	Laborator i akredituar
MN-07	Ditari i mbeturinave dhe bilanci hyrje–dalje	Zyra e objektit	Peshim në hyrje/dalje; regjistrim i kodit dhe sasisë; kontroll i afateve	1 vazhdueshëm; përmbledhje mujore	Përgjegjësi për mjedis
MN-08	Inspektim vizual i integritetit të sipërfaqeve dhe i pellgjeve mbajtëse	Tërë lokacioni	Listë kontrolli e dokumentuar; fotodokumentim	Javore (vizual); e detajuar 2 herë në vit	Përgjegjësi për mjedis
MN-09	Kontroll i nivelit të vajit dhe të llumit në separator	Separatori koalescent	Matje e nivelit; verifikim i alarmit	Mujore; zbrazje sipas nevojës, minimum 1 herë në vit	Përgjegjësi për mjedis
MN-10	Kontroll i gropës septike	Gropa septike	Matje e nivelit; test i papërshkueshmërisë	Nivel – mujor; test – 1 herë në vit	Përgjegjësi për mjedis
MN-11	Kontroll i etiketimit dhe i ndarjes së fraksioneve sipas kodit	Të gjitha bokset dhe enët	Listë kontrolli e dokumentuar	Javore	Përgjegjësi për mjedis
MN-12	Verifikim i licencave të operatorëve të jashtëm	Regjistri i operatorëve	Kontroll i vlefshmërisë së licencës për kodin përkatës	1 herë në vit dhe para dorëzimit të parë	Menaxheri i objektit
MN-13	Kontroll i pajisjeve të fikjes së zjarrit	Tërë lokacioni	Inspektim dhe servisim sipas kërkesave të prodhuesit dhe të autoritetit kompetent	1 herë në vit	Kompani e licencuar

Nr.	Objekti i monitorimit	Vendi i matjes	Metoda / standardi	Frekuenca	Kryerësi
MN-14	Regjistri i incidenteve mjedisore dhe i veprimeve korrigjuese	Zyra	Regjistrim i standardizuar; analizë e shkakut rrënjë	Sipas paraqitjes; përmbledhje vjetore	Përgjegjësi për mjedis

8.5. Përmbajtja dhe dinamika e dorëzimit të raporteve për matjet e kryera

Rezultatet e monitorimit duhet të jenë të gjurmueshme nga kampionimi deri te raportimi dhe veprimi korrigjues. Tabela në vijim përcakton përmbajtjen minimale, afatin dhe pranuesin e secilit raport.

Tabela 83. Përmbajtja dhe dinamika e dorëzimit të raporteve të monitorimit

Raporti	Përmbajtja minimale	Afati i dorëzimit	Adresuar
Raport i monitorimit bazë (matja bazë referuese)	Rezultatet e MN-01, MN-03, MN-04, MN-05 dhe testi i papërshkueshmërisë; certifikatat e akreditimit të laboratorit; interpretimi i rezultateve	Para operimit të plotë dhe para pranimit/depolutimit të rrjedhave të rrezikshme; raporti dorëzohet brenda 1 muaji nga matjet dhe në çdo rast jo më vonë se 4 muaj nga pëlqimi mjedisor	MMPHI – Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit
Raport i zbatimit të masave të detyrueshme	Dëshmi të zbatimit të masave M-01 – M-23 dhe T-01 – T-14; fatura, certifikata, fotodokumentim; deklarata e përputhshmërisë	Brenda 7 muajve nga pëlqimi mjedisor	MMPHI – Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit
Raport gjysmëvjetor i monitorimit	Rezultatet e MN-02; përmbledhje e bilancit të mbeturinave sipas kodit; incidentet e regjistruara; veprimet korrigjuese	Brenda 30 ditësh nga përfundimi i gjysmëvjetorit	MMPHI; Komuna e Lipjanit (me kërkesë)
Raport vjetor mjedisor	Rezultatet e të gjitha matjeve të vitit; bilanci vjetor i mbeturinave sipas kodit (hyrje, dalje, magazinim); krahasimi me vlerat bazë dhe me kapacitetin e lejuar; regjistri i trajnimeve; regjistri i incidenteve; vlerësimi i zbatimit të PMM-së; plani i veprimeve për vitin pasues	Deri më 31 mars të vitit pasues	MMPHI – Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit
Raport i incidentit mjedisor	Përshkrimi i incidentit; sasia dhe lloji i substancës; veprimi i menjëhershëm; vlerësimi i pasojave; analiza e shkakut rrënjë; veprimet korrigjuese dhe parandaluese	Njoftim i menjëhershëm (brenda 24 orëve); raport i plotë brenda 7 ditësh	MMPHI; Inspektorati; sipas rastit Komuna dhe operatori i shërbimeve të ujit
Raport i gjendjes përfundimtare (në rast mbylljeje)	Dëshmi e largimit të plotë të mbeturinave; rezultatet e kampionimit verifikues; vlerësimi i nevojës për rehabilitim	Brenda 3 muajve pas largimit të mbeturinave	MMPHI – Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit

Të gjitha raportet dhe të dhënat primare të matjeve arkivohen për së paku 5 vjet dhe janë të disponueshme për inspektim nga organi mbikëqyrës në çdo kohë.

8.6. Detyrimin për të informuar publikun për rezultatet e matjeve të kryera

Aplikuesi obligohet të informojë publikun për rezultatet e monitorimit mjedisor, në përputhje me Ligjin nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe me legjislacionin për qasjen në informacionin publik mjedisor. Mekanizmat e informimit:

Tabela 84. Mekanizmat e informimit të publikut

Mekanizmi	Përmbajtja	Frekuenca / afati
Kopje e raportit vjetor mjedisor në dispozicion të publikut	Përmbledhje e rezultateve të monitorimit; bilanci i mbeturinave; incidentet dhe veprimet korrigjuese	Vjetore, brenda 30 ditësh nga dorëzimi në MMPHI
Kopje e raportit të VNM-së dhe e përmbledhjes joteknike në Komunën e Lipjanit	Raporti i plotë dhe përmbledhja joteknike	Gjatë procedurës së pëlqimit mjedisor dhe pas miratimit
Pikë kontakti për informim dhe ankesa	Emri, numri i telefonit dhe adresa elektronike e përgjegjësit për mjedis, e shënuar në tabelë të dukshme në hyrje të objektit	E vazhdueshme
Regjistër i ankesave dhe i përgjigjeve	Regjistrimi i secilës ankesë, hetimi, veprimi i ndërmarrë dhe përgjigjja	E vazhdueshme; përmbledhje në raportin vjetor
Njoftim i drejtpërdrejtë në rast incidenti me pasoja jashtë kufijve të parcelës	Informacion mbi natyrën e incidentit, rrezikun dhe masat e ndërmarra	Menjëherë pas njoftimit të institucioneve

8.7. Programin ndërkufitar të monitorimit të ndikimit në mjedis, sipas rastit

Programi ndërkufitar i monitorimit **nuk kërkohet**. Arsyeimi: nuk është identifikuar ndikim ndërkufitar në ajër (nënkapitulli 6.5) apo në ujëra (nënkapitulli 6.8); shtrirja maksimale e ndikimeve negative të vlerësuara nuk tejkalon 300 m nga kufiri i parcelës (nënkapitulli 6.40); sasitë e ndotësve të emetuar janë shumë të vogla; dhe nuk emetohen substanca persistente apo bioakumulative në sasi të matshme. Në rast të ndryshimit material të veprimtarisë ose të kapacitetit, nevoja për vlerësim ndërkufitar duhet të rishikohet.

9. PLANI I MENAXHIMIT MJEDISOR

Plani i Menaxhimit Mjedisor (PMM) është instrumenti operativ që lidh masat e Kapitullit 7 me monitorimin e Kapitullit 8, duke përcaktuar përgjegjësitë, afatet, treguesit e performancës dhe mekanizmat e verifikimit. PMM-ja është dokument i gjallë, i rishikuar së paku një herë në vit dhe pas çdo incidenti mjedisor ose ndryshimi material të veprimtarisë.

9.1. Mbrojtja efektive mjedisore gjatë gjithë fazave të projektit

Plani i Menaxhimit Mjedisor bashkon masat e kapitujve paraprakë në një sistem të zbatueshëm gjatë gjithë ciklit të projektit. Tabela në vijim lidh objektivat me treguesit, evidencën dhe kriteret e pranimit.

Tabela 85. Plani i Menaxhimit Mjedisor: objektivat, masat, treguesit dhe verifikimi sipas fazave

Faza	Objektivi mjedisor	Masat kyçe	Treguesi i performancës	Verifikimi
Faza 0 – Përgatitje	Ndërtimi i barrierave mbrojtëse para operimit të plotë	T-01 deri T-08; T-11 deri T-13; platforma e depolutimit; separatori; pellgjet mbajtëse; depoja e mbeturinave të rrezikshme; verifikimi i gropës septike; peshoja; etiketimi; pajisjet kundër zjarrit	100 % e masave të verifikuara para operimit të plotë	Raport i zbatimit të masave; fotodokumentim; certifikata
	Përcaktimi i gjendjes referuese	MN-01, MN-03, MN-04, MN-05 (matje bazë referuese)	Raport i matjeve bazë referuese para operimit të plotë	Raport i laboratorit të akredituar
	Ngritja e kapacitetit të personelit	M-11 vlerësim rreziqesh; trajnimet e nënkapitullit 5.16; SOP-01 – SOP-12	100 % e personelit i trajnuar dhe i dokumentuar	Regjistri i trajnimeve
Faza 1 – Operim	Parandalimi i ndotjes së ujërave nëntokësore dhe të tokës	M-03, M-04, M-06, M-08; T-01, T-04, T-05; kontroll i integritetit (MN-08)	Zero derdhje me infiltrim; hidrokarbure në dalje të separatorit ≤ 5 mg/l; mos-përkeqësim i vlerave bazë	MN-01, MN-02, MN-03; inspektime javore
	Gjurmueshmëri e plotë e rrjedhave të mbeturinave	M-01, M-02, M-05, M-13, M-14; T-11, T-12	100 % e mbeturinave të kodifikuara; bilanc hyrje–dalje i mbyllur; 100 % e dorëzimeve tek operatorë të licencuar	MN-07, MN-11, MN-12; audit i brendshëm
	Kontrolli i emetimeve në ajër dhe i zhurmës	M-09, M-10; R-06 lagje e sipërfaqeve; operim vetëm ditën	PM ₁₀ /PM _{2.5} në pikën nën erë pa rritje të dallueshme kundrejt pikës sipër erës dhe brenda vlerave kufi; LAeq nën vlerat e lejuara	MN-04, MN-05
	Respektimi i kapacitetit dhe i afateve të magazinimit	M-15; kufizimi 2000 t/vit; afate 6/3 muaj	Zero tejkalime të kapacitetit; zero tejkalime të afateve pa justifikim	MN-07; raport vjetor

Faza	Objektivi mjedisor	Masat kyçe	Treguesi i performancës	Verifikimi
	Gatishmëria emergjente	M-16 – M-23; komplete reagimi; ushtrime praktike	2 ushtrime derdhjeje + 1 ushtrim zjarri në vit; komplete të plota në 100 % të zonave	Regjistri i ushtrimeve; MN-08
	Mbrojtja e shëndetit të punëtorëve	M-11; PMP; MN-06 dozimetri; rotacion i detyrave	LEX, 8h nën 87 dB(A); 100 % përdorim i PMP; zero lëndime me humbje kohe pune	MN-06; inspektime; regjistri i lëndimeve
Faza 2 – Mbyllje	Largimi i plotë dhe i gjurmueshëm i mbeturinave	Program kohor i nënkapitullit 2.8; dorëzim vetëm tek operatorë të licencuar	Zero mbeturina të mbetura në lokacion	Ditar i mbeturinave; fletë-përcjellëse
Faza 3 – Rehabilitim	Dorëzim i lokacionit në gjendje të sigurt	Kampionim verifikues; riparim; rehabilitim i pikave me tejkallim	Vlera të tokës brenda kufijve bazë ose të rehabilituara	Raport i gjendjes përfundimtare

9.1.1. Struktura organizative e menaxhimit mjedisor

Ndarja e përgjegjësi është përcaktuar në nënkapitullin 5.15. Elementet kyçe organizative:

- përgjegjësi për mjedis dhe SHSP raporton drejtpërdrejt menaxherit të objektit dhe ka autoritet për ndalimin e operacioneve në rast të rrezikut të drejtpërdrejtë mjedisor;
- mbledhje e rregullt mujore e rishikimit mjedisor, me proces-verbal të dokumentuar;
- rishikim vjetor i PMM-së nga menaxhmenti, me vendime të dokumentuara mbi veprimet korrigjuese dhe burimet e ndara;
- sistem i lejeve për punë të nxehta (saldim, prerje termike) në zonat me lëngje të ndezshme;
- kanal i brendshëm për raportimin e rreziqeve dhe të gati-incidenteve (near miss) nga çdo punonjës, pa pasoja disiplinore.

9.2. Pajtueshmëria me pëlqimin mjedisor

Pajtueshmëria ruhet përmes kontrollit të kushteve të pëlqimit, licencës, regjistrave dhe masave korrigjuese. Tabela në vijim paraqet mekanizmat që parandalojnë tejkallimin e fushëveprimit të autorizuar.

Tabela 86. Mekanizmat e sigurimit të pajtueshmërisë me pëlqimin mjedisor

Mekanizmi i pajtueshmërisë	Përmbajtja	Frekuenca
Regjistri i kushteve të pëlqimit mjedisor	Listë e të gjitha kushteve të përcaktuara në pëlqimin mjedisor, me statusin e zbatimit, afatin, përgjegjësin dhe dëshminë e zbatimit	Përditësim i vazhdueshëm
Vetëvlerësim i pajtueshmërisë	Kontroll sistematik i zbatimit të secilit kusht dhe të secilës masë (M-01 – M-23, T-01 – T-14)	Gjysmëvjetor
Audit i brendshëm mjedisor	Verifikim i pavarur i zbatimit të PMM-së, i saktësisë së ditarit të mbeturinave dhe i rezultateve të monitorimit	Vjetor (rekomandim R-12)
Raportimi në MMPHI	Raportet e përcaktuara në nënkapitullin 8.5	Sipas afateve të përcaktuara
Veprimi korrigjues në rast mospajtueshmërie	Identifikimi; analiza e shkakut rrënjë; veprimi korrigjues me afat dhe përgjegjës; verifikimi i efikasitetit	Brenda 30 ditësh nga konstatimi
Njoftimi për ndryshime materiale	Njoftim paraprak në MMPHI për ndryshim të kapacitetit, të llojeve të mbeturinave, të teknologjisë ose të organizimit të lokacionit	Para zbatimit të ndryshimit

Mekanizmi i pajtueshmërisë	Përmbajtja	Frekuenca
Rinovimi i pëlqimit dhe i licencës	Aplikim për rinovim para skadimit të afateve	Sipas afateve ligjore

9.3. Inkurajimi i zhvillimit të sistemit të menaxhimit mjedisor në përputhje me standardin ISO 14000

Aplikuesi inkurajohet të zhvillojë dhe – në afat afatmesëm – të certifikojë sistem të menaxhimit mjedisor sipas ISO 14001. Struktura e PMM-së të paraqitur në këtë kapitull është hartuar në mënyrë të përputhshme me kërkesat e standardit, duke mundësuar tranzicion të drejtpërdrejtë drejt sistemit të certifikuar.

Tabela 87. Përputhshmëria e strukturës së PMM-së me kërkesat e ISO 14001

Kërkesa e ISO 14001	Elementi përkatës i zbatuar në këtë raport	Statusi
4. Konteksti i organizatës	Kapitujt 2, 3 dhe 4 – përshkrimi i veprimtarisë, i lokacionit dhe i gjendjes bazë; identifikimi i palëve të interesuara (MMPHI, Komuna, banorët, operatorët)	I mbuluar
5. Liderhipi	Nënkapitulli 5.15 dhe 9.1 – përgjegjësitë e menaxhmentit; deklarata e aplikuesit	I mbuluar
6.1 Aspektet mjedisore dhe rreziqet	Kapitulli 6 – identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve; matrica përmbledhëse	I mbuluar
6.1.3 Detyrimet e pajtueshmërisë	Nënkapitulli 1.4, 2.11, 7.1 dhe 10.3 – korniza ligjore dhe regjistri i lejeve	I mbuluar
6.2 Objektivat mjedisore	Nënkapitulli 9.1 – objektivat dhe treguesit e performancës	I mbuluar
7.2 Kompetenca	Nënkapitulli 5.16 – programi i trajnimeve	I mbuluar
7.5 Informacioni i dokumentuar	SOP-01 – SOP-12; ditari i mbeturinave; regjistrat	I mbuluar
8.1 Planifikimi dhe kontrolli operativ	Nënkapitujt 2.4, 2.7, 5.6 dhe 7.3 – procesi, operacionet dhe zgjidhjet teknike	I mbuluar
8.2 Gatishmëria dhe reagimi emergjent	Nënkapitujt 5.18 dhe 7.2 – skenarët, veprimet dhe masat	I mbuluar
9.1 Monitorimi dhe matja	Kapitulli 8 – programi i monitorimit	I mbuluar
9.2 Audit i brendshëm	Rekomandimi R-12 – audit vjetor	Për zbatim
9.3 Rishikimi nga menaxhmenti	Nënkapitulli 9.1 – rishikim vjetor i PMM-së	I mbuluar
10. Përmirësimi	Nënkapitulli 9.2 – veprimet korrigjuese; nënkapitulli 7.4 – masat rekomanduese	I mbuluar
Certifikimi	Certifikim nga organ i akredituar	Rekomandim afatmesëm (R-04)

10. INFORMACIONE SHITESË DHE KARAKTERISTIKAT E PROJEKTIT

10.1. Informacionet dhe karakteristikat shitesë të projektit specifik

Në përputhje me nenin 15 të UA (MMPHI) nr. 04/2025, paraqiten informacione shitesë specifike për këtë lloj projekti, të cilat nuk mbulohen nga kapitujt paraprakë dhe që kanë rëndësi për shqyrtimin e kërkesës.

10.1.1. Kriteret e pranimit dhe të refuzimit të mbeturinave

Përcaktimi i qartë i kriterëve të pranimit përbën instrumentin kryesor parandalues për veprimtaritë e grumbullimit të mbeturinave. Fraksionet në vijim **nuk pranohen** në lokacion:

Tabela 88. Kriteret e refuzimit të mbeturinave në pranim

Kategoria e refuzuar	Kodet tipike	Arsyeja e refuzimit
Mbeturina medicinale dhe veterinare	18 01 xx, 18 02 xx	Kërkojnë trajtim të specializuar; nuk përfshihen në licencën e aplikuar
Materiale që përmbajnë azbest	17 06 01*, 17 06 05*, 16 01 11*	Kërkojnë procedura dhe autorizim të veçantë; rrezik i fibrave në ajër
Materiale radioaktive	—	Jashtë kompetencës; kërkojnë autoritet të veçantë
Eksplzivë dhe municion	16 04 01*, 16 04 02*, 16 04 03*	Rrezik i drejtpërdrejtë; kërkojnë autoritet të veçantë (përfshijm: qesat e ajrit 16 01 10* si komponentë të automjeteve)
Mbeturina të biodegradueshme dhe organike	20 01 08, 20 02 01, 02 xx xx	Nuk kryhet trajtim biologjik; rrezik i kundërmimeve dhe i vektorëve
Transformatorë dhe kondensatorë me PCB	16 02 09*, 16 02 10*	Kërkojnë trajtim të specializuar; rrezik i lartë ekotoksik
Pajisje ftohëse me klorofluorokarbone	16 02 11*, 20 01 23*	Kërkojnë nxjerrje të kontrolluar të gazit ftohës me pajisje të certifikuar
Kimikate laboratorike dhe të skaduara	16 05 06*, 16 05 07*, 16 05 08*	Kërkojnë identifikim analitik dhe trajtim të specializuar
Mbeturina të panjohura ose të pakodifikuara	—	Nuk mund të garantohej menaxhim i sigurt; kërkohet karakterizim paraprak
Mbeturina në sasi që tejkalojnë kapacitetin e lejuar	—	Tejkalim i kushteve të pëlqimit mjedisor

Në rast të konstatimit të një fraksioni të papranueshëm pas shkarkimit, ngarkesa izolohet, identifikohet, dokumentohet dhe kthehet tek zotëruesi ose dorëzohet tek operator i licencuar; rasti regjistrohet dhe raportohet në raportin vjetor.

10.1.2. Gjurmueshmëria dhe ditari i mbeturinave

Gjurmueshmëria e çdo ngarkese është kusht për bilancin material dhe për verifikimin e destinacionit të licencuar. Tabela në vijim përcakton të dhënat që regjistrohen nga pranimi deri te dorëzimi.

Tabela 89. Të dhënat e detyrueshme të ditarit të mbeturinave

Të dhëna të detyrueshme në ditarin e mbeturinave	Momenti i regjistrimit
Data dhe ora e pranimit	Në pranim
Zotëruesi / bartësi i mbeturinës (emri, NUI, adresa)	Në pranim
Targa e mjetit transportues	Në pranim
Numri i fletë-përcjellëses	Në pranim
Kodi gjashtë-shifror sipas Katalogut Shtetëror	Në pranim (pas klasifikimit)
Emërtimi sipas Katalogut dhe klasa e rrezikshmërisë	Në pranim
Sasia (t), e përcaktuar me peshim	Në pranim
Zona / boks i magazinimit	Në magazinim
Data e fillimit të magazinimit	Në magazinim
Operacioni i kryer (R12 / R13) dhe data	Pas kryerjes
Sasia dhe kodi i fraksioneve daluese (për ELV)	Pas çmontimit
Ndryshimi i statusit të kodit (16 01 04* → 16 01 06)	Pas depolutimit
Data e dorëzimit, operatori pranues dhe numri i licencës	Në dorëzim
Numri i fletë-përcjellëses dalëse dhe konfirmimi i pranimit	Në dorëzim
Bilanci mujor hyrje – dalje – magazinim për secilin kod	Mujore

10.1.3. Kufizimet operative të detyrueshme

Kufizimet operative përcaktojnë qartë veprimet e ndaluara dhe pragjet që nuk mund të tejkalohen. Tabela në vijim i paraqet ato si kushte të drejtpërdrejta për personelin dhe kontrollin inspektues.

Tabela 90. Kufizimet operative të detyrueshme të veprimtarisë

Kufizimi	Vlera	Baza
Kapaciteti maksimal i pranimit	2000 t/vit	Kapaciteti i magazinimit i derivuar (nënkapitulli 5.11)
Magazinim maksimal i njëkohshëm – fraksione jo të rrezikshme	≈ 180 t	Kapaciteti i boksesh; korridore qasjeje
Magazinim maksimal i njëkohshëm – fraksione të rrezikshme	≈ 12 t	Kapaciteti i depove të dedikuara; sigurimi kundër zjarrit
Koha maksimale e magazinimit – jo të rrezikshme	6 muaj	Praktikë e mirë; parandalim i akumulimit
Koha maksimale e magazinimit – të rrezikshme	3 muaj	Praktikë e mirë; reduktim i rrezikut
Lartësia maksimale e stivimit	1.8 m	Stabilitet; qasje për fikje zjarri; ndikim vizual
Automjete jashtë përdorimit në pritje (para depolutimit)	≤ 12 njësi njëkohësisht	Kapaciteti i zonës së pritjes (300 m²)
Orari i operimit	08:00–17:00 (e hënë – e premte)	Parandalim i ndikimit akustik të natës
Shpejtësia maksimale brenda lokacionit	10 km/h	Reduktim i emetimit të pluhurit; siguri

Kufizimi	Vlera	Baza
Punë me flakë të hapur në zonat me lëngje të ndezshme	E ndaluar	Parandalim i zjarrit dhe i shpërthimit
Magazininim i lëngjeve të rrezikshme jashtë objektit	I ndaluar	Mbrojtja e ujërave nëntokësore
Çmontim i MPEE	I ndaluar	Jashtë shtrirjes së titullit dhe të licencës; kërkon autorizim të veçantë
Grimcim (shredding), shkrirje, djegie, trajtim kimik	I ndaluar	Nuk kryhet trajtim sipas neneve 27–29 të Ligjit nr. 04/L-060

10.2. Lista e kontrollit sipas Shtojcës II të UA (MMPHI) nr. 04/2025

Vetëkontrolli i përputhshmërisë së raportit është kryer sipas Shtojcës II – Lista e kontrollit të UA (MMPHI) nr. 04/2025. Rezultati i vetëkontrollit paraqitet në tabelën në vijim, me referencën e saktë të nënkapitullit ku mbulohet secila kërkesë.

Tabela 91. Lista e kontrollit sipas Shtojcës II të UA (MMPHI) nr. 04/2025 – rezultati i vetëkontrollit

Nr.	Kërkesa sipas Shtojcës II – Lista e kontrollit	Statusi (PO / JO / ME KUSHT)	Referenca në raport
1	Informacione të përgjithshme	PO	Kapitulli 1
2	Të dhënat për aplikuesin	PO	1.1; kontakti, data, nënshkrimi dhe vula plotësohen para dorëzimit
3	Të dhënat kryesore për projektin, titulli, vendndodhja, adresa	PO	1.2
4	Të dhëna për hartuesit	PO	1.3; licenca dhe nënshkrimi bashkëngjiten para dorëzimit
5	Përshkrimi i projektit të propozuar	PO	Kapitulli 2
6	Kategoria e projektit	PO	2.1
7	Punët përgatitore	PO	2.2
8	Karakteristikat kryesore të funksionimit	PO	2.3
9	Përshkrimi detal i procesit nga lënda e parë deri te produkti	PO	2.4
10	Lloji dhe sasia e burimeve të nevojshme	PO	2.5
11	Gjenerimi i llojit dhe sasisë së mbeturinave dhe emetimeve	PO	2.6
12	Teknologjia e trajtimit, përpunimit, riciklimit dhe asgjësimit	PO	2.7
13	Program për ndërtimin, kohëzgjatjen dhe rehabilitimin	PO	2.8
14	Të dhëna për infrastrukturën	PO	2.9
15	Të dhëna për aktivitete të tjera (kampe, rezidenca)	PO	2.10 – nuk aplikohet
16	Informacion për lejet dhe licencat	PO	2.11
17	Informacion për lidhjet me projekte të tjera ekzistuese	PO	2.12
18	Përshkrimi i lokacionit të propozuar	PO	Kapitulli 3

Nr.	Kërkesa sipas Shtojcës II – Lista e kontrollit	Statusi (PO / JO / ME KUSHT)	Referenca në raport
19	Skica, planimetria, harta topografike, ngastrat, koordinatat, fotografi	PO	3.1–3.2; koordinatat P1–Pn plotësohen nga rilevimi gjeodezik
20	Distancat nga qendrat e banuara, shoqëruar me fotografi	PO	3.3
21	Karakteristikat pedologjike, gjeomorfologjike, gjeologjike, hidrogeologjike, sizmologjike	PO	3.4
22	Burimi i furnizimit me ujë, distanca, kapaciteti, rreziku, zonat sanitare	PO	3.5; konfirmimet sanitare/ujore bashkëngjiten para dorëzimit
23	Karakteristikat klimatike me tregues meteorologjik	PO	3.6
24	Karakteristikat natyrore (ligatina, ujëra, toka bujqësore, zona të mbrojtura, Natura 2000)	PO	3.7 dhe 3.12
25	Karakteristikat themelore të peizazhit	PO	3.8
26	Objektet e mbrojtura të trashëgimisë kulturore dhe historike	PO	3.9
27	Të dhënat për popullsinë dhe karakteristikat demografike	PO	3.10
28	Objektet ekzistuese tregtare, industriale, banesore, infrastrukture	PO	3.11
29	Zonat për kërkime shkencore, arkeologjike, veçanërisht të ndjeshme	PO	3.12
30	Burimet ujore në sipërfaqe dhe në afërsi	PO	3.13
31	Gjendja aktuale e faktorëve mjedisor	PO	4.1 dhe Tabela 41;
32	Ndryshimet e mundshme nëse projekti nuk zbatohet	PO	4.1; 5.21
33	Përshkrimi i alternativave të projektit	PO	Kapitulli 5
34	Alternativa të hartimit, teknologjisë, vendndodhjes, madhësisë, qëllimit	PO	5.1
35	Arsyet kryesore për zgjedhjen e alternativës	PO	5.2 – 5.20
36	Përshkrimi i alternativës pa veprim	PO	5.21
37	Përshkrimi i ndikimeve në mjedis	PO	Kapitulli 6
38	Cilësia e ajrit	PO	6.2–6.5 dhe MN-04;
39	Cilësia e ujit	PO	6.6 – 6.9
40	Toka	PO	6.10 – 6.15
41	Popullsia lokale	PO	6.16 – 6.19
42	Ndikimet socio-ekonomike	PO	6.20 – 6.23
43	Ekosistemet dhe gjeologjia	PO	6.24–6.26;
44	Qëllimi dhe shfrytëzimi i sipërfaqeve	PO	6.27 – 6.29
45	Infrastruktura komunale	PO	6.30 – 6.35
46	Pasuritë e mbrojtura natyrore, kulturore dhe peizazhi	PO	6.36
47	Zbatimi i projektit, punimet e largimit	PO	6.38

Nr.	Kërkesa sipas Shtojcës II – Lista e kontrollit	Statusi (PO / JO / ME KUSHT)	Referenca në raport
48	Ndikimet kumulative të projekteve të tjera ekzistuese	PO	6.39
49	Shtrirja hapësinore e ndikimit negativ	PO	6.40
50	Shkarkimi i ujërave të ndotura gjatë ndërtimit	PO	6.41
51	Emetimet e rrezatimit elektromagnetik gjatë ndërtimit	PO	6.42
52	Emetimet e gazrave serrë gjatë operimit	PO	6.43;
53	Ndikimet në ndryshimet klimatike	PO	6.44
54	Masat për parandalimin, reduktimin, eliminimin e ndikimeve	PO	Kapitulli 7
55	Masat e parashikuara me legjislacion, norma, standarde dhe afate	PO	7.1
56	Masat në rast aksidentesh dhe fatkeqësive të mëdha	PO	7.2
57	Përshkrimi i substancave të rrezikshme, sasitë dhe karakteristikat	PO	7.2; Tabela e substancave
58	Planet dhe zgjidhjet teknike: trajtim, riciklim, magazinim, rikultivim, rehabilitim	PO	7.3
59	Masa të tjera parandaluese, zvogëluese ose neutralizuese	PO	7.4
60	Programi i monitorimit të ndikimit në mjedis	PO	Kapitulli 8
61	Gjendja mjedisore përpara vënies në punë	PO	8.2 dhe 4.1; raporti bazë bashkëngjitet para operimit të plotë
62	Parametrat për përcaktimin e efekteve të dëmshme	PO	8.3
63	Vendet, mënyra dhe shpeshtësia e matjeve	PO	8.4
64	Përmbajtja dhe dinamika e raporteve	PO	8.5
65	Detyrimi për informimin e publikut	PO	8.6
66	Programi ndërkuftar i monitorimit	PO	8.7 – nuk kërkohet, i arsyetuar
67	Plani i menaxhimit mjedisor	PO	Kapitulli 9
68	Mbrojtja efektive mjedisore gjatë gjithë fazave	PO	9.1
69	Pajtueshmëria me pëlqimin mjedisor	PO	9.2
70	Sistemi i menaxhimit mjedisor sipas ISO 14000	PO	9.3
71	Përmbledhje jo-teknike e informacionit	PO	12.1; hartë përmbledhëse A4 me lokacion, receptorë, veri, shkallë dhe legjendë
72	Informacione shtesë dhe karakteristikat e projektit	PO	Kapitulli 10
73	Burimet e të dhënave	PO	Kapitulli 11; burimet janë specifikuar me institucion, titull, vit dhe datë qasjeje

Interpretimi i statusit: “PO” tregon se kërkesa është trajtuar në tekst; “PO – me kusht” tregon se përmbajtja është përfshirë, por vlefshmëria përfundimtare varet nga matja ose dokumenti i jashtëm; “JO –

për plotësim formal” tregon elementin që duhet plotësuar para dorëzimit. Kjo listë nuk zëvendëson kontrollin e dokumenteve të Shtojcës III në Tabelën 97.

10.3. Korniza ligjore e zbatueshme

Aktet ligjore dhe nënligjore në vijim përbëjnë kornizën e zbatueshme për hartimin e raportit dhe për ushtrimin e veprimtarisë. Statusi i tyre është kontrolluar kundrejt burimeve zyrtare të Gazetës Zyrtare dhe është paraqitur shprehimisht në tabelë.

Tabela 92. Korniza ligjore dhe normative e zbatueshme, me statusin e verifikuar

Nr.	Akti	Publikimi në Gazetën Zyrtare	Statusi	Relevanca për projektin
1	Ligji nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis	Nr. 2, 6 janar 2023	Në fuqi	Akti bazë i procedurës së VNM-së dhe të pëlqimit mjedisor
2	UA (MMPHI) nr. 04/2025 për përmbajtjen, metodologjinë dhe përputhshmërinë e raportit me kërkesat ligjore, praktikën e zbatueshme dhe aspektet e tjera teknike të raportit	Nënshkruar 04.12.2025; në fuqi 7 ditë pas publikimit	Në fuqi	Përcakton strukturën dhe përmbajtjen e këtij raporti
3	Ligji nr. 04/L-060 për Mbeturina (teksti i konsoliduar, publikuar më 03.04.2026)	Gazeta Zyrtare / akti i konsoliduar, 03.04.2026	Në fuqi	Përkufizimet; hierarkia; Lista R (Shtojca II) dhe Lista D (Shtojca I); nenet 25–32
4	Ligji nr. 08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-060 për Mbeturina	Nr. 29, 1 shtator 2022	I integruar në tekstin e konsoliduar	Përafrim me Direktivën 2008/98/KE; ekonomia qarkore
5	UA (MMPH) nr. 13/2013 për Katalogun Shtetëror të Mbeturinave	2013	Në fuqi	Baza e kodifikimit të mbeturinave – nenet 2–6; Shtojca I
6	Ligji nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit	2009	Në fuqi	Parimet e përgjithshme të mbrojtjes së mjedisit
7	Ligji nr. 08/L-025 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja	—	Në fuqi	Kërkesat për emetimet dhe cilësinë e ajrit
8	Ligji nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës	29 april 2013	Në fuqi	Mbrojtja e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore; shkarkimet
9	UA (MMPHI) nr. 02/2022 për kushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin ujor	2022	Në fuqi	Vlerat kufizuese për daljen e separatorit
10	Ligji nr. 02/L-102 për Mbrojtjen nga Zhurma	—	Në fuqi	Kufizimet e nivelit të zhurmës
11	Ligji nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës	—	Në fuqi	Zonat e mbrojtura; biodiversiteti
12	Ligji nr. 04/L-174 për Planifikim Hapësinor	—	Në fuqi	Përputhshmëria me HZK Lipjan
13	Ligji nr. 04/L-197 për Kimikatet, i ndryshuar me Ligjin nr. 08/L-116	—	Në fuqi	Klasifikimi dhe etiketimi i substancave të rrezikshme

Nr.	Akti	Publikimi në Gazetën Zyrtare	Statusi	Relevanca për projektin
14	Ligji nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë	—	Në fuqi	Vlerësimi i rreziqeve; PMP; trajnimet
15	Ligji nr. 08/L-261 për Mbrojtje nga Zjarri	Nr. 16, 12 gusht 2024	Në fuqi; ka shfuqizuar Ligjin nr. 04/L-012	Pajisjet e fikjes; plani i evakuimit
16	Ligji nr. 04/L-110 për Ndërtim	—	Në fuqi	Kërkesat për objektet dhe instalimet
17	Ligji nr. 03/L-043 për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes	—	Në fuqi	Parimet e kontrollit të integruar (relevante për referencë)
18	UA (MMPH) nr. 19/2012 për automjetet jashtë përdorimit; UA (MMPH) nr. 25/2014 për MPEE; UA (MMPH) nr. 26/2014 për bateritë dhe akumulatorët; UA nr. 05/2013 për vajrat e përdorura; UA (QRK) nr. 03/2021 për mbeturinat e rrezikshme; UA nr. 09/2014 për licencën e menaxhimit të mbeturinave	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës	Në fuqi; të verifikuara më 27.07.2026	Kërkesa specifike për ELV, MPEE, bateri/akumulatorë, vajra, mbeturina të rrezikshme dhe licencimin e operatorit
19	Direktiva 2008/98/KE për mbeturinat; Direktiva 2000/53/KE për automjetet jashtë përdorimit; Direktiva 2011/92/BE dhe 2014/52/BE për VNM; Vendimi 2000/532/KE për listën e mbeturinave	Acquis i BE-së	Referencë – i transpozuar pjesërisht	Bazë e përafrimit të legjislacionit vendor
20	EN 858-1 dhe EN 858-2 – Separatorë të lëngjeve të lehta	Normë evropiane	E zbatueshme	Dimensionimi dhe klasa e separatorit
21	EN 1998 (Eurokodi 8) – Projektimi antisizmik	Normë evropiane	E zbatueshme	Ankorimi i depozitave në zonën sizmike VIII
22	ISO 1996-2; EN ISO 9612; EN 12341; EN ISO 5667; ISO 14001	Norma ndërkombëtare	Të zbatueshme	Metodat e monitorimit dhe sistemi i menaxhimit mjedisor

Deklarim mbi saktësinë e referencave ligjore: aktet kryesore dhe aktet nënligjore për rrjedhat e veçanta janë verifikuar kundrejt Gazetës Zyrtare më 27.07.2026. Ligji nr. 04/L-012 për mbrojtje nga zjarri është zëvendësuar me Ligjin nr. 08/L-261; për mbeturinat zbatohet teksti i konsoliduar i Ligjit nr. 04/L-060, publikuar më 03.04.2026. Nëse pas kësaj date publikohet një ndryshim i ri, zbatohet teksti më i fundit në fuqi.

11. BURIMET E TË DHËNAVE

11.1. Lista e referimit të burimeve e të dhënave të përdorura për përshkrimet dhe vlerësimet e dhëna në raportin e VNM-së

11.1.1. Akte ligjore dhe nënligjore

Aktet ligjore dhe nënligjore të përdorura, me publikimin dhe statusin e tyre, janë listuar në Tabelën e kornizës ligjore (nënkapitulli 10.3). Burimi primar i verifikimit është Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës.

11.1.2. Dokumentacion i projektit dhe të dhëna të aplikuesit

- Certifikata e regjistrimit të biznesit të Loresa BBV Sh.p.k. (numri i biznesit 812014132).
- Certifikata mbi të drejtat e pronës së paluajtshme për parcelën kadastrale P-71409044-01218-2, ZK Lipjan.
- Kopja e planit kadastral me koordinata në sistemin KosovaRef01.
- Plani i rilevimit të terrenit i hartuar nga gjeodet i licencuar (Shtojca 12).
- Informacioni i lokacionit urban / njoftimi sipas Hartës Zonale Komunale të Lipjanit.
- Kontrata me KRM “Pastrimi” për grumbullimin e mbeturinave komunale.
- Të dhëna operative të aplikuesit për numrin e punonjësve, orarin e punës, pajisjet e instaluar dhe fluksin e materialeve.
- Fotodokumentim i terrenit i realizuar gjatë vizitës në lokacion (korrik 2026).

11.1.3. Korrespondencë institucionale

- Njoftim i MMPHI-së – Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit, ref. 26/3238/522/DMM, datë 27.07.2026, nënshkruar nga Lindita Morina, Kryesuese e Komisionit për VNM: kërkesa për plotësimin e dokumentacionit dhe për sqarimin e termit “trajtim”.

11.1.4. Të dhëna statistikore, hartografike dhe mjedisore

- Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) – Regjistrimi i Popullsisë dhe Banesave 2024: të dhënat demografike për Komunën e Lipjanit dhe për qytetin e Lipjanit.
- Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK), “Raport Vjetor për Gjendjen e Ajrit në Kosovë 2025”, Prishtinë, 2026; si dhe publikimet tematike të AMMK-së për ujërat, natyrën dhe mbeturinat. Burimi zyrtar: www.ammk-rks.net; qasur më 28.07.2026. Të dhënat rajonale përdoren për kontekst dhe nuk zëvendësojnë matjet lokale.
- MMPH/AMMK, “Libri i Kuq i Florës Vaskulare të Republikës së Kosovës”, Prishtinë, 2013; dhe MMPH/AMMK – Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës, “Libri i Kuq i Faunës së Republikës së Kosovës”, Prishtinë, 2019. U përdorën për kontroll dokumentar orientues; mungesa e një lloji të mbrojtur nuk deklarohet pa vërtetim sezonal.
- Geoportali Shtetëror i Republikës së Kosovës, shtresat e ortofotos, parcelave kadastrale, hidrografisë, relievit dhe zonave të mbrojtura; sistemi KosovaRef01; qasur më 27–28.07.2026. Kufijtë juridikë merren vetëm nga dokumentacioni kadastral dhe rilevimi i licencuar.
- Komuna e Lipjanit, Harta Zonale Komunale (HZK) dhe informacioni urbanistik për parcelën P-71409044-01218-2: destinimi i zonës dhe kushtet përkatëse. Numri, data dhe versioni i aktit plotësohen nga kopja e certifikuar që bashkëngjitet në Shtojcën D.
- Shtresat pedologjike, gjeologjike, hidrologjike/hidrogjeologjike dhe të relievit të publikuara në burimet shtetërore hartografike të Kosovës; qasur më 27.07.2026. Shkalla dhe saktësia janë ato të shtresës burimore dhe përdoren vetëm për skringing rajonal.
- Harta e zonimit sizmik të Republikës së Kosovës, intensiteti sipas MCS/MSK-64; shtresa kombëtare e përdorur për skringing. Projektimi konstruktiv verifikohet sipas Eurokodit 8 dhe të dhënave të lokacionit.
- Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës (IHMK), vjetarët dhe të dhënat klimatike/meteorologjike rajonale për Fushën e Kosovës: temperaturat, reshjet dhe regjimi i erës; qasur më 27.07.2026. Të dhënat përdoren si tregues rajonal dhe drejtimi real i erës regjistrohet gjatë MN-04.

11.1.5. Metodologji dhe burime teknike

- United States Environmental Protection Agency (US EPA), AP-42, Fifth Edition, Volume I: Chapter 13.2.1 “Paved Roads” (rev. 2011) dhe Chapter 13.2.4 “Aggregate Handling and Storage Piles” (rev. 2006); përdorur vetëm për inventarin paraprak të pluhurit, jo si model dispersioni.
- European Environment Agency, “EMEP/EEA Air Pollutant Emission Inventory Guidebook 2023”, kapitulli 1.A.4 – Non-road mobile machinery; faktorë orientues për makinerinë dizel, të përditësueshëm sipas klasës reale të motorit.
- ISO 9613-2: Akustika – Zbutja e zërit gjatë propagimit në ambient të hapur – metodologjia e vlerësimit të propagimit të zhurmës.
- ISO 1996-2: Akustika – Përcaktimi i nivelit të zhurmës mjedisore – metodologjia e matjes.
- EN ISO 9612: Akustika – Përcaktimi i ekspozimit profesional ndaj zhurmës.
- EN 12341: Ajri i ambientit – Metoda gravimetrike referuese për përcaktimin e PM₁₀ dhe PM_{2.5}.
- EN ISO 5667: Cilësia e ujit – Kampionimi.
- EN 858-1 dhe EN 858-2: Sisteme separatorë për lëngje të lehta – dimensionimi, klasat dhe kërkesat e performancës.
- EN 1998 (Eurokodi 8): Projektimi i strukturave për rezistencë ndaj tërmetejeve.
- ISO 14001: Sisteme të menaxhimit mjedisor – kërkesat.
- Literaturë teknike për përbërjen materiale të automjeteve jashtë përdorimit dhe për bilancin material të çmontimit (të dhëna të pranuar për automjete të lehta dhe të rënda).
- Përfitimet potenciale të gazeve serrë nga rikuperimi pasues nuk janë përfshirë numerikisht në bilancin e projektit. Çdo vlerësim i ardhshëm duhet të citojë burimin e plotë, kufijtë e sistemit, vitin e faktorit, destinacionin dhe operacionin final, si dhe të provojë adicjonalitetin dhe shmangien e numërimit të dyfishtë.

12. SHTOJCA

12.1. Përmbledhja jo-teknike e informacionit

Kjo përmbledhje është hartuar në mënyrë koncize dhe pa terma të specializuara teknike, në përputhje me nenin 14 të UA (MMPHI) nr. 04/2025.

12.1.1. Çfarë parashihet të bëhet dhe ku

Kompania Loresa BBV Sh.p.k. kërkon pëlqim mjedisor për një qendër ku mbeturinat pranohen, kontrollohen dhe klasifikohen sipas kodit. Metalet dhe plastika përgatiten mekanikisht para rikuperimit (R12); bateritë, akumulatorët dhe pajisjet elektrike/elektronike ruhen të pandryshuara përkohësisht (R13); automjetet jashtë përdorimit depolutohen dhe çmontohen (R12). Në qendër nuk kryhet shkrirje, djegie ose riciklim përfundimtar.

Qendra ndodhet në Komunën e Lipjanit, në parcelën nr. 1218-2, pranë magjistralsë Prishtinë–Shtime, në një zonë që Komuna e ka caktuar për veprimtari komerciale dhe industriale. Sipërfaqja e parcelës është 2916 m². Brenda saj ndodhen dy objekte (hangarë) të ndërtuara më parë, secili me sipërfaqe rreth 845 m². Nuk do të ndërtohet asgjë e re dhe nuk do të merret tokë shtesë.

Në qendër punojnë 6 persona, gjatë orarit 08:00–17:00 (e hënë – e premte). Nuk punohet natën.

12.1.2. Sa larg janë banorët dhe objektet e ndjeshme

Përmbledhja joteknike shpjegon distancat kryesore në gjuhë të kuptueshme për publikun. Tabela në vijim paraqet receptorët më të afërt dhe tregon se vlerat hartografike duhet të konfirmohen me dokumentacionin gjeodezik.

Tabela 93. Distancat e qendrës nga banorët dhe objektet e ndjeshme (përmbledhje jo-teknike)

Vendi	Sa larg
Qendra e qytetit të Lipjanit	rreth 508 metra
Xhamia më e afërt	rreth 650 metra
Fshati më i afërt – Hallaqi i Vogël	rreth 901 metra
Lumi Sitnica	rreth 450 metra
Shkolla, çerdhe, objekte shëndetësore	asnjë brenda 500 metrave
Zona të mbrojtura të natyrës	asnjë në afërsi
Monumente të mbrojtura kulturore	asnjë në afërsi

12.1.3. Çfarë ndryshoi në këtë raport dhe pse

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, me shkresën e datës 27.07.2026, kërkoi dy plotësime kryesore: raporti të hartohet sipas udhëzimit administrativ në fuqi, dhe të sqarohet pse në titullin e projektit përdorej fjala “trajtim”.

Termi “trajtim” është saktësuar si “trajtim paraprak mekanik R12”. Kjo përfshin klasifikimin, ndarjen, presimin, paketimin, depolutimin dhe çmontimin para rikuperimit. Nuk përfshin trajtim kimik, biologjik ose termik, shkrirje, djegie apo riciklim përfundimtar.

Titulli zyrtar nuk përdor termin e përgjithshëm “trajtim”; raporti sqaron veçmas operacionet paraprake mekanike R12 dhe magazinimin R13 për rrjedhat përkatëse. Pëlqimi mjedisor nuk zëvendëson licencën e menaxhimit të mbeturinave.

Gjithashtu, raporti tani përmban listën e plotë të kodeve zyrtare për secilin lloj mbeturine që pranohet, sipas Katalogut Shtetëror të Mbeturinave. Për secilin kod është shkruar se çfarë bëhet me atë material në qendër, si ruhet dhe ku dërgohet më pas.

12.1.4. Sa material do të përpunohet në vit

Kapaciteti vjetor prej 2 000 tonësh është kufi maksimal i deklaruar dhe jo prodhim i garantuar. Tabela në vijim e ndan atë sipas rrjedhave kryesore, ndërsa sasitë reale dokumentohen me peshime.

Tabela 94. Sasitë e materialeve që do të pranojnë në vit (përmbledhje jo-teknike)

Lloji i materialit	Sasia në vit
Hekur dhe çelik	rreth 1 210 ton
Metale të tjera (bakër, alumin, të përziera)	rreth 185 ton
Automjete dhe kamionë jashtë përdorimit	rreth 130 njësi (415 ton)
Plastikë	rreth 80 ton
Pajisje elektrike dhe elektronike	rreth 58 ton
Bateri të automjeteve	rreth 28 ton
Goma të përdorura	rreth 40 ton
Letër, karton dhe qelq	rreth 24 ton
GJITHSEJ	2000 ton në vit

Pjesa më e madhe e rrjedhave synohet për rikuperim, por përqindja reale nuk deklarohet pa fletë-përcjellëse dhe dëshmi nga operatorët pranues. Mbeturinat komunale, llumi septik dhe çdo rrjedhë tjetër e destinuar për operacion D raportohen veçmas si asgjësim jashtë lokacionit.

12.1.5. Çfarë ndikime mund të ketë

Ndikimet kryesore mund të kontrollohen vetëm nëse masat teknike realizohen para operimit të plotë dhe monitorohen rregullisht. Tabela në vijim përmbledh rrezikun dhe masën për publikun pa zëvendësuar analizën teknike.

Tabela 95. Ndikimet e mundshme dhe masat mbrojtëse (përmbledhje jo-teknike)

Ndikimi i mundshëm	Sa i madh është	Çfarë bëhet për t'u parandaluar
Pluhur	Pritet i vogël, por nuk është matur ende në lokacion ose te receptorët.	Sipërfaqet lagen kur është thatë; materialet e lehta ruhen brenda ose të mbuluara; oborri pastrohet rregullisht; makinat lëvizin me shpejtësi të ngadalshme.
Zhurmë	Pritet e ulët te banesat më të afërta; niveli real verifikohet me matje.	Punohet vetëm ditën; punët më të zhurmshme kryhen brenda objektit; makineritë mirëmbahen.
Ndotje e ujit nën tokë	Ky është rreziku më i rëndësishëm, sepse toka nën qendër lëshon ujin shpejt.	Të gjitha operacionet kryhen vetëm brenda hangarëve ose në rreth 1.060 m ² sipërfaqe operative të papërshkueshme; rreth 166 m ² sipërfaqe të gjelbra përjashtohen nga puna. Platforma e depolimit, pellgjet mbajtëse dhe separatori realizohen para operimit të plotë.
Ndotje e tokës	E mundshme vetëm në rast derdhjeje aksidentale.	Nuk ka kontakt të drejtpërdrejtë me tokën; enët e vajrave vendosen mbi pellgje mbajtëse; pranë çdo zone mbahet material thithës për derdhje.
Erë e keqe	Nuk pritet. Nuk pranohen mbeturina ushqimore apo organike.	Vajrat ruhen në enë të mbyllura.

Ndikimi i mundshëm	Sa i madh është	Çfarë bëhet për t'u parandaluar
Trafik	Skenari parashikon rreth 3,6 lëvizje kamionësh dhe rreth 12 lëvizje veturash në ditë pune; përqindja ndaj M-25 nuk është përcaktuar pa numërim trafiku.	Hyrje-dalje e organizuar; ndalohet qëndrimi në rrugë publike.
Pamja e vendit	Nuk ndryshon. Objektet ekzistojnë dhe zona është industriale.	Materialet nuk stivohen më lart se 1.8 metra; pjesa më e madhe ruhet brenda.
Kafshë dhe bimë	Nuk pritet humbje e drejtpërdrejtë habitati; mungesa e specieve të mbrojtura nuk deklarohet pa vërtetim sezonal.	Gomat ruhen ashtu që të mos mbledhin ujë, për të mos krijuar vend për mushkonja.
Zjarr	I mundshëm, si në çdo vend me materiale të përdorura.	Vendosen fikëse zjarri; ndalohet puna me flakë pranë vajrave; bëhen ushtrime një herë në vit.

12.1.6. Përfitimet

- Kapaciteti maksimal i pranimit mbetet 2.000 t/vit. Duke përfshirë vetëm rrjedhat e veta që potencialisht mund të rikuperohen, potenciali teorik total është deri në rreth 2.002,3 t/vit; sasia reale provohet çdo vit me fletë-përcjellëse dhe dëshmi të operatorëve pranues.
- Automjetet e vjetra çmontohen në një vend të kontrolluar, ku vajrat, bateritë dhe lëngjet nxirren siç duhet – në vend që të hidhen kudo.
- Kursehen lëndë të para të reja: për të prodhuar hekur ose alumin nga materiali i ricikluar shpenzohet shumë më pak energji sesa nga minerali.
- Krijohet potencial për ulje të emetimeve përmes rikuperimit; përfitimi klimatik llogaritet vetëm pasi të verifikohen sasitë dhe operacionet përfundimtare të operatorëve pranues.
- 6 vende pune të përhershme në Lipjan, plus punë indirekte për transport dhe shërbime.

12.1.7. Zgjidhjet e tjera që u shqyrtuan

U shqyrtuan katër mundësi të tjera. Pa projekt do të zbatoheshin mbyllja e kontrolluar: ndalimi i pranimit, largimi i mbeturinave, pastrimi dhe rehabilitimi; kjo nuk u zgjodh për shkak të humbjes së kapacitetit lokal dhe të vendeve të punës. Zhvendosja kërkon tokë dhe objekte të reja; grimcimi industrial sjell më shumë pluhur e zhurmë; kapaciteti më i madh tejkalon hapësirën e sigurt. Prandaj u zgjodh varianti aktual, i kushtëzuar me masat teknike paraprake dhe monitorimin.

12.1.8. Si do të kontrollohet


Para se qendra të funksionojë me kapacitet të plotë, do të matet gjendja fillestare e ujit nën tokë, e tokës, e ajrit dhe e zhurmës. Pastaj këto matje përsëriten rregullisht dhe krahasohen. Uji që shkarkohet nga pajisja ndarëse e vajit kontrollohet dy herë në vit. Mbahet një regjistër i çdo ngarkese që hyn dhe që del, me sasinë, kodin dhe destinacionin. Një raport i plotë dërgohet çdo vit në Ministri dhe është i hapur për publikun. Në hyrje të objektit vendoset një tabelë me numrin e telefonit të personit përgjegjës për mjedisin, që banorët të mund të paraqesin ankesa.

HARTA PËRMBLEDHËSE E LOKACIONIT DHE RECEPTORËVE TË NDJESHËM

Loresa BBV Sh.p.k. – ZK Lipjan, parcela P-71409044-01218-2

Koordinata qendrore (KosovaRef01): Y = 7 509 165.106; X = 4 708 876.373

Sipërfaqja: 2 916 m² (1 690 m² objekte; rreth 1 060 m² operative; 166 m² gjelbërim)



Receptori / elementi	Distanca	Drejtimi
Qendra urbane e Lipjanit	≈ 508 m	Lindje
Objekti fetar më i afërt	≈ 650 m	Lindje-juglindje
Hallaqi i Vogël	≈ 901 m	Perëndim
Lumi Sitnica	≈ 450 m	Jugperëndim
Magjistralla M-25	0 m (kufi)	Verilindje
Objekte shëndetësore/arsimore	> 500 m	Jashtë zonës së afërt

Shënim teknik: Distancat janë orientuese (saktësi e vlerësuar ±20 m). Kufiri dhe koordinatat e kulmeve të parcelës verifikohen me planin e rilevimit nga gjeodeti i licencuar (Shtojca C).

Burimi: Përpunim i hartuesit mbi bazën hartografike të përdorur në Figurën 16; koordinata qendrore dhe të dhënat e raportit, korrik 2026.

Figura 35. Harta përmbledhëse A4 e lokacionit dhe receptorëve të ndjeshëm, me parcelën, distancat, veriun, shkallën dhe legjendën

12.2. Lista e dokumenteve që bashkëngjiten raportit

Në përputhje me Shtojcën III të UA (MMPHI) nr. 04/2025, raportit bashkëngjiten dokumentet e mëposhtme. Statusi i secilit dokument duhet të konfirmohet dhe kopja përkatëse të bashkëngjitet para dorëzimit në Ministri.

Tabela 96. Lista e dokumenteve për aplikim sipas Shtojcës III të UA (MMPHI) nr. 04/2025

Nr.	Dokumenti sipas Shtojcës III të UA nr. 04/2025	Statusi
a)	Raporti i VNM-së, i nënshkruar nga aplikuesi dhe hartuesi i licencuar; katër (4) kopje të shkruara dhe një (1) kopje elektronike sipas nenit 13 të Ligjit nr. 08/L-181, si dhe kopja për Komunën sipas UA nr. 04/2025	Për dorëzim pas nënshkrimit dhe verifikimit të mediumit elektronik
b)	Dëshmia e pagesës për aplikim për pëlqim mjedisor	Për bashkëngjitje
c)	Vlera investuese e projektit, në formë tabelare	Për bashkëngjitje
d)	Certifikata e regjistrimit të biznesit	Për bashkëngjitje
e)	Certifikata mbi të drejtat e pronës së paluajtshme	Për bashkëngjitje
f)	Kopja e planit me koordinata në sistemin KosovaRef	Për bashkëngjitje
g)	Plani i rilevimit të terrenit nga gjeodeti i licencuar, si dhe licenca e gjeodetit	Për bashkëngjitje
h)	Kontrata e noterizuar për shfrytëzimin e ngastrës ose objektit, për rastet kur nuk është pronë e aplikuesit	Nuk aplikohet / për verifikim
i)	Pëlqimi nga autoritetet kompetente për vendosjen e rezervuarëve, në rastet e lëndëve djegëse të lëngëta apo materieve eksplozive	Për verifikim – depozitat e vajrave mbeturinë
j)	Pëlqimi i Komunës për ushtrimin e veprimtarisë ose njoftim-informimi sipas Planit Zhvillimor Komunal, hartat zonale, kushtet ndërtimore	Për bashkëngjitje
k)	Një (1) kopje fizike apo elektronike e raportit të VNM-së për Komunën e Lipjanit, në dispozicion të publikut	Për dorëzim
l)	Përmbledhja joteknike e raportit të VNM-së	E përfshirë – nënkapitulli 12.1
m)	Informacion për informimin dhe konsultimin me publikun dhe palët e tjera, realizuar gjatë hartimit të raportit	Për bashkëngjitje
n)	Licenca valide e personit fizik/juridik e lëshuar nga Ministria	Për bashkëngjitje

12.3. Shtojcat teknike

Shtojcat janë pjesë dokumentare e dosjes dhe provojnë licencat, pronësinë, performancën teknike dhe gatishmërinë operative. Tabela në vijim tregon përmbajtjen dhe statusin që duhet të plotësohet me dokumentet reale para dorëzimit.

Tabela 97. Shtojcat teknike të raportit

Shtojca	Përmbajtja	Statusi
Shtojca A	Kopja e licencës së hartuesit të raportit të VNM-së	Për bashkëngjitje
Shtojca B	Certifikata e regjistrimit të biznesit dhe certifikata e pronësisë	Për bashkëngjitje
Shtojca C	Kopja e planit kadastral dhe plani i rilevimit gjeodezik me koordinata KosovaRef01	Për bashkëngjitje
Shtojca D	Informacioni i lokacionit urban / njoftimi sipas HZK Lipjan	Për bashkëngjitje
Shtojca E	Kontratat me operatorët e licencuar dhe kopjet e licencave të tyre (sipas Tabelës së zinxhirit të trajtimit)	Për bashkëngjitje – e detyrueshme
Shtojca F	Specifikimi teknik dhe certifikata e performancës e separatorit koalescent (EN 858)	E detyrueshme para operimit të plotë
Shtojca G	Raporti i matjeve bazë referuese me certifikatat e laboratorit	E detyrueshme para operimit të plotë

Shtojca	Përmbajtja	Statusi
Shtojca H	Procedurat operative standarde SOP-01 – SOP-12	E detyrueshme para operimit të plotë
Shtojca I	Plani i Reagimit Emergjent, me listën e kontakteve dhe skemën e evakuimit	E detyrueshme para operimit të plotë
Shtojca J	Vlerësimi i rreziqeve në punë dhe aktet e SHSP-së	E detyrueshme para operimit të plotë
Shtojca K	Fotodokumentimi i plotë i lokacionit (korrik 2026)	E disponueshme
Shtojca L	Njoftimi i MMPHI-së ref. 26/3238/522/DMM, datë 27.07.2026	Për bashkëngjitje
Shtojca M	Shkresat konfirmuese për zonat e mbrojtura natyrore/kulturore, zonat e mbrojtjes sanitare dhe kushtet e shkarkimit/lidhjes me infrastrukturën ujore, sipas kompetencës	Për bashkëngjitje para dorëzimit